



**Raporti i Studimit Mjedisor dhe Social**

**PROJEKTI I PARKUT FOTOVOLTAIK  
SPITALLË DERI NË 100 MW, SHQIPËRI**

Nëntor / 2022  
Tiranë, Shqipëri

## PËRMBLEDHJE RAPORTI

TITULLI I PROJEKTIT	PROJEKTI I PARKUT FV SPITALLË, deri në 100 MW, SHQIPËRI, Spitalla Solar sh.p.k. për tu zhvilluar nga Voltalia Ltd
TITULLI I DOKUMENTIT	Raporti i Studimit Mjedisor dhe Social

Rishikimi	Data	Hartoi	Kontrolluesi	Aprovues	Përshkrim
00	23/11/2021	E.Sopaj, K.Cipo, A. Petroshti, T.Bino, A.Proko, F.Bego, A.Beqiraj, S.Sulce, M.Grundy, R.Biba	R.Biba, M.Grundy	R.Biba, M.Grundy	Drafti fillestar për komente nga klienti.
01	14/02/2022	E.Sopaj, K.Cipo, A. Petroshti, M.Grundy, R.Biba	R.Biba, M.Grundy	R.Biba, M.Grundy	Përditësuar për publikim.
02	11/11/2022	E.Sopaj, K.Cipo, A. Petroshti, M.Grundy, R.Biba	R.Biba, M.Grundy	R.Biba, M.Grundy	Përditësuar për publikim.

## Përmbajtja

SHKURTIMET .....	7
1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI RAPORTIN .....	9
1.1. Hyrje 9	
1.2. Historiku dhe Përmbledhja e Projektit.....	9
1.3. Qëllimi dhe Struktura e Raportit të Studimit.....	9
1.4. Përshkrim i Projektuesit të Projektit (Voltaia) .....	10
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT .....	12
2.1. Përmbledhje e projektit .....	12
2.2. Vendndodhja dhe drejtimi i projektit.....	12
2.3. Nevoja për Projektin.....	15
2.4. Përmbledhje teknike dhe komponentët e projektit.....	15
2.5. Vështrim i përgjithshëm i fazave dhe aktiviteteve të projektit .....	19
2.5.1. Mobilizimi/Para-ndërtimi.....	19
2.5.2. Faza e Ndërtimit dhe Instalimit.....	20
2.5.3. Operimi dhe Mirëmbajtja .....	22
2.5.4. Çaktivizimi dhe Mbyllja.....	23
2.6. Alternativat e projektit.....	23
2.6.1. Alternativa pa projekt ose mos bëni asgjë .....	23
2.6.2. Format alternative të gjenerimit të energjisë elektrike .....	23
2.6.3. Alternativat për vendndodhjen e Impiantit.....	24
2.7. Rishikimi i Projektit.....	24
3. KUADRI LIGJOR.....	25
3.1. Hyrje 25	
3.2. Kërkesat Kombëtare Ligjore.....	25
3.2.1. Procedura e Aprovimit Mjedisor .....	26
3.2.2. Kuadri i Mbrojtjes së Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura.....	30
3.2.3. Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore .....	31
3.2.4. Kuadri ligjor i mbrojtjes fizike të mjedisit .....	32
3.2.5. Shëndeti dhe siguria .....	38
3.2.6. Lige të tjera Kombëtare që kanë lidhje me këtë projekt.....	39
3.2.7. Legjislacioni Shqiptar për Sektorin e Energjisë.....	40
3.2.8. Konventat dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare .....	40
3.2.8.1. Udhëzimet e OBSH-së.....	44
3.2.8.2. Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (BNRN) .....	45
3.3. Kërkesat e BERZH-it.....	45
3.3.1. Kërkesat e Performancës së BERZH në M&S.....	45
3.3.2. Legjislacioni i BE-së për VNM.....	45
3.3.3. Kuadri Mjedisor dhe Social i Grupit të Bankës Botërore.....	46
3.3.4. Standardet e Performancës së IFC.....	47
3.3.5. Udhëzimet e IFC-së për Angazhimin Mjedisor, Social dhe të Palëve të Interesit .....	47
4. PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE MJEDISORE DHE SOCIALE .....	49
4.1. Mjedisi Fizik.....	49
4.1.1. Topografia dhe rreziqet natyrore.....	49
4.1.1.1. Pozicioni gjeografik dhe veçoritë gjeografike të zonës .....	50
4.1.2. Kushtet klimatike .....	50
4.1.2.1. Era.....	51
4.1.3. Cilësia e ajrit.....	52
4.1.4. Hidrologjia .....	54
4.1.4.1. Uji sipërfaqësor .....	54
4.1.4.2. Ujërat nëntokësore.....	55
4.1.5. Gjeologjia .....	58
4.1.5.1. Tokat zonale.....	58
4.1.5.2. Tokat azonale.....	58
4.1.5.3. Tokat intrazonale.....	58
4.1.5.4. Toka sipërfaqësore në zonën e projektit.....	58

4.1.6.	Përmbytjet .....	59
4.1.6.1.	Të dhënat hidrologjike nga vizita në terren .....	60
4.2.	Përdorimi i tokës .....	61
4.3.	Mjedisi Biologjik.....	63
4.3.1.	Zonat e mbrojtura .....	63
4.3.2.	Habitatet .....	66
4.3.3.	Flora .....	66
4.3.4.	Fauna .....	69
4.3.5.	Avifauna (fauna e zogjve) .....	70
4.3.6.	Ekologjia Ujore .....	71
4.4.	Baza Socio-Ekonomike .....	73
4.4.1.	Profili Demografik.....	74
4.4.2.	Ekonomia dhe Jetesa.....	74
4.4.3.	Arsimi .....	78
4.4.4.	Shëndetësia .....	78
4.4.5.	Turizmi dhe Aktivitetet Rikrijuese .....	79
4.4.6.	Grupet e Cenueshme.....	79
4.4.7.	Analiza Gjinore .....	80
4.4.8.	Veçoritë gjeologo-gjeomorfologjike-sedimentologjike-oqeanografike të zonës bregdetare të gjirit të Durrësit .....	80
4.4.9.	Trashëgimia Arkeologjike dhe Kulturore .....	81
4.4.10.	Infrastruktura dhe rrugët e Aksesit në zonë .....	84
4.5.	Receptorët Sensitiv Kryesorë të Identifikuar Fillimisht.....	86
5.	ANGAZHIMI I GRUPEVE TË INTERESIT .....	87
5.1.	Objektivat .....	87
5.2.	Identifikimi i Grupeve të Interesit.....	88
5.3.	Përmbledhje e procesit të angazhimit të grupeve të interesit në kuadër të VNMS-së. ....	90
5.4.	Konsultimi publik gjatë fazës së përcaktimit të fushëveprimit.....	91
5.5.	Mekanizmi i Ankesave .....	92
5.6.	Studim bazë socio-ekonomik .....	93
6.	IDENTIFIKIMI FILLESTAR I PASOJAVE TË MUNDSHME .....	95
6.1.	Hyrje 95	
6.2.	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor .....	96
7.	PLANI I PROPOZUAR PËR VNMS-në.....	104
7.1.	Hyrje 104	
7.2.	Studimi fillestar .....	104
7.2.1.	Përcaktimi i Zonave të Influencës (ZI) për Projektin .....	106
7.2.2.	Studimet nga zyra .....	106
7.2.3.	Studime të identifikuara të specializuara .....	108
7.2.3.1.	Studime për biodiversitetin .....	108
7.2.3.2.	Cilësia e tokës dhe e ujit .....	115
7.2.3.3.	Baza socio-ekonomike .....	115
7.3.	Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit .....	122
7.3.1.	Identifikimi dhe Karakterizimi i Ndikimeve.....	122
7.3.2.	Vlerësimi i ndikimeve .....	123
7.3.3.	Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve .....	124
7.3.4.	Mundësitë e marrjes së masave zbutëse dhe ndikimi pas zbatimit të tyre.....	124
7.3.5.	Ndikimet Kumulative .....	125
7.4.	Struktura e propozuar e Raportit të VNMS-së .....	125
8.	PËRFUNDIME .....	128
	Shtojca I. Lista e Kontrollit të Fushëveprimit.....	130
	Shtojca II. Projektet që po zhvillohen në zonë .....	141
	Shtojca III. Përmbledhje e Takimeve të Palëve të Interesit .....	142

## Figurat

Figura 1. Kapaciteti I Operimit dhe Mirëmbajtjes së Voltalias .....	11
Figura 1. Vendndodhja rajonale e projektit .....	14
Figura 2. Vendndodhja e projektit dhe rrethet/fshatrat e afërt në zonën e projektit.....	15
Figura 3. Përmbledhje skematike të Sistemit të një Parku Fotovoltaik (IFC, 2015) .....	17
Figura 4. Paraqitja fillestare e projektit.....	18
Figura 5. Opsionet e përgjithshme të vendndodhjes së projektit dhe linjës së transmetimit .....	19
Figura 6. Procedura për VNM Paraprake dhe GI&P e afatet kohore sipas Legjislacionit Shqiptar .....	29
Figura 7. Harta topografike e zonës dhe gjurma e projektit të propozuar .....	49
Figura 8. Trëndafili i erës .....	51
Figura 9. Përqendrimi mesatar vjetor i NOx në sfond (Burimi: Të dhënat e Interpolimit të AEM, 2005) .....	53
Figura 10. Përqendrimi mesatar vjetor të SO <sub>2</sub> në sfond (Burimi: Të dhënat e Interpolimit të AEM, 2005) .....	54
Figura 11. Harta Hidrologjike .....	55
Figura 12. Sistemi/rrjeti i kanalit të kullimit.....	57
Figura 13. Rrjeti ekzistues i kullimit - Harta topografike.....	57
Figura 14. Harta e Përmblytjeve (Burimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar - Harta e Rrezikut Gjeologjik Shqiptar).....	59
Figura 15. Pellgje uji në zonën e studimit .....	60
Figura 16. Kanali dytësor në zonën e studimit.....	60
Figura 17. Kanali dytësor në kufirin verior .....	60
Figura 18. Stacioni i pompave në Porto Romano .....	61
Figura 19. Kanali në stacionin e pompave (majtas) dhe shkarkimi në det (djathtas) .....	61
Figura 20. Harta e përdorimit të tokës në zonën e projektit.....	62
Figura 21. Harta e mbulesës së tokës në zonën e projektit.....	63
Figura 22. Harta e zonës së mbrojtur .....	65
Figura 23. Pamje të florës brenda zonës së projektit FV .....	67
Figura 24. Pamje përgjatë kanaleve të kullimit .....	67
Figura 25. Harta e mbulesës së tokës .....	68
Figura 26. Foto 4016. Bufotes viridis i mitur pas përfundimit të metamorfozës.....	69
Figura 27. Foto 4091. Emys orbicularis dhe Mauremys rivulata duke pushuar përgjatë kanalit kryesor të kullimit të Spitalës.....	69
Figura 28. Foto 4025. Juvenile of <i>Hyla arborea</i> .....	70
Figura 29. Foto 4132. <i>Natrix natrix</i> .....	70
Figura 30. Foto 4324. Pelophylax kurtmuelleri (i rritur) të pellgu përgjatë kanalit kullues dytësor .....	70
Figura 31. Foto 4349. Gjurmët e freskëta të Emys orbicularis në terren me baltë përgjatë një pellgu të mbushur .....	70
Figura 32. Çafkë gjedhe ( <i>Bubulcus ibis</i> ) që shoqëron bagëtinë duke kullotur në tokë të braktisur bujqësore.....	71
Figura 33. Glareola pratincola (rreth 80 ind) e vërejtur në afërsi të ZZHP Spitala, drejtimi V-L .....	71
Figura 34: Ish-tokë e punueshme e përdorur për kullotje; .....	71
Figura 35. <i>Athene noctua</i> .....	71
Figura 36: Kanali dytësor i drenazhimit: Kanalet e kullimit / Habitatet evropiane përfshijnë 72A0 Shtretër kallamishte ( <i>Phragmito-Magnocaricetea</i> ); .....	72
Figura 37: Secondary Drainage Channel: Drainage Channels / European Habitats include 72A0 Reed beds ( <i>Phragmito-Magnocaricetea</i> );.....	72
Figura 38: <i>Idotea baltica</i> dhe <i>Chironomus salinus</i> .....	73
Figura 39. Mbulesa e Tokës në Zonën e Parkut FV .....	77
Figura 40. Mbulesa e Tokës në Zonën e Parkut FV .....	77
Figura 41. Mbulesa e Tokës në Zonën e Parkut FV .....	78
Figura 42. Harta e Trashëgimisë Kulturore në Zonën e Projektit .....	84
Figura 43. Harta e Rrugëve në Afërsi të Impiantit FV.....	85
Figura 44. Harta që tregon Zonën e Studimit Bazë/Zona direkte e Influencës.....	105

## Tabelat

Tabela 1. Koordinatat e zonës së përzgjedhur .....	12
Tabela 2. Koordinatat e zonës së nënstacionit .....	13
Tabela 3. Programi i ndërtimit .....	21
Tabela 4. Legjislacioni shqiptar për një VNM.....	25
Tabela 5. Procesi i përgjithshëm i vendimmarrjes së VNM-së .....	27
Tabela 6. Legjislacioni shqiptar mbi Biodiversitetin që ka lidhje me Projektin.....	30
Tabela 7. Legjislacioni për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.....	31
Tabela 8. Legjislacioni në lidhje me mbrojtjen e mjedisit fizik.....	32
Tabela 9. Legjislacioni për shëndetin dhe sigurinë në punë.....	38
Tabela 10. Ligje të tjera Kombëtare që kanë lidhje me këtë projekt.....	39
Tabela 11. Legjislacioni Shqiptar për Sektorin e Energjisë .....	40
Tabela 12. Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara / ratifikuara nga Shqipëria ..	40
Tabela 13. Temperaturat mesatare gjatë vitit .....	50
Tabela 14. Reshjet mesatare gjatë vitit .....	51
Tabela 15. Drejtimi i erës (duke fryrë nga) dhe frekuenca (stacioni i portit të Durrësit) .....	51
Tabela 16. Drejtimi i erës gjatë vitit.....	51
Tabela 17. Vlerat mesatare vjetore të treguesve të ajrit për vitet 2017, 2019, 2020 ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ ) .....	52
Tabela 18. Struktura Administrative e Qarqeve Shqiptare me Bashkitë dhe Popullsinë Përkatese ....	73
Tabela 19. Rritja e popullsisë në zonë.....	74
Tabela 20. Grupet e Identifikuara të Interesit.....	88
Tabela 21. Vlerësimi i Fillestar i Ndikimit .....	96
Tabela 22. Plani i studimit të biodiversitetit.....	117
Tabela 23. Studime dhe raportime shtesë për biodiversitetin.....	117
Tabela 24. Programi i Studimeve Bazë Mjedisore dhe Sociale.....	118
Tabela 25. Matrica e rëndësisë së ndikimit.....	124
Tabela 26. Hierarkia e zbutjes .....	125
Tabela 27. Udhëzuesi i Përdoruesit për Vështrimin e Raportit të VNMS-së .....	125
Tabela 28. Lista e Kontrollit të Fushëveprimit.....	130

## SHKURTIMET

VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
KPM	Konsulent i Pavarur Mjedisor
MW	Mega Watt
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
BRE	Burimet e Rinovueshme të Energjisë
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
GW	Giga Watt
SHSM	Shëndeti, Siguria dhe Mjedisi
LTTL	Linja e Transmetimit të Tensionit të Lartë
FV	FotoVoltaik
NTRP	Nënstacioni i Transmetimit të Porto Romanos
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
LAT	Linja Ajrore e Transmetimit
TAP	Gazsjellësit Trans – Adriatik
PAGI	Plan i Angazhimit të Grupeve të Interesit
RNM	Raport i Ndërveprimit Mjedisor
ZM	Zonat e Mbrojtura
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeo-hapësinor
DRTK	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës
KE	Këshilli European
BE	Bashkimi European
PMMM	Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Mjedisit
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
KKKBNK	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike
KDB	Konventa mbi Diversitetin Biologjik
UNRN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
MMSHAE	Marrëveshja për Mbrojtjen e Shpendëve Ujorë Shtegtarë Afrikano-Euroaziatike
KTNSRR	Konventa mbi Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
BNRN	Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
KP	Koeficient Performance
KMS	Korniza Mjedisore dhe Sociale
ZZHP	Zona e Zhvillimit të Projektit
AEM	Agjencia Europiane e Mjedisit
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
SP	Standardi i Performancës
INSTAT	Instituti Kombëtar i Statistikave
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IKTK	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë
TK	Trashëgimi Kulturore
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
PJT	Përmbledhjet Jo-Teknike
ARZM	Agjencia Rajonale e Zonave të Mbrojtura
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
GI&P	Grupet e Interesit dhe të Prekura



DSH	Dokument mbi Sfondin Historik
ZI	Zona e Influencës
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
IJK	Intervistat me Informatorë Kryesor
PVZH	Planin e Veprimit të Zhvendosjes
FEM	Fushat Elektrike dhe Magnetike
BDHZP	Baza e të Dhënave Botërore për Zonat e Mbrojtura
ZKB	Zonat Kryesore të Biodiversitetit
DFG	Diskutime në Fokus Grupe
PRJ	Plan të Rivendosjes së Jetesës
PM	Pikë Monitorimi
KMTZH	Korniza e Marrjes së Tokës dhe Zhvendosjes



# 1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI RAPORTIN

## 1.1. Hyrje

Raporti i Studimit është hartuar në emër të Voltalia Ltd. (Voltalia) si pjesë e procesit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) për Projektin e Parkut Fotovoltaik të Spitallës, deri në 100 MW në Bashkinë e Durrësit në Shqipëri. Voltalia ka kontraktuar Abkons sh.p.k (Abkons) si Konsulent i Pavarur Mjedisor (KPM) për të kryer studimin e VNMS-së për Projektin.

Abkons do të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të lidhura me zhvillimin e projektit duke kryer një proces objektiv dhe të pavarur të VNMS-së, duke përfshirë informacionin dhe opinionet përkatëse të Grupeve të Interesuara dhe të Prekura (GI&P) të cilat do të mblidhen dhe do të transmetohen Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për të mundësuar një vendimarrje të informuar.

Dizajni i projektit do të evoluojë gjatë gjithë procesit të VNMS-së, me një proces projektimi përsëritës të aplikuar, ku identifikohen kufizimet specifike për vendndodhjen dhe do të merren parasysh komentet dhe sugjerimet e bëra nga palë të ndryshme të interesuara për të udhëhequr planin përfundimtar të Projektit.

VNMS do të përshkruajë se si është ndikuar nga komente të tilla dizajni i projektit dhe objektet përkatëse. Ky raport i fushëveprimit është faza e parë e procesit të VNMS-së dhe synon të identifikojë ndikimet kryesore të mundshme dhe të përcaktojë kuadrin për VNMS-në.

## 1.2. Historiku dhe Përmbledhja e Projektit

Shqipëria ka një potencial të konsiderueshëm Burimesh të Rinovueshme të Energjisë (BRE) dhe për këtë arsye përfaqëson një burim të rëndësishëm energjie në Shqipëri. Përdorimi i këtyre burimeve për prodhimin e energjisë mbështet objektivin afatgjatë të politikave energjetike të vendit, duke përfshirë mbështetjen për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtjen e mjedisit. Përdorimi i energjisë së rinovueshme mund të ndihmojë në uljen e varësisë nga importet e energjisë dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji, si dhe mund të ndihmojë në sigurinë makroekonomike dhe politike të vendit duke ulur deficitin e brendshëm buxhetor. Energjia diellore do të luajë një rol të rëndësishëm në diversifikimin nga prodhimi i hidrocentraleve dhe do të kontribuojë në axhendën e qeverisë për të pozicionuar Shqipërinë si një eksportues neto të energjisë elektrike në Ballkan.

Projekti Spitalla u krijua nga MIE me sponsorizimin e BERZH. Ai konsiston në impiantin fotovoltaik diellor me një kapacitet të instaluar deri në 100 MWp që ndodhet në bashkinë e Durrësit në Shqipëri. Vitin e kaluar, ajo iu dha Voltalia-s në vijim të një procedure tenderimi ndërkombëtar për zhvillimin, ndërtimin, financimin, vënien në punë, funksionimin dhe mirëmbajtjen e centralit PV. Pas njoftimit për dhënien e çmimit nga MIE, Voltalia themeloi Spitalla Solar sh.p.k., mjetin për qëllime të veçanta që do të strehojë të gjithë projektin dhe është zhvilluesi i projektit të propozuar Spitalla Solar PV.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) bazuar në Politikat e saja Mjedisore dhe Sociale (E&S) të vitit 2019 e klasifikoi projektin në kategorinë "B", pasi u konsiderua se ky projekt mund të ketë ndikime të mundshme negative mjedisore dhe sociale në të ardhmen, të cilat përgjithësisht janë specifike për vendndodhjen dhe/ose identifikohen dhe adresohen lehtësisht përmes masave zbutëse; për këtë arsye është e nevojshme të kryhet një Vlerësim i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) dhe rishikimi i dokumenteve shoqëruese.

Referuar Udhëzuesit të IFC-së, ky projekt klasifikohet si kategoria "B" dhe një VNMS dhe rishikimi i dokumenteve shoqëruese duhet të kryhet, ndjekur nga publikimi i tyre për një periudhë minimale prej 30 ditësh.

Githashtu edhe MTM (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit) konfirmon se për projektin, referuar Aneksit 2 sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 686 datë 29.7.2015 (i ndryshuar) për Procedurën e VNM-së.

## 1.3. Qëllimi dhe Struktura e Raportit të Studimit

Raporti Studimi, si pjesë e procesit të VNMS për Projektin, dhe VNMS-ja u zhvilluar posaçërisht për të treguar pajtueshmërinë midis huadhënësit ndërkombëtar, përkatësisht BERZH, dhe kërkesave ligjore të Shqipërisë.

Raporti identifikon çështjet mjedisore dhe sociale potencialisht të rëndësishme në lidhje me ndërtimin, operimin dhe çaktivizimin e projektit të propozuar që do të adresohen në VNMS. Kjo bëhet përmes një rishikimi të literaturës ekzistuese për zonën e projektit dhe të informacionit bazë, angazhimit fillestar me aktorët kryesorë (dhe iniciativave të tjera të konsultimit publik), si dhe vizitave në terren.

Raporti i Studimit përfshin gjithashtu një përshkrim të projektit të propozuar, infrastrukturës dhe aktivitetëve, alternativave të konsideruara dhe metodologjisë së VNMS-së që do të zbatohet. Gjithashtu është paraqitur një përmbledhje e procesit të angazhimit të palëve të interesuara. Këto çështje ndihmuan në zhvillimin e planit për të kryer VNMS-së, përfshirë edhe studimet e detajuara që do të ndërmerren. Objektivi i VNMS-së, si rezultat i gjetjeve të studimeve teknike shpesh ose informacionit të ofruar nga palët e interesuara, mund të përditësohet gjatë zhvillimit të projektit.

Duhet të theksohet se raporti i studimit nuk ka për qëllim të ofrojë informacion të detajuar për projektin, por përkundrazi është një përmbledhje paraprake e tij që synon të formojë bazën për angazhim të hershëm me palët e interesuara përkatëse dhe për të ndihmuar në identifikimin e ndikimeve kryesore të mundshme të projektit. Studimi është krijuar për të siguruar që VNMS-ja përqendrohet në ndikimet dhe çdo çështje tjetër të rëndësishme.

### Struktura e Raportit

Ky raport është strukturuar si më poshtë:

- **Kapitulli 1** prezanton Projektin, pjesëmarrësit e tij dhe qasjen e përgjithshme të procesit të vlerësimit të VNMS-së;
- **Kapitulli 2** jep një përshkrim të shkurtër të Projektit dhe alternativave të tij;
- **Kapitulli 3** përshkruan kornizë administrative dhe ligjore për Projektin;
- **Kapitulli 4** përcakton kontekstin dhe kushtet mjedisore dhe sociale të zonës së Projektit;
- **Kapitulli 5** përfshin një përshkrim të qasjes për angazhimin e palëve të interesuara;
- **Kapitulli 6** përshkruan ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të identifikuara të Projektit;
- **Kapitulli 7** ofron planin dhe qëllimin e propozuar për VNMS-në, duke përshkruar qasjen dhe metodologjinë e propozuar për vlerësimin dhe zbutjen e ndikimeve;
- **Kapitulli 8** përmbledh përfundimet dhe rekomandimet kryesore të identifikuara gjatë këtij aktiviteti.

## 1.4. Përshkrim i Projektuesit të Projektit (Votalia)

E themeluar në vitin 2005, Votalia Group është prodhues dhe ofrues i shërbimeve globale të energjisë së rinovueshme. Kompania zhvillon, financon, ndërton dhe operon centrale diellore, hibride, eolike, hidroenergjitike dhe të biomasës. Edhe pse aktiviteti kryesor i kompanisë është prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike nga centrale të pavarura të energjive të rinovueshme që zotëron vetë, Votalia Group gjithashtu ofron shërbime në lidhje me Inxhinierinë, Prokurimin, Ndërtimin (IPN), Operimin dhe Mirëmbajtjen (O&M) për energjinë që prodhon vetë dhe për palë të treta.

Me gati 800 punonjës, Votalia Group ka një prani të konsoliduar në 20 vende dhe mbulon një larmi të madhe tregjesh në Afrikë, Evropë, Amerikë Latine si dhe disa pjesë të Lindjes së Mesme dhe Azisë. Blerja e Martifer Solar në 2016 përshpejtoi rritjen dhe diversifikimin e Votalia Group drejt vendeve, teknologjive dhe modeleve të reja të biznesit.

Votalia Group ka përvojë të gjerë në Afrikë, Evropë, Amerikën Latine, Lindjen e Mesme dhe Azi. Që nga gushti i vitit 2019, Kompania ka zhvilluar mbi 2.4 GW në projekte të energjisë së rinovueshme, nga të cilat Votalia zotëron dhe operon drejtpërdrejtë një kapacitet total të instaluar prej 559.8 MW. Si ofrues i shërbimeve, Votalia ka ndërtuar gjithashtu 1.7 GW centrale (kryesisht parqe fotovoltaike) dhe aktualisht operon 1.2 GW centrale (kryesisht parqe fotovoltaike) përmes kontratave O&M.



## Figura 1. Kapaciteti I Operimit dhe Mirëmbajtjes së Voltalias

Voltalia Group ka një projekt prej 420 MW, aktualisht në një fazë të përparuar zhvillimi, që do të komisionohet brenda vitit 2020, në përputhje me synimin e kompanisë për instalimin e 1 GW, target i vendosur për vitin 2020. Brenda vitit 2020, Energjia diellore do të përfaqësojë pothuajse 20% të portofolit të kompanisë, krahasuar me vetëm 4% që ishte në vitin 2016.

### Ekspierenca dhe Ekspertiza Teknike

Grupi Voltalia ka përvojë dhe kapacitet të gjerë dhe të njohur në zhvillimin dhe ndërtimin e impianteve të energjisë së rinovueshme. Kompania ka ekipe të dedikuara IPN, të cilat përfshijnë një organ teknik inxhinierik me përvojë të gjerë në projektimin e centraleve që përdorin teknologjitë diellore, të erës dhe hidro, si dhe depot e baterive, sistemet elektrike dhe lidhjet në rrjet. Vitet e fundit, Kompania gjithashtu ka investuar në kapacitete të reja në projektimin dhe inxhinierinë e termocentraleve hibride.

Grupi Voltalia ka zhvilluar me sukses projekte në të gjithë botën, kryesisht në Evropë, Afrikën Lindore (Kenia, Tanzani), Amerikën Latine (Meksikë, Brazil, Kili) dhe Lindjen e Mesme (Egjypt, Jordan). Shumica e këtyre projekteve janë realizuar nga Kompania si kontraktori kryesor IPN. Lidhur me energjinë eolike, projekti më i madh, që Voltalia ka zhvilluar me sukses, ka një kapacitet prej 163 MW dhe është i vendosur në Serra Branca, Brazil me një kontratë 20-vjeçare për shitjen e energjisë.

Përveç shërbimeve IPN, Grupi Voltalia ofron shërbime më të mira O&M në tregun e energjisë së rinovueshme. Kompania kryen mbikëqyrjen e impiantit në kohë reale 24/7, dhe vepron me ekipet lokale O&M për të siguruar zbulimin e shpejtë të defekteve, duke zvogëluar humbjet e prodhimit të impiantit dhe duke maksimizuar të ardhurat. Kompania operon dhe mirëmban një total prej 1.19 GW të impianteve fotovoltaike dhe 616 MW në impiante eolike në botë, kryesisht në Evropë, Brazil, Jordani dhe Egjypt.

## 2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

### 2.1. Përmbledhje e projektit

Parku Fotovoltaik quhet “Parku Fotovoltaik i Spitalës” Spitala Solar dhe ndodhet në Porto Romano, Durrës. Vendndodhja e zonës së propozuar nga MIE për ndërtimin e Parkut Fotovoltaik është në zonën kadastrale nr. 8517 dhe ka një sipërfaqe prej rreth 120 ha. Si rezultat, faqosja përfundimtare e projektit mund të ndryshojë. Në të gjitha rastet, është e sigurt që gjurmët e projektit do të ketë [1] një kapacitet të instaluar deri në 100 MW, [2] një nënstacion të ngritur për të akumuluar dhe transformuar energjinë në 110 kV dhe [3] një linjë ajrore 110 kV (OHL) prej afërsisht 2 km për të transportuar energjinë elektrike dhe për t'u lidhur me rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike nëpërmjet të ardhurave duke u lidhur me zbarrat e nënstacionit 110/20 kV në nënstacionin e Porto Romanos.

### 2.2. Vendndodhja dhe drejtimi i projektit

Impianti FV i Spitalës ndodhet në rrethin e Durrësit (prefektura e Durrësit). Distanca me qytetet dhe infrastrukturat kryesore janë:

- 40 km në pjesën perëndimore të Tiranës;
- 6 km në veri të qytetit të Durrësit;
- 7 km nga Porti i Durrësit dhe nga stacioni hekurudhor i Durrësit;
- 9 km nga autostrada Tiranë-Durrës.

Impianti fotovoltaik kufizohet në veri me zonën industriale dhe energjetike të Porto-Romanos, në jug me qytetin e Durrësit, në lindje me kodrat e Shënnavlashit dhe Rrashbullit dhe në perëndim me detin Adriatik.

Zona e Parkut Fotovoltaik deri në 100 MW përfshihet në zonën e Parkut Industrial Spitalë, pranë zonës së Porto-Romanos, i cili do të zhvillohet edhe me një sërë aktivitetesh të tjera industriale të planifikuara. Vendndodhja e zonës së propozuar për ndërtimin e Parkut Fotovoltaik në Spitalë është në zonën kadastrale nr. 8517 dhe përfshinë një sipërfaqe prej rreth 120ha (Figura 3) Terreni në zonën e projektit përbëhet nga toka të kripura, të cilat e bëjnë atë të papërshtatshme për çdo aktivitet bujqësor.

Për të lidhur pajisjet diellore të parkut fotovoltaik me rrjetin, do të kërkohet infrastruktura e lidhjes së rrjetit që përbëhet nga një linjë transmetimi dhe një nënstacion. Linja e transmetimit do të ketë një kapacitet prej 110 kV dhe nënstacioni do të ketë një kapacitet prej 110 kV. Infrastruktura e lidhjes me rrjetin do të lidhë projektet e propozuara me Nënstacionin e Transmetimit të Porto Romanos (NTRP), i vendosur përafërsisht 2 km në jug-perëndim të zonës së projektit. Infrastruktura e lidhjes me rrjetin do të jetë pjesë e procesit të Vlerësimit Mjedisor.

Aktualisht po shqyrtohen dy opsione për linjën e transmetimit dhe lidhjen me nënstacionin e Porto Romanos (shih Figura 3). Opsioni më i preferuar teknikisht, mjedisor dhe social do të përcaktohet në fazat e mëtejshme të studimit, siç është procesi i VNMS-së.

Nga pikëpamja sociale, këto paraqesin skenarin më të keq, pasi këto radhitje mund të rezultojnë në ndikimet më të mëdha. Megjithatë, nga pikëpamja mjedisore, drejtimi i linjës nëpër fusha do të ishte rasti më i keq. Këto rreshtime do të studiohen dhe çdo ndryshim ose amendament, mund të ndodhë në vijim duke marrë parasysh aspektet teknike ose Mjedisore dhe Sociale (E&S).

Vendndodhja e saktë dhe koordinatat e projektit të propozuar janë paraqitur më poshtë.

Tabela 1. Koordinatat e zonës së përzgjedhur

Pikat	X_UTM_WGS84_34N	Y_UTM_WGS84_34N
1	370421.00	4579372.00

Pikat	X_UTM_WGS84_34N	Y_UTM_WGS84_34N
2	370351.00	4579499.00
3	369686.00	4580771.00
4	370202.00	4581033.00
5	370259.00	4580949.00
6	370941.00	4579639.00
7	370226.00	4581045.00
8	370564.00	4581218.00
9	370935.00	4580544.00
10	370760.00	4580456.00
11	371066.00	4579862.00
12	370924.00	4579789.00
13	370334.00	4580902.00
14	370296.00	4580912.00

Tabela 2. Koordinatat e zonës së nënstacionit

Pikat	X_UTM_WGS84_34N	Y_UTM_WGS84_34N
A	370387.00	4579451.00
B	370467.00	4579490.00
C	370426.00	4579382.00
D	370507.00	4579423.00






Figura 2. Vendndodhja rajonale e projektit




Figura 3. Vendndodhja e projektit dhe rrethet/fshatrat e afërt në zonën e projektit<sup>1</sup>

## 2.3. Nevoja për Projektin

Qeveria shqiptare po punon për një sektor energjie të besueshëm dhe më të qëndrueshëm, zhvillimi i të cilit do të bazohet në shfrytëzimin e të gjitha opsioneve energjetike për të përmbushur kërkesat në vend për energji dhe për të krijuar vlerë të shtuar për qytetarët e saj, në përputhje me parimet e përgjegjësive mjedisore, ekonomike dhe sociale.

Historikisht, prodhimi i energjisë elektrike është bërë pothuajse ekskluzivisht nga hidrocentralet. Në vitin 2017 vendi kishte një kapacitet total të instaluar prej rreth 2100 MW nga të cilat vetëm 100 MW ishte termike. Në vitin 2017 konsumi vjetor i energjisë elektrike ishte rreth 7.1 TWh me një kërkesë maksimale prej 1.4 GW.

Shqipëria importon energji elektrike edhe nga vendet fqinje. Megjithatë, këto importe kanë rënë në mënyrë progresive në dhjetë vitet e fundit pas rritjes së prodhimit të brendshëm të energjisë dhe uljes së humbjeve të energjisë elektrike, të cilat janë reduktuar nga 45% në 2013 në 23% në fund të 2018, me një plan investimi dhe menaxhimi për t'i reduktuar në 17% deri në fund të 2020.

Shqipëria është një vend që në zona të caktuara ka mesatarisht 360 ditë rrezatim diellor dhe për rrjedhojë prodhimi i energjisë nga Parku Fotovoltaik (FV) është një burim i rëndësishëm potencial i energjisë elektrike që do të ndihmojë në diversifikimin e burimeve të energjisë dhe në uljen e varësisë së saj nga hidrocentralet dhe energjia elektrike e importuar.

Sipas Strategjisë Kombëtare Shqiptare të Energjisë<sup>2</sup> 2018-2030, Shqipëria synon “Rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore me kosto të përballueshme për qytetarët shqiptarë”; parimet drejtuese të strategjisë janë:

- Rritja e besueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit me energji, duke siguruar njëkohësisht rritjen e mirëqenies;
- Zhvillimi i burimeve të brendshme primare të energjisë në mënyrë të qëndrueshme dhe konkurruese;
- Përmirësimi i efektivitetit të kostos së sistemeve të furnizimit me energji elektrike;
- Arritja e objektivave për burimet e rinovueshme të energjisë dhe eficientë të energjisë të përcaktuara në Planet Kombëtare të Veprimit për Eficientë të Energjisë dhe Burimet e Rinovueshme të Energjisë;
- Integrimi i tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe gazit natyror me Kosovën, rajonin dhe tregjet evropiane;
- Arritja e objektivave të kontributit të synuar kombëtar (NDC) për reduktimin e emetimeve të gazeve serë (GHGs).

Në këtë kontekst, investimi dhe zhvillimi i projekteve FV është një element i rëndësishëm në arritjen e parimeve të kësaj strategjie, ndaj dhe ky Projekt është në përputhje me objektivat e përgjithshëm të strategjisë kombëtare shqiptare të energjisë. Projekti do të mbështesë strategjinë e Shqipërisë për të përmbushur nevojat e saj në rritje për energji dhe për të reduktuar varësinë nga importet e energjisë, duke përfituar nga veçoritë optimale të Shqipërisë për prodhimin e energjisë FV diellore.

## 2.4. Përmbledhje teknike dhe komponentët e projektit

Voltalia ka shqyrtuar një sërë modelesh dhe planesh të mundshme për impiantin; plani i përgjithshëm i projektit fotovoltaik është paraqitur në **Figurën 4** më poshtë dhe korrespondon me gjurmën e projektit në parcelat e tokës të parashikuara fillimisht nga MIE në procedurën e tenderit. Është e rëndësishme të përmendet se gjurma përfundimtare mund të ndryshojë në varësi të tokës që MIE do të përfundojë të zgjedhë për projektin e dhënë nga MIE. Në të gjitha rastet, projekti do të ketë një

<sup>1</sup> Note: For the reasons mentioned in Section 2.1, the final layout of the PV plant will be located in the vicinity of the red zone indicated in the map. The buffer area was purposely made a bit wider to foresee any change of the PV plant zone and ensure that the final design and its final buffer zone will be covered in the study.

<sup>2</sup> <https://qbz.gov.al/>



kapacitet maksimal të instaluar deri në 100 MWp. Ai do të përbëhet nga një seri modulesh dy-anëshe të montuara në një strukturë gjurmuese horizontale me një aks dhe do të japë deri në 90 MW (AC) në rrjet.

Figura 4 jep një përmbledhje të një impianti fotovoltaik diellor të lidhur me rrjetin në dobi të shërbimeve; komponentët kryesorë përfshijnë:

- **Modulet diellore FV:** Çdomodul fotovoltaik (PV Module) siguron në terminalet e tij një rrymë të drejtpërdrejtë. Këto module PV janë rregulluar në seri për të formuar një varg me një nivel tensioni të përcaktuar dhe të përvetësuar, dhe më pas vargjet grupohen paralelisht në mënyrë që të rritet rryma direkte në një vlerë të përcaktuar dhe të përvetësuar, për funksionimin korrekt të inverterit. Përcaktimi i numrit të moduleve në seri (“vargu”) është thelbësor për të garantuar që tensioni i vargut të jetë gjithmonë nën tensionin maksimal të pranueshëm DC të impiantit diellor, 1500 VDC në këtë rast. Në projektin e propozuar do të instalohen gjithsej nga 128,000 deri në 171,000 module FV, ku secili gjeneron deri në 580 W.
- **Sistemet e gjurmimit të moduleve:** Këto lejojnë që modulet FV të montohen në mënyrë të sigurt në tokë me një kënd të fiksuar të inklinimit (përkuljes), ose në kornizat e gjurmimit. Sistemi i zgjedhur i gjurmimit për Projektin është një gjurmues horizontal me një aks (orientimi Veri-Jug) me modulet FV që rrotullohen nga Lindja (lindja e diellit) në Perëndim (perëndimi i diellit), me një kënd rrotullimi 55°. Qëllimi i sistemit të gjurmimit është të maksimizojë rendimentin e Projektit duke rritur kohën e ekspozimit të moduleve fotovoltaike në diell me këndin e tyre optimal, nga orët e para deri në fund të ditës, duke rritur ndjeshëm energjinë elektrike të prodhuar në krahasim me sistemet e strukturës fikse.
- **Inverterat:** Inverteri është komponenti që konverton rrymën direkte në rrymë alternative. Pas konvertimit dhe kalimit nëpër të gjitha mbrojtjet e nevojshme, niveli i tensionit të energjisë rritet përmes një transformatori rritës (Transformator LV/MV), për të reduktuar humbjet e tij në transmetim dhe evakuohet përmes kabllave të Tensionit të Mesëm deri në Nënstacionin e brendshëm të impiantit i cili është lidhur me rrjetin e shpërndarjes (Pika e Injeksionit).. Shumë module në vargje seri dhe vargje paralele janë të lidhura me inverterat. Projekti do të kërkojë gjithsej midis 21 dhe 30 invertera.
- **Transformatorë rritës të tensionit:** Dalja nga inverterat kërkon një rritje të tensionit për të arritur nivelin e tensionit të rrjetit AC. Transformatori rritës i tensionit merr voltazhin e daljes nga inverterat (600 V) dhe e rrit deri në 20 kV, i cili më pas mbledhet dhe rritet përsëri në nën-stacionin e Projektit në tensionin e kërkuar të rrjetit prej 110 kV.
- **Ndërfaqja e lidhjes në rrjet<sup>3</sup>:** Këtu, energjia elektrike eksportohet në rrjet. Nënstacioni do të ketë gjithashtu pajisjet e kërkuara të ndërfaqes së rrjetit - të tilla si ndërprerësit (CB) dhe shkëqjet për mbrojtjen dhe izolimin e parkut FV, si dhe pajisjet e matjes. Projekti do të lidhet me Rrjetin Kombëtar Shqiptar të shpërndarjes së energjisë në Nënstacionin e Porto-Romanos që ndodhet afërsisht 2 km në jug-perëndim nga zona e projektit përmes një linje ajrore 110-kV. Rrugët e propozuara për linjën e transmetimit janë paraqitur më poshtë në **Figura 6**.

<sup>3</sup>Kompania duhet të konfirmojë se cila është lidhja më e preferuar e rrjetit në mënyrë që të identifikojë fshatrat që mund të preken.




Figura 4. Përmbledhje skematike të Sistemit të një Parku Fotovoltaik (IFC, 2015)

Projekti do të kërkojë gjithashtu një ndërtesë për të akomoduar pajisjet SCADA (Kontrolli Mbikëqyrës dhe Përvetësimi i të Dhënave) për komandimin, kontrollin dhe mbrojtjen e Projektit. Kjo do të drejtohet nga teknikët e punësuar për kontrollin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Projektit.

Përveç komponentëve kryesorë të përmendur me lart, një park FV në shkallë të gjerë kërkon gjithashtu infrastrukturën e mëposhtme:

- Kabllot lidhëse (nëntokë);
- Rrethimin dhe masat e sigurisë;
- Rrugët e aksesit;
- Objektet e magazinimit të materialeve.

Gjatë fazës së ndërtimit, do të kërkohej një ose më shumë komplekse ndërtimi të përkohshme, duke përfshirë zyrat e kantierit, magazinat për materialet dhe pajisjet etj., si dhe rrugë të përkohshme për të lehtësuar aksesin në të gjitha pjesët e kantierit të zhvillimit.

Projekti kërkon gjithashtu një linjë ajrore të transmetimit 110 kV (LAT) për të lidhur projektin me rrjetin kombëtar. Kjo do të arrihet nëpërmjet LTTL 2 km që lidh Projektin me nënstacionin që ndodhet në zonën periferike të zonës së Porto Romanos; itinerari i propozuar i LTTL shtrihet brenda qarkut të Durrësit dhe njësive administrative të Porto Romanos. Rruga e LTTL është paraqitur më poshtë në **Figura 6**

Të gjitha infrastrukturat e ndërlidhjes, fillimisht duhet të mbajnë në konsideratë që duhet të projektohen për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit në të gjitha kushtet e punës në kantier si dhe për të lehtësuar inspektimin, mirëmbajtjen dhe riparimet.



Figura 5. Paraqitja fillestare e projektit




Figura 6. Opsionet e përgjithshme të vendndodhjes së projektit dhe linjës së transmetimit

## 2.5. Vështrim i përgjithshëm i fazave dhe aktiviteteve të projektit

Fazat e përgjithshme të zhvillimit për projektet fotovoltaike diellore në shkallë të gjerë mund të klasifikohen si më poshtë:

- **Mobilizimi/Para-ndërtimi:** përgatitja e kantierit, mobilizimi i pajisjeve dhe materialeve në vend.
- **Ndërtimi dhe instalimi:** përfshinë punimet civile, punimet elektrike dhe instalimin e pajisjeve.
- **Operacioni:** funksionimi i impiantit dhe mirëmbajtja rutinë.
- **Dekomisionimi:** çmontimi i pajisjeve dhe objekteve përkatëse dhe rikthimi i vendit në gjendjen fillestare.

Kapaciteti total i propozuar i centralit FV është deri në 100 MW dhe propozohet të ndërtohet në një fazë të vetme. Ndërtimi i Projektit është planifikuar të fillojë në tremujorin e tretë të vitit 2023 dhe të jetë në funksionim të plotë në tremujorin e tretë të vitit 2024. Energjia elektrike e prodhuar nga projekti do të eksportohet nëpërmjet linjave të energjisë elektrike në nënstacionin e afërt për transmetim dhe shpërndarje nëpërmjet rrjetit kombëtar, ndërtimi i të cilit është planifikuar të bëhet paralelisht me elementin FV të Projektit.

Ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale lidhen me aktivitetet e ndërmarra gjatë fazave të ndërtimit, operimit dhe çmontimit; aktivitetet kryesore gjatë këtyre fazave janë përmbledhur në seksionet e mëposhtme.

### 2.5.1. Mobilizimi/Para-ndërtimi

Faza e mobilizimit duhet të ndodhë përpara se puna e ndërtimit dhe instalimit të fillojë në kantier. Faza e para-ndërtimit përfshin zhvillimin e projektimit të detajuar, mobilizimin dhe fazat e përgatitjes së kantierit. Projekti do të zbatohet nga Voltalia duke vepruar si kontraktor IPN. Si kontraktor IPN,



Voltalia do të jetë përgjegjëse për zhvillimin e projektimit të detajuar, ndërtimin dhe vënien në punë të impiantit.

Faza e mobilizimit përfshin porositjen e materialeve dhe pajisjeve, nënshkrimin e kontratave me nënkontraktorët dhe punësimin e personelit. Kjo fazë përfshin gjithashtu mobilizimin e punëtorëve, planifikimin dhe transportimin e komponentëve të projektit, pajisjeve dhe materialeve në kantier (p.sh. modulet FV), si dhe përgatitjen e kantierit që përfshin pastrimin, gradimin dhe nivelimin e vendit dhe ngritjen strukturave të kantierit; nuk ka plane për të siguruar strehim në kantier për punëtorët.

Pajisjet e rënda dhe pajisje të tjera do të zhvendosen në kantier me fillim e aktiviteteve të ndërtimit për aktivitetet e punës civile dhe instalimin e pajisjeve. Të gjitha modulet FV, pajisjet elektrike dhe strukturore janë planifikuar të mbërrijnë në kantier përmes rrugës në "kontejnerë". Përveç pajisjeve, projekti do të kërkonte gjithashtu mjete dhe pajisje të mëdha ndërtimi, si buldozerë, ekskavatorë, vinça etj. për montimin e strukturës.

Gjatë fazës së përgatitjes së kantierit, fuqia punëtore e nevojshme për sigurinë e kantierit, punën manuale, civile, transportin e mallrave dhe shërbime të tjera të ngjashme do të punësohet nga fuqia punëtore lokale.

### 2.5.2. Faza e Ndërtimit dhe Instalimit

Faza e ndërtimit të projektit do të përfshijë shumë aktivitete dhe faza, si:

- Ndërtimi / përmirësimi i rrugëve hyrëse të brendshme dhe të jashtme;
- Nivelimi i tokës;
- Rrethimi i kanterit;
- Instalimi i njësive të prodhimit të energjisë FV;
- Vendosja e shtyllave për montimin e strukturës;
- Ndërtimi i nënstacionit elektrik dhe themeleve;
- Gërmimi, krijimi i llogoreve dhe shtrirja e kabujve;
- Rregullimi dhe instalimet elektrike të paneleve;
- Instalimi i kamerave të sigurisë CCTV (nëse është e aplikueshme) rreth vijës së rrethojës dhe pikave të hyrjes;
- Instalimi i rezervuarit të ujit për stafin dhe aktivitetet e O&M;
- Instalimi i rezervuarit septik;
- Ndërtimi i ndërtesave;
- Ngritja e linjave të energjisë HV lart;
- Testimi dhe komisionimi i pajisjeve dhe projektit në tërësi;
- Pastrimi i zonës së projektit.

Gjatë fazës së ndërtimit, shtyllat duhet të futen në tokë për të formuar bazën strukturore të vargjeve FV. Pasi komponentët FV të kenë mbërritur në vend, teknikët do të mbikëqyrin montimin e paneleve dhe do të testojnë objektin. Panelet FV do të instalohen në konstruksione çeliku të galvanizuara. Një rrugë bazike do të mundësojë aksesin e brendshëm për aktivitetet e ndërtimit. Gjatë ndërtimit do të miratohet dhe qasja sipas fazave të projektit.

Një pjesë e kantierit do të përdoret si zonë akomodimi ku do të vendosen objektet e strehimit, pajisjet, objektet sanitare (portative) dhe kontenierët.

Për të siguruar akses në kantier nga rruga publike aty pranë, do të duhet të ndërtohet një rrugë e shkurtër aksesi në nivel të pranueshëm për transportin e pajisjeve, materialeve dhe njerëzve. Vlerësohet se do të nevojiten rreth 5 ekskavatorë/ngarkues/buldozerë për pastrimin e tokës dhe 5 deri në 10 kamionë me vinça do të nevojiten për ndërtimin. Për të ndërtuar strukturën fotovoltaike do të duhen kontenierë me ngarkesa 182-243 x 12 metra. Pasi të ketë përfunduar projekti do të shihet a është e nevojshme të gërmohet dhe mbushen me dhe' zonat dhe/ose të gropat në kantier, përgjatë rrugëve dhe në nënstacione/vendet e transformatorit.

Do të nevojiten gjithashtu ndërtesa ndihmëse si dhomat e rojeve, ndërtesat O&M, objektet e trajtimit të ujit, etj.

Kohëzgjatja e parashikuar për periudhën e ndërtimit është 3 muaj përgatitja e kantierit dhe 8 muaj për ndërtimin e tij (shih Tabela 3). Plani përfundimtar i ndërtimit do të specifikohet gjatë fazës së projektimit të detajuar bazuar në punën e përcaktuar që do të kryhet.

Deri në 200 persona pritet të punësohen gjatë fazës së ndërtimit. Këtu përfshihen rreth 20 inxhinierë me përvojë, 10 ekspertë dhe 150-180 punëtorë vendas të kualifikuar, gjysmë të kualifikuar dhe të pakualifikuar. Numri i punëtorëve në kantier do të rritet me kalimin e kohës derisa të arrihet kulmi i aktivitetit të ndërtimit dhe më pas do të fillojë të zvogëlohet ndërsa ndërtimi i afrohet përfundimit dhe Projekti hyn në fazën e vënies në punë. Strehimi i punëtorëve në kantier nuk është planifikuar si pjesë e projektit. Projekti do të synojë të punësojë për ndërtim fuqi punëtore të pakualifikuar dhe të kualifikuar nga komunitetet përreth, aty ku është e mundur, dhe punëtorët jo vendas do të akomodohen pranë banesave egzistuese pranë kantierit.

#### Linja e Transmetimit LTTL

Linja ajrore e transmetimit (LTTL) do të mbështetet dhe drejtohet nga shtyllat që do të lidhin Projektin me nënstacionin e Porto Romanos. Ndërtimi i linjës së transmetimit do të bëhet sipas favaze më poshtë:

- Puna përgatitore:
  - Mikrovendosja dhe finalizimi i vendndodhjeve të kullave dhe gjurmës së LTTL-së;
  - Mobilizimi i makinerive inxhinierike në trasenë e LTTL-së;
  - Ndërtimi i platformave për pilotat dhe shpërndarja e materialeve përgjatë gjurmës së LTTL;
- Punë ndërtimore:
  - Demarkacioni i themeleve, punimet dhe gërmimet tokësore;
  - Instalimi i themeleve dhe pajisjeve tokëzuese;
  - Montimi, instalimi, rreshtimi dhe rregullimi i pilotave;
- Puna e instalimit:
  - Vondosja dhe lidhja e telave dhe kablllove, ngritja e tyre në pilota, shtrirja dhe fiksimi në pilota;
  - Instalimi i amortizuesve kundër vibrimit dhe ndarësve në distancë, unazave të montimit;

Paraprakisht kohëzgjatja dhe skedulimi i punëve për ndërtimin e Projektit është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3. Programi i ndërtimit

Detyrat	Kohëzgjatja	Data e Parashikuar për Fillimin
Njoftimi për të vazhduar/filluar ndërtimin	1 ditë	Korrik 2023
Inxhinieria dhe prokurimi	150 ditë	Maj 2023 – Shtator 2023
Mobilizimi i zonës	20 ditë	Shtator 2023
Përgatitja e zonës	90 ditë	Shtator-Nëntor 2023
Dorëzimi i gjurmuesve dhe instalimi mekanik	150 ditë	Dhjetor 2023-Prill 2024
Dorëzimet e pajisjeve elektrike dhe instalimet elektrike	150 ditë	Mars-Qershor 2024
Komisionimi & Testimi	60 ditë	Gusht-Shtator 2024

Detyrat	Kohëzgjatja	Data e Parashikuar për Fillimin
Data e funksionimit komercial	1 ditë	Nëntor 2022

### 2.5.3. Operimi dhe Mirëmbajtja

Pasi objekti të jetë i përfunduar dhe funksional, pritet që ai të ketë një jetëgjatësi operimi prej afërsisht 30 vjetësh.

Për shkak të natyrës pasive të impianteve FV diellore, nuk ka emisione ose mbetje të gjeneruara gjatë operimit të projektit, nuk ka pajisje ose makineri të konsiderueshme që gjenerojnë zhurmë dhe nuk do të ketë materiale të rrezikshme që të ruhen në zonën e Projektit.

Projekti do të kontrollohet dhe menaxhohet përmes sistemit SCADA i cili do të drejtohet gjatë ditës nga tekninë plotësisht të kualifikuar dhe të trajnuar.

Funksionimi i përditshëm i impiantit do të përfshijë aktivitete të rregullta parandaluese dhe korigjuese të mirëmbajtjes në vend, për të mbajtur impiantin në gjendje optimale funksionimi gjatë gjithë periudhës operative, për të siguruar jetëgjatësinë e sistemit, si dhe respektimin e garancisë së prodhuesit. Mirëmbajtja parandaluese ndjek një program rutinë që synon parandalimin e defekteve dhe mbajtjen e sistemit në nivel optimal. Frekuenca e mirëmbajtjes parandaluese varet nga një numër faktorësh si teknologjia e zgjedhur, kushtet mjedisore të zonës, kushtet e garancisë dhe ndryshimet sezonale. Ai përmban, për shembull, aktivitete si pastrimi i modulit FV, mirëmbajtja e inverterit, kontrollet e integritetit strukturor të strukturës së montimit dhe prerjen periodike të bimësisë në impiant. Mirëmbajtja korigjuese kryhet në përgjigje të dështimeve, për shembull, riparimi/zëvendësimi i pajisjeve të dëmtuara ose me defekt. Aktivitetet tipike të O&M përfshijnë:

- Pastrimi mujor i moduleve FV;
- Kontrolli i bimësisë (barërat e këqija, shkurret, etj.) brenda Parkut Fotovoltaik;
- Inspektimi rutinë i të gjitha moduleve FV dhe strukturave shoqëruese, të tilla si kabllo, transformatorët, inverterat, strukturat e montimit, etj;
- Funksionimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve ndihmëse siç janë nënstacioni;
- Inspektimi dhe mirëmbajtja e linjave të transmetimit; dhe
- Inspektimi dhe mirëmbajtja e rrugëve të brendshme dhe rrugëve hyrëse.

Një nga aktivitetet kryesore gjatë fazës së funksionimit është pastrimi i rregullt i moduleve FV për të parandaluar grumbullimin e pluhurit që mund të ndikojë në performancën e tyre. Kjo ka potencialin për të konsumuar sasi të konsiderueshme uji. Për të reduktuar kërkesën për ujë, është planifikuar që modulet FV të pastrohen çdo muaj duke përdorur teknika *dry cleaning*; me pastrim të lagësht (duke përdorur ujë) është planifikuar çdo tre muaj ose nëse do të ketë një degradim në performancën e impiantit. Për pastrimin e lagësht, vlerësohet se mesatarisht kërkohet rreth 1 litër ujë për modul FV, që është e barabartë me rreth 300 m<sup>3</sup> ujë për pastrim, një total prej 1,200 m<sup>3</sup> në vit. Nuk pritet të përdoret ndonjë lëndë shtesë për pastrimin. Megjithatë, në rast përdorimi, ajo duhet të jetë biodegradueshme me ndikim të ulët mjedisor dhe të mos përmbajë komponentë organike të paqëndrueshme (VOCs), fosfate dhe klor.

Pasi të ketë përfunduar ndërtimi dhe komisionimi i linjave ajrore, ato do t'i dorëzohen Operatorit të Sistemit së Transmetimit (OST) për të menaxhuar funksionimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Uji për pastrim dhe për përdorim të pijshëm do të merret nga pusi i ujit lokal nëse është i disponueshëm në vend. Nëse jo, do të sigurohet përmes marrëveshjeve me kompani vendore si, kompani të specializuara, bashki apo stacione zjarrfikëse. Projekti do të kryejë analiza të ujërave nëntokësore dhe, në rast se kërkohet pastrim, do të bëjë trajtimin e nevojshëm të ujit.

Ngruhja elektrike është planifikuar për ndërtesat (rojet, ndërtesat O&M).

Gjatë fazës së operimit do të mundësohen gjithsej rreth 20 mundësi punësimi, duke përfshirë fuqinë punëtore të kualifikuar dhe gjysmë të kualifikuar (siç janë teknikët elektrikë dhe mekanikë si dhe specialistë mjedisorë dhe socialë) dhe punën e pakualifikuar (siç janë pastruesit e moduleve dhe personeli i sigurisë) për një kohëzgjatje prej 30 vjetësh.



## 2.5.4. Çaktivizimi dhe Mbyllja

Projekti pritet të ketë një jetëgjatësi të dobishme ekonomike prej afërsisht 30 vjet dhe infrastruktura e Impiantit do të çaktivizohet, zgjatet ose përmirësohet (nëse jepet një licencë e re) pasi të arrijë në fund të jetëgjatësisë ekonomike. Azhurnimi i projektit do të konsistonte në zëvendësimin e moduleve të vjetra FV me module të reja, rritjen e fuqisë totale të pikut të impiantit (një proces i quajtur "rimbushja e energjisë"), ose rritjen e fuqisë së impiantit duke shtuar elemente të reja të tilla si gjurmuesit, modulet FV, ose transformatorët.

Nëse Projekti do të çaktivizohet, atëherë zona e projektit do të kthehet në gjendjen e saj fillestare. Komponentët e një impianti FV mund të ripërdoren ose riciklohen. Kjo vlerë do të mbulojë kostot e çaktivizimit të impiantit dhe rehabilitimit të vendit.

Panelet FV dhe strukturat ndihmëse përbëhen nga materiale të shumta të riciklueshme, përfshirë qelqin, materialin gjysmëpërçues, çelikun, betonin, drurin, aluminin, bakrin dhe plastikën. Kur Projekti FV të arrijë fundin e jetës së tij operacionale, pjesët përbërëse do të çmontohen dhe riciklohen. Projekti do të çmontohet dhe hiqet duke përdorur pajisje konvencionale me ndikim minimal në mjedis. Këto materiale do të riciklohen ose hidhen në mënyrë të sigurt në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi në kohën e çmontimit.

Çmontimi pritet të zgjasë midis 6 dhe 12 muaj. Efektet e nxjerrjes nga përdorimi janë shpesh të ngjashme, ose më të vogla sesa efektet e ndërtimit dhe do të merren parasysh, kur është e mundur, në seksionet përkatëse të VNMS-së. Sidoqoftë, mund të ketë një shkallë të lartë pasigurie në lidhje me çmontimin pasi teknologjia dhe inxhinieria mund të zhvillohen gjatë jetës operacionale të Projektit. Një plan çmontimi, duke përfshirë afatet kohore dhe metodat e transportit, do të dorëzohet paraprakisht tek autoritetet përkatëse.

## 2.6. Alternativat e projektit

### 2.6.1. Alternativa pa projekt ose mos bëni asgjë

Me opsionin "Mos bëj asgjë", projekti i propozuar Parku Fotovoltaik Spitalla dhe linja e transmetimit përkatëse nuk do të ndërtohen, prandaj nuk do të ketë kosto të investimi kapital, dhe çdo ndikim negativ mjedisor dhe social që lidhet me ndërtimin dhe funksionimin e projektit do të shmangej; si rrjedhje përfitimet e Projektit, siç përshkruhet në seksionin 2.3 nuk do të realizoheshin.

Për më tepër, të gjitha përfitimet që Projekti FV mund t'i sjellë ekologjisë lokale përmes menaxhimit aktiv të biodiversitetit dhe eliminimit të bujqësisë brenda gjurmës së projektit duke lejuar që proceset natyrore të vazhdojnë, gjithashtu do të humbasin në skenarin e "të mos bësh asgjë". Në një kontekst më të gjerë, opsioni "Mos bëj asgjë" do të kufizonte zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe mundësitë për përmirësimin e mirëqenies sociale të njerëzve në rajon.

### 2.6.2. Format alternative të gjenerimit të energjisë elektrike

Përveç teknologjisë diellore FV forma të tjera të gjenerimit të energjisë përfshijnë energjinë termike (përdorimi i lëndëve djegëse fosile), biomasës, energjisë diellore, energjisë eolike dhe/apo energjisë bërthamore; këto opsione diskutohen më poshtë:

**Termocentrali** nuk konsiderohet si një zgjedhje e mirë pasi burimit të energjisë (si qymyri apo gazi), duhet të importohen ose prodhohen me kosto të lartë. Për shembull, përdorimi i qymyrit apo naftës vlerësohet si emetues shumë i madh i ndotjes në mjedis për shkak të djegies, për të cilat nevojiten kosto të mëtejshme për të ulur nivelin e ndotjes. Për rrjedhojë, kostot e transportit do të ishin të larta, prandaj në Shqipëri nuk ka termocentrale me qymyr. Për më tepër, gjenerimi i gazit serrë si rezultat i djegies gjatë operimit të termocentralëve është shkak edhe për ngrohjen globale dhe emetimet në ajër, të cilat janë shumë problematike.

**Energjia Bërthamore** është e kushtueshme dhe një sistem prodhimi energjie me një numër të lartë sfidash nga pikëpamja teknike, e sigurisë dhe mjedisore. Aktualisht, mundësia që të zhvillohen centrale bërthamore në Shqipëri konsiderohet si e pamundur dhe inekzistente.

**Gaz:** Shqipëria është e lidhur me rrjetet ndërkombëtare të gazit vetëm nëpërmjet Gazsjellësit Trans – Adriatik (TAP) i ndërtuar në territorin e saj. Aktualisht, prodhohet një sasi shumë e vogël gazi në vend. Megjithatë, egziston një rrjet tubacioni i vjetëruar, kryesisht jofunksional. Planet e zhvillimit të gazit do

të kërkojnë planifikim të konsiderueshëm dhe zhvillim të infrastrukturës shtesë, impiantet do të shkaktojnë emetime në atmosferë dhe do të kërkojnë sasi të konsiderueshme uji të pastër.

**Hidroenergjia:** Pothuajse 100% e energjisë elektrike të vendit të prodhuar në vend vjen nga hidrocentralet. Zona malore është shtëpia e tetë lumenjve kryesore të vendit. Lumi Drin, në veri të Shqipërisë, është lumi më i madh në vend dhe në të janë ndërtuar hidrocentralet e Fierzës (500 MW), Komanit (600 MW) dhe Vau të Dejës (250 MW). Kjo kaskadë siguron rreth 3/4 e kapacitetit total të energjisë elektrike në vendit dhe 90% të prodhimit të brendshëm të energjisë elektrike. Megjithatë, qëndrueshmëria e një projekti hidroelektrik varet tërësisht nga disponueshmëria e burimeve dhe topografisë së duhur për të mundësuar ndërtimin dhe funksionimin e një objekti të tillë. Një projekt hidroelektrik nuk është i realizueshëm në vendin e propozuar të Projektit.

**Energjia eolike (e erës):** energjia e erës konsiderohet e panjohur në Shqipëri; balancimi i kërkesës dhe ofertës shihet si sfidues dhe burimi i energjisë jo i vazhdueshëm. Ekonomia e projekteve të erës varet tërësisht nga disponueshmëria e burimeve të mjaftueshme të erës në një vend të caktuar. Burimet e erës në vendin e propozuar të Projektit janë të panjohura. Për më tepër, një impiant eolik paraqet gjithashtu rreziqe për shpendët vendase dhe shtegtarë, dhe duke pasur parasysh afërsinë e zonave me Parkun Kombëtar të Mbrojtur të Spitallës, i njohur për rëndësinë e tij për speciet e shpendëve, kjo do të përfaqësojë një rrezik serioz ekologjik .

### 2.6.3. Alternativat për vendndodhjen e Impiantit

Vendndodhja e propozuar për Parkun FV ishte përcaktuar nga Ministria e Infrastrukturës së Shqipërisë, prandaj nuk mund të ndryshohet. Elementi i vetëm i projektit që mund të projektohet në mënyra të ndryshme është rruga e LTTL-së.

Parimi për projektimin e LTTL-së është që të shmangen sa më shumë që të jetë e mundur zonat e mëposhtme:

- Zonat e banuara;
- Zonat e pyllëzuara dhe në mënyrë absolute shmangia e shpyllëzimeve;
- Tokat bujqësore, veçanërisht me vreshta dhe pemishte;
- Parqet dhe rezervatet natyrore;
- Zonat gjeologjike të paqëndrueshme;
- Peisazh i veçantë ose me vlerë arkitektonike dhe historike.

Gjurma e LTTL-së do të marrë në konsideratë kufizimet e përdorimit të tokës në zonën përreth saj që janë të detyrueshme sipas legjislacionit shqiptar, si dhe tokën e nevojshme për bazat e shtyllave. Për më tepër, VNMS-ja do të identifikojë zonat e ndjeshme ekologjike. Gjetjet e VNMS do të përdoren për të informuar përzgjedhjen përfundimtare të gjurmës në këtë zonë, për të minimizuar më tej, aty ku është e mundur, potencialin e zhvendosjes ekonomike në lidhje me përdorimin e tokës bujqësore, si dhe për të kufizuar ndikimin e mundshëm ekologjik.

Besohet se qasja e propozuar, përfshirë gjetjet dhe rekomandimet e VNMS-së për projektin përfundimtar të gjurmës së LTTL-së, do të përmbushë parimet e renditura më sipër.

## 2.7. Rishikimi i Projektit

Dizajni i projektit do të evoluojë gjatë procesit të VNMS-së, nëpërmjet një procesi përsëritës të aplikuar, ku do të identifikohen kufizimet specifike të zonës dhe kriteret e dizajnit për të arritur në dizajnin përfundimtar të Projektit. Nëse është e nevojshme, disa nga zonat e Projektit mund të mos zhvillohen në mënyrë që të shmangen, zvogëlohen ose hiqen efektet e rënda negative ose për shkak të kufizimeve fizike.

Procesi rishikimit të projektit do të marrë parasysh komentet e bëra gjatë konsultimit, përfshirë edhe përgjigjen ndaj këtij Raporti të Studimit. VNMS-ja do të përshkruajë se si hartimi i Projektit dhe objektet shoqëruese janë ndikuar nga këto komente.

## 3. KUADRI LIGJOR

### 3.1. Hyrje

Seksioni i mëposhtëm paraqet kërkesat rregullatore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe standartet e lidhura me menaxhimin e risqeve të SHSM të aplikuara në projekt.

### 3.2. Kërkesat Kombëtare Ligjore

Sipas legjislacionit specifik në Shqipëria nevojitet Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis. Ligji i vitit 2002 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" vendosi disa kërkesa, përfshirë detyrimin për të kryer një VNM dhe për të marrë një leje mjedisore përpara fillimit të një projekti. Ky ligj parashikon kërkesat për monitorim për të ndihmuar në identifikimin e ndikimeve të projektit gjatë ndërtimit, operimit dhe çmontimit, si dhe kërkesat gjatë fazës së mbylljes së projektit. Ligji i vitit 2002 u zëvendësua me ligjin nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, i cili synon të pasqyrojë direktivat e Bashkimit Evropian dhe praktikatat më të mira në lidhje me menaxhimin e mjedisit. Ligji i vitit 2011 mbi Mbrojtjen e Mjedisit (i ndryshuar) përcakton kuadrin e mbrojtjes së mjedisit, kuadrin dhe kompetencat institucionale, parimet e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe lejet mjedisore. Ai i përcakton aktivitetet që ndikojnë në mjedis si "çdo aktivitet ekonomik dhe social që përdor mjedisin ose një pjesë të tij, ose që shkarkon materiale dhe energji duke i ndryshuar karakteristikat e tij".

Kuadri ligjor për procedurën e VNM-së në Shqipëri bazohet në Ligjin Nr. 10440 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", miratuar më 07.07.2011 dhe më pas me Ligjin Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 07.07.2011, Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 10 448, datë 14.07.2011 "Për Lejet Mjedisore", të ndryshuar. Një kuadër i rëndësishëm ligjor për VNM-në është gjithashtu VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", të ndryshuar, dhe VKM nr. 247, data 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".

Kuadri ligjor dhe procedural i rëndësishëm për ndërmarrjen e VNM-së është dhënë në Tabela 4 më poshtë.

Tabela 4. Legjislacioni shqiptar për një VNM

Legjislacion	Përmbledhje	Lidhja Me Projektin
Ligji Nr 10431 (09.06.2011) Ndryshuar	"Për Mbrojtjen e Mjedisit" (i ndryshuar) - Ky ligj përcakton kuadrin ligjor të mbrojtjes së mjedisit, kornizën dhe kompetencat institucionale, parimet e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe lejet mjedisore. Ligji bazohet në parimet e Bashkimit Evropian dhe praktikatat më të mira të menaxhimit të mjedisit.	Duhet të kryhet VNM-ja dhe të merret leja mjedisore përpara se të fillohet një Projekt. Ligji përcakton kërkesat monitoruese për të identifikuar ndikimet e projektit gjatë ndërtimit, funksionimit dhe rehabilitimit, si dhe kërkesat gjatë fazës së mbylljes së projektit.
Ligji Nr 10440 (07.07.2011) ndryshohet	"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" (i ndryshuar) përcakton parimet e një VNM-je, përcakton kategoritë e projekteve me ndikim në mjedis dhe përcakton përgjegjësitë dhe të drejtat e institucioneve dhe publikut në procedurën e VNM-së. Ligji përcakton kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) për sa i përket procedurës, shqyrtimit e raportit të VNM-së dhe miratimin përfundimtar të tij.	VNM për Projektin do t'i paraqitet MTM dhe AKM për kontroll, shqyrtim dhe miratim.

Legjislacion	Përmbledhje	Lidhja Me Projektin
Ligji Nr 10448 (14.07.2011) Ndryshuar	"Për lejet mjedisore" (i ndryshuar) - përcakton kushtet dhe termat e dhënies së lejeve mjedisore për operatorët industrialë dhe përcakton masat për parandalimin dhe kontrollin e shkarkimit të ndotjeve dhe menaxhimin në mënyrë të sigurt të kimikateve. Në përgjithësi, objekti i kuadrit rregullator është: të parandalojë dëmtimin e mjedisit; të garantojë përputhjen me standardet e shëndetit; dhe mbrojtjen nga çdo detyrim i mbetur.	Deklarata e mjedisit zbatohet për ndërtimin e parkut fotovoltaiik (rregulluar me ligjin 10440/2011)
VKM 686 (29.07.2015) Ndryshuar	"Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", të ndryshuar - Akti përcakton rregullat specifike dhe të hollësishme për procedurën, kuadrin dhe strukturën e raportit dhe shtojcave të VNM-së, afatin kohor të procedurës, kërkesën për aprovim, vendimin përfundimtar dhe monitorimin e ndikimit dhe raportimin gjatë ekzekutimit të projektit.	Raporti i VNM përgatitet në përputhje me këtë VKM.
VKM Nr 247 (30.04.2014)	"Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" - Akti përcakton kërkesat specifike për konsultimin me grupet e interesit, duke u fokusuar në konsultimet me komunitetet lokale. Gjithashtu jep detaje mbi procedurën që duhet ndjekur, afatin kohor dhe botimin në media.	Grupet e interesit do të angazhohen / konsultohen gjatë procesit të VNM; një Plan i Angazhimit të Grupeve të Interesit ( <b>PAGI</b> ) është zhvilluar dhe implementuar nga zhvilluesi dhe konsulenti..

### 3.2.1. Procedura e Aprovimit Mjedisor

Të gjitha projektet që mund të kenë ndikim në mjedis, duhet të kryejnë një VNM para fillimit të zbatimit të tyre. Raporti i VNM-së dhe dokumentet e tjera të nevojshme do t'i paraqiten MTM-së e cila do t'i transferojë dosjet e projektit në AKM për shqyrtim. Projekti duhet të miratohet me Vendim / Deklaratë Mjedisore të AKM-së dhe MTM-së. Procedura e VNM-së është e detajuar në VKM Nr. 686 datë 29.07.2015 "për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" të ndryshuar.

Dokumenti bazë që mbështet procesin e VNM-së, është Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- Raporti paraprak i VNM-së, për projektet e Shtojcës II;
- Raporti i thelluar i VNM-së, për projektet e Shtojcës I.

Bazuar në kërkesat ligjore të Ligjit Nr. 10440/2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" i ndryshuar, Shtojca II, Pika 3, Industria e energjisë; Projekti bie në kategorinë e mëposhtme përkatëse:

- Instalime industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit ose ujit të nxehtë (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I).

Pjesë e konsultimit të studimit është marrja e konfirmimit nga AKM nëse projekti i propozuar në përgjithësi i nënshtrohet kërkesave të një VNM të thelluar sipas Ligjit Nr. 10440/2011 ose procedurës paraprake të VNM. "Vendimi" është dokumenti zyrtar i lëshuar nga AKM-ja, në të cilin vendoset nëse një projekt i Aneksit II duhet t'i nënshtrohet apo jo procedurës së thelluar të VNM-së.

Gjatë takimit fillestar konsultativ me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) në shtator 2021, ata konfirmuan se projekti konsiderohet të mbulohet nga Aneksi 2 dhe i kategorizuar për VNM Paraprake.

Një përmbledhje e procesit të përgjithshëm të vendimmarrjes së VNM-së është paraqitur më poshtë në Tabela 5

Grafiku i procedurës së VNM-së së bashku me afatet kohore ilustron në Figura 7 më poshtë.

Tabela 5. Procesi i përgjithshëm i vendimmarrjes së VNM-së

Hapi	Veprimi	Afati kohor	Dokumentet për tu përgatitur
Shqyrtimi / Klasifikimi	<p>Bazuar në kapacitetin / specifikimet e projektit, kryhet një vetë-klasifikim i projektit sipas Shtojcës I (VNM të thelluar) ose Shtojcës II (VNM Paraprake) të Ligjit për VNM, Nr. 10440, datë 07.07.2011.</p> <p>a) <b>Nëse projekti bie në Shtojcën 1</b>, aplikimi i VNM-së fillon me përgatitjen e Raportit të Ndërveprimit Mjedisor (RNM) dhe vazhdon me procedurën e thelluar të VNM-së;</p> <p>b) <b>Nëse projekti bie në Shtojcën 2</b>, Konsulenti përgatit studimin paraprak të VNM-së dhe vazhdon me procesin Paraprak të VNM;</p> <p>c) <b>Nëse projekti nuk bie në asnjë nga Shtojcat</b>, atëherë Konsulenti kërkon opinionin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM).</p>	---	----
VNM paraprake	<p>Sipas pikës "b" sipër Konsulenti përgatit dhe aplikon VNM-në paraprake.</p> <p>AKM mund ta pranojë këtë procedurë, dhe gjithashtu mund të kërkojë informacion shtesë. Pastaj AKM do të konsultohet me palët e interesuara të shtetit (në nivel kombëtar dhe lokal) dhe do të vazhdojë me një vendim / aprovim ose jo.</p> <p>Nëse AKM konsideron se Studimi Paraprak i VNM-së nuk është i mjaftueshëm për projektin (për shkak të çështjeve të tilla si zonat e mbrojtura, zonat e ndjeshme, çështjet ekonomike natyrore ose sociale), ajo do të kërkojë studime të mëtejshme dhe për të zbatuar një Procedurë të thelluar të VNM-së.</p>	45 ditë për të marrë një vendim / një aprovim dhe deklaratë	Raport teknik për projektin e propozuar, Raporti preliminar i VNM-së, Pagesa prej 30'000 lekë për AKM
Raporti Ndërveprimit Mjedisor (RNM)	<p>Konsulenti përgatit dhe dërgon RNM-së si hapin e parë të Procedurës së thelluar të VNM.</p> <p>AKM konsulton RNM me palët e interesuara shtetërore, konfirmon procedurën dhe dërgon</p>	45 ditë për të marrë një vendim dhe rekomandë	Raporti i Ndërveprimit Mjedisor (RNM) Nuk kërkohet pagesë

Hapi	Veprimi	Afati kohor	Dokumentet për tu përgatitur
	rekomandime ose kërkesa për studime shtesë që do të kryhen gjatë studimit të thelluar të VNM;	me	
Konsultimi publik	Konsulenti përgatit kërkesën për dëgjim publik; AKM publikon RNM për 20 ditë (në faqen e web-it të AKM-së); Konsulenti shpërndan njoftimin për dëgjim publik (vendi, data dhe koha) në TV, radio, gazeta;	Pas 20 ditësh nga aplikimi, organizoni dëgjimin publik	RNM dhe aplikimi për dëgjim publik. Nuk kërkohet pagesë për aplikim; Pas dëgjimit publik: Raporti i konsultimit publik, që përmban: Prezantim për palët e interesuara, Minutat e diskutimeve; Formulari i konsultimit dhe nënshkrimi i palëve të interesuara. Kostot e botimeve dhe dëgjimit publik që do të mbulohen nga Zhvilluesi;
VNM e thelluar	Konsulenti paraqet paketën e thelluar të VNM-së tek MTM; MTM përcjell aplikimin në AKM; AKM konsultohet raportin e VNM me palët e interesit dhe mund të kërkojë informacion shtesë; AKM merr një vendim, miraton ose jo raportin e VNM-së; Nëse miratohet, MTM lëshon një deklaratë të VNM Zhvilluesit / Konsulentit	60 ditë për të marrë deklaratën e VNM-së.	Paketa VNM përmban: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Raporti teknik për projektin e propozuar,</li> <li>• Përmbledhje jo-teknike e raportit të thelluar të VNM-së</li> <li>• Raporti i thelluar i VNM-së,</li> <li>• Raporti i konsultimit publik</li> <li>• Pagesa prej 50,000 lekë për AKM</li> </ul>






Figura 7. Procedura për VNM Paraprake dhe GI&P e afatet kohore sipas Legjislacionit Shqiptar

Sipas Ligjit Nr.10440/2011 (neni 11), në përfundim të procesit të VNM-së, AKM-ja do të vendosë nëse do të lëshohet një Deklaratë e Mjedisit ose nëse kërkohen studime të mëtejshme (d.m.th. VNM e thelluar). Është parashikuar që në fund të procesit të VNM-së, si rrjedhojë e aplikimit të bërë, të lëshohet një Deklaratë Mjedisore nga Ministria. Dokumentet që duhet të paraqiten në MTM së bashku me aplikimi për Deklaratën e Mjedisore janë:

- Raporti i Ndërveprimit Mjedisor; BRE
- Raporti i plotë i VNM-së;
- Përmbledhje jo-teknike;
- Raport teknik përmbledhës mbi projektin;
- Një përmbledhje e procesit të konsultimit me publikun dhe palët e tjera të interesuara, të bëra gjatë procesit të VNM;
- Një kopje e pagesës së tarifës së shërbimit, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës.
- Institucionet kombëtare, rajonale dhe lokale që kanë një rol gjatë procesit të VNM-së janë:
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Drejtoria Rajonale e Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;



- Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura;
- Bashkia Durrës;

Përveç legjislacionit që lidhet posaçërisht me nevojën për një VNM, ekzistojnë politika, ligje dhe rregullore kombëtare të zbatueshme për Projektin e propozuar dhe aspektet e tij mjedisore dhe sociale. Për më tepër, Shqipëria ka zhvilluar standarde mjedisore që bazohen kryesisht në direktivat e Komisionit Europian. Standardet ekzistuese përfshijnë: mbrojtjen e biodiversitetit; trashëgiminë kulturore, emetimet në ajër; nivelet e zhurmës, cilësinë e ujit dhe ujrave të zeza dhe menaxhimin e mbetjeve.

### 3.2.2. Kuadri i Mbrojtjes së Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura

**MTM** është përgjegjëse për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore në Shqipëri, përfshirë mbrojtjen e mjedisit, burimet pyjore, biodiversitetin, kullotat dhe burimeve ujore. Biodiversiteti në Shqipëri mbrohet me legjislacion të veçantë dhe me masa praktike, siç është parashikuar në sistemin e Zonave të Mbrojtura (ZM). Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e biodiversitetit dhe rëndësia për projektin është përmbledhur në Tabela 6 më poshtë.

Pushteti qendror aktualisht është duke ristrukturuar dhe decentralizuar sistemin e administrimit dhe menaxhimit të mbrojtjes së natyrës, duke u përqendruar kryesisht në burimet pyjore dhe kullotat. Qëllimi është të forcohet kuadri ekzistues politik dhe rregullator; të krijonjë një administrim më efektiv të ZM-ve, të mundësojnë pjesëmarrjen dhe përfshirjen aktive të pushteteve vendore në menaxhimin e ZM-ve, zonave pyjore dhe kullotave, të lehtësojnë trajnimin adekuat të personelit administrativ, si dhe të ofrojnë mbështetje financiare dhe asistencë teknike për menaxhimin e FV dhe konservim të biodiversitetit.

Tabela 6. Legjislacioni shqiptar mbi Biodiversitetin që ka lidhje me Projektin

Legjislacioni	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
Bio-diversiteti		
Ligji nr. 9587 (20.07.2006)	"Ligji për mbrojtjen e Biodiversitetit" (i ndryshuar) - Ky ligj përcakton kërkesat për ruajtjen dhe mbrojtjen e diversitetit biologjik, përfshirë zonat e mbrojtura, habitatet dhe speciet e ndjeshme. Ligji kërkon një vlerësim biologjik si pjesë të vlerësimit mjedisor dhe mbledhjes së të gjitha të dhënave përkatëse për procesin e vendimmarrjes.	Karakterizimi bazë i biodiversitetit të Zonës së Projektit në VNM, përfshin një përshkrim të zonave të mbrojtura, habitateve dhe specieve të ndjeshme bazuar në studimin të literaturës së disponueshme, të plotësuar me të dhënat e mbledhura si pjesë e studimeve bazë në terren. Vlerësimi i ndikimit merr parasysh ndikimet e mundshme në biodiversitet dhe propozon masa zbutëse për mbrojtjen e biodiversitetit.
Zonat e Mbrojtura		
Ligji nr. 81/2017, datë 04.07.2017	"Për Zonat e Mbrojtura" - Ky ligj rregullon të gjitha çështjet që lidhen me Zonat e Mbrojtura në Shqipëri. Ai përcakton kategoritë e zonave të mbrojtura në Shqipëri, rregullat e menaxhimit dhe rolet në procesin e vendimmarrjes. Ai presupozon respektimin e rregullave specifike për aksesin, punën dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjetër të lidhur në afërsi dhe/ose brenda zonave të mbrojtura	Aktiviteti ndërtimor i Projektit nuk ndodhet afër ndonjë zone të mbrojtur.
Urdhër nr. 1280, datë	"Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës së egër" (i ndryshuar) - Ky urdhër përcakton statusin e ruajtjes së llojeve të	Është bërë studimi i specieve me interes ruajtjeje bazuar në literaturën dhe studimet e fundit të kryera. Do të kryhen studime të mëtejshme brenda fushës së veprimit të

Legjislacioni	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
20.11.2013	florës dhe faunës në Shqipëri	procesit të VNM-së.

Ligji Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura" përcakton kategoritë e ndryshme të Zonave të Mbrojtura në Shqipëri dhe mënyrën e menaxhimit të tyre. Ligji shqiptar nr. 81/2017 për zonat e mbrojtura (ZM) përcakton 7 kategori zonash të mbrojtura, secila me shkallë të ndryshme mbrojtjeje, që janë gjetur të jenë të pranishme në fushën e studimit:

Rezervë strikte natyrore / rezervat shkencor (Kategoria I);

Park Kombëtar (Kategoria II);

Monument Natyror (Kategoria III);

Park Natyror Bashkiak (Kategoria IV);

Peizazh i mbrojtur (Kategoria V);

Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (Kategoria VI);

Zona të mbrojtura me interes ndërkombëtar (nuk ka kategori specifike mbrojtjeje).

Përcaktimi i kategorisë nuk përcakton domosdoshmërisht mbrojtjen që i ofrohet një zone specifike. Informacion shtesë për zonat e mbrojtura në zonën e studimit jepet në seksionin 4.

### 3.2.3. Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore

Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe rëndësia për projektin është përmbledhur në Tabela 7

Tabela 7. Legjislacioni për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

Legjislacioni	Përmbledhje	Lidhja me Projektin
Ligji nr. 27/2018, datë 17.05.2018	"Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" - Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore në Shqipëri rregullohen nga ky ligj. Ligji përcakton procedurat e ruajtjes dhe gjetjeve të rastësishme (objektet arkeologjike ose sendet me vlerë për trashëgiminë kulturore të cilat janë zbuluar rastësisht) që do të përdoren gjatë zbatimit të Projektit.	Monumentet e trashëgimisë kulturore pranë zonës së projektit janë identifikuar paraprakisht, bazuar në të dhënat e marra nga literatura dhe portali i Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG). Studime të mëtejshme do të kryhen gjatë VNM-së bazë.
Neni 146 i ligjit	Kërkon dhe detyron këdo që zbulon ose gërmon rastësisht objekte me vlerë për trashëgiminë kulturore gjatë punimeve të ndërtimit, të pezullojë menjëherë punën dhe të informojë autoritetet përkatëse lokale brenda tri ditëve. Autoritetet lokale përkatëse përbëhen nga zyra e qeverisjes vendore (Bashkia), Komisariati i Policisë dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (RDCH - DRTK) DRTK-ja verifikon situatën / gjetjet dhe raporton në Institutin e Monumenteve të Kulturës (KPM - IMK). Këto institucione janë përgjegjëse për vlerësimin e vlerës arkeologjike të objekteve të gjetura dhe përcaktimin nëse puna mund të vazhdojë ose nëse duhet pezulluar derisa të ndërmerren studime të mëtejshme.	Procedura për gjetjet të rastësore do të zhvillohet dhe zbatohet përpara ndërtimit të Projektit dhe, në rast të një gjetje të rastësishme, autoritetet do të njoftohen sipas nevojës. Autoriteti lokalë përgjegjës për ruajtjen, restaurimin dhe menaxhimin e monumenteve të kulturës është DRTK-ja, e cila është nën autoritetin e Ministrisë së Kulturës. Drejtoria rajonale që aplikon për këtë projekt është DRTK-ja e Qarkut Tiranë.

Legjislacioni	Përmbledhje	Lidhja me Projektin
Neni 5, paragrafi 64 dhe neni 31	Përcakton ruajtjen e trashëgimisë kulturore jo materiale nëpërmjet masave që synojnë ruajtjen afatgjatë të pasurive të tilla kulturore.	Deri në këtë moment projekti nuk ka identifikuar pasuri kulturore të paprekshme (jo materiale).

### 3.2.4. Kuadri ligjor i mbrojtjes fizike të mjedisit

Shqipëria ka zhvilluar legjislacionin për mbrojtjen fizike të mjedisit, ku përfshihen udhëzimet, pragu dhe kufiri i emetimit. Legjislacioni në lidhje me shkarkimin e ujit, emetimin e ajrit, zhurmës, emetimin nga automjetet dhe pajisjet, cilësinë e karburantit, mbetjet dhe ujërat e zeza është përmbledhur në Tabela 8.

Tabela 8. Legjislacioni në lidhje me mbrojtjen e mjedisit fizik

Legjislacioni	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
Uji		
Ligji Nr. 111/2012 i ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018	“Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” bazuar në direktivën 2000/60/KE mbi kuadrin ujor. Qëllimi i ligjit përqendrohet në: (i) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre; (ii) mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike. Ky ligj jep përkufizimin e trupave ujorë dhe vendos disa masa mbrojtëse dhe kufizime përdorimi dhe kërkon që të miratohen të tjera me akte nënligjore. Ligji përcakton brigjet e burimeve ujore, kufizimin e veprimtarive të caktuara të dëmshme ndërtimore në brigje <sup>4/</sup> dhe zonat ujore të mbrojtura.	Me qëllim mbrojtjen e ujërave dhe ekosistemeve ujore është e nevojshme të ndërmerren masa të posaçme mbrojtëse. Bazuar në këtë ligj dhe ligje të tjera përkatëse, përcaktohen zonat e mbrojtura. Zonat e mbrojtura mund të përfshijnë si më poshtë: a) zonat higjieno-sanitare të mbrojtura për ujë të pijshëm; b) zonat e kultivimit të peshkut dhe butakëve, sipas legjislacionit për peshkimin; c) zonat për banjat termale dhe rekreacionit; d) zonat e prirura ndaj eutrofikimit dhe zonat në rrezik nga nitratet; e) zonat e destinuar për mbrojtjen e njerëzve, bimëve apo kafshëve, ose të habitateve ku ruajtja apo përmirësimi i statusit të ujërave është një element i rëndësishëm i mbrojtjes së tyre. Ministri përgjegjës për mjedisin, me propozim të Këshillit të Basenit Ujor përcakton Zonat e Mbrojtura.  Janë propozuar masa zbutëse për mbrojtjen e cilësisë së ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore.

<sup>4</sup> “Brigjet” janë rripat anësorë të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrrenjve. që, në funksion të përdorimit, përfshijnë të paktën dy zona: i me gjerësi 5 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje, një herë në 25 vjet, të ujit në brigjet e sheshta, që përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta, ii. me gjerësi 100 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje një herë në 25 vjet të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore.

Legjisllacioni	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
VKM Nr. 177 (31.3.2005)	"Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse" jep normat e lejuara për shkarkimin e lumenjve në mjedis, për burimet ujore të mbrojtura.	Të gjitha shkarkimet e lëngëta duhet të jenë në përputhje me standardet dhe rregulloret shqiptare për cilësinë, temperaturën dhe erën përpara se të shkarkohen në mjedis. Standardet e shkarkimit të ujit në lidhje me projektin janë të kufizuara në ndërtimin e strukturave të përkohshme të ndërtesave. Disa alternativa për ujërat e zeza do të vlerësohen si pjesë e procesit të VNM-së. Duhet theksuar se nuk ka standarde për pajisjet e vogla të shkarkimit të ujërave të ndotura dhe sipas standardeve aktuale konsiderohen vetëm shkarkimet e komunitetit pas trajtimit në një impiant të veçantë. Aktualisht, nuk ka rregulla specifike për shkarkimet nga aglomerateve të vogla (siç mund të jenë nga kampet me rreth 200 punëtorë). Në mungesë të standardeve të tilla të emetimeve për projektin, mund të zbatohen standardet ndërkombëtare, por kjo bëhet duke rënë dakort me autoritetet nëpërmjet një procedure sqarimi për objektet (të mundshme) të ndërtimit.
VKM Nr. 379 (25.5.2016)	"Për miratimin e rregullore <sup>5</sup> për Cilësinë e Ujit të Pijshëm"- Qëllimi i kësaj rregulloreje është të mbrojtë shëndetin e njeriut nga efektet e dëmshme të çdo lloji ndotjeje të ujit të destinuar për konsum njerëzor, duke siguruar që ai është i shëndetshëm dhe i pastër. Rregullon disa çështje lidhur me testimin e ujit të pijshëm dhe zonat e mbrojtjes rreth puseve të ujit ose depove të ujërave nëntokësore të komunitetit. Rregullorja përcakton tri zona të mbrojtura (zona neutrale) rreth puseve të ujërave nëntokësore ose vendet e depozitimit të ujit në tokë. Zona e menjëhershme e mbrojtjes varion nga 15 deri në 100 m nga boshti i pusit ose depozita. Distanca e saktë përcaktohet në bazë të vlerësimit të formacioneve gjeologjike nga eksperti hidrogeologjik. Zona e dytë dhe e tretë tampon janë përreth të parës. Për këto zona rregullorja nuk i përcakton kriteret e distancës, por kufizon aktivitetet që mund të ndikojnë në cilësinë e ujit, siç janë, asgjësimi ose groposja e mbeturinave, minierat, etj.	Standardi i përcaktuar nga kjo rregullore (zona e menjëhershme e mbrojtjes) është konsideruar në VNM dhe janë propozuar masat zbutëse përkatëse.
Ajri		

<sup>5</sup> Bazuar në Direktivën e Këshillit të KE-së 98/83 / KE të datës 3 nëntor 1998 mbi cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor) ka të bëjë me cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor.

Legjislati	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
<p>Ligji nr. 162 (04.12.2014) që ka hyrë në fuqi që nga janari 2018)</p>	<p>“Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” përafuar plotësisht me Direktivën 2008/50/KE “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe për ajër më të pastër në Evropë” si dhe Direktivën 2004/107/KE “Për arsenikun, kadmiumin, mërkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e ambientit”. Ky ligj ka hyrë në fuqi më 1 janar 2018 dhe ofron kuadrin institucional, rregulloret, rolet, gjobat për garantimin e pajtueshmërisë. Ligji përcakton që personat fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, kanë për detyrë të mbajnë ajrin e pastër dhe ta mbrojnë atë nga ndotja e shkaktuar nga aktivitetet që ata kryejnë në territorin e Republikës së Shqipërisë</p>	<p>Në VNM janë propozuar masat zbutëse për të kufizuar ndikimin e aktiviteteve të projektit.</p>
<p>Emetimi nga automjetet</p>		
<p>Udhëzimi Nr. 6527 (24.12.2004)</p>	<p>Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Transportit “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotëse të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre” i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 12, datë 15.6.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 6527, të datës 24.12.2004 shoqëruar me Manualin e Kontrollit të Automjeteve.</p>	<p>Certifikata e pajtueshmërisë teknike lëshohet nga SGS Albania<sup>6</sup> dhe është e detyrueshme për të gjithë automjetet e regjistruara në Shqipëri (me targa shqiptare). Pajtueshmëria me këtë udhëzim është marrë në konsideratë në zhvillimin e masave zbutëse të VNM-së.</p>
<p>Emetimet nga transporti, automjetet dhe pajisjet</p>		
<p>Urdhri i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 149 (07.04.2014)</p>	<p>“Për miratimin e rregullores për zbatimin e vlefshmërisë ajrore dhe certifikimit mjedisor të avionëve dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve që kanë lidhje me to, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe të prodhimit”, plotësisht të përafuar me Rregulloren e BE-së Nr. 748/2012 të datës 3 gusht 2012, që përcakton rregullat zbatuese për certifikimin e vlefshmërisë ajrore dhe mjedisore të avionëve dhe të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve përkatëse, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit.</p>	<p>Pajtueshmëria me këtë urdhër është marrë në konsideratë në zhvillimin e masave zbutëse të VNM-së.</p>
<p>Udhëzimi Nr.6527 (24.12.2004)</p>	<p>“Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotëse të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre” i ndryshuar - Ky udhëzim përfshin kërkesat për inspektimet vjetore të</p>	<p>Për aktivitetin e projektit të Parkut Fotovoltaik Spitalla do të përdoren makineri të rënda, mjete me katër rrota dhe kamionë. Certifikata e pajtueshmërisë teknike lëshohet nga SGS Albania dhe është e detyrueshme për të gjithë</p>

<sup>6</sup> <https://www.automotivealbania.sgs.com/>

Legjisllacioni	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
	automjeteve dhe shkarkimet e lejuara të ajrit. Të gjitha automjetet duhet të jenë në përputhje me këto norma.	automjetet e regjistruara në Shqipëri (me targa shqiptare). Pajtueshmëria me këtë urdhër është marrë në konsideratë në zhvillimin e masave zbutëse të VNM-së.
VKM Nr.613 (07.9.2011)	"Miratimi i rregullave teknike për vlerësimin e konformitetit të zhurmës në mjedis të pajisjeve të instaluar në hapësira të hapura ose mjedis" përcakton normat e emetimit të zhurmës për pajisje të caktuar që gjenerojnë zhurmë, të tilla si; gjeneratorë elektrikë, traktorë, kompresorë etj. Rregullorja përcakton pragun e vendosur.	Për aktivitetin e projektit të Parkut Fotovoltaik Spitalla do të përdoren makineri të rënda. Pajtueshmëria me këtë urdhër është marrë në konsideratë në zhvillimin e masave zbutëse të VNM-së.
VKM Nr.10 (30.5.2015)	"Në lidhje me miratimin e traktorëve bujqësore ose pyjore, rimorkiove të tyre dhe makinerive tërheqëse të këmbëshme, si dhe sistemeve, përbërësve dhe njësisve teknike të tyre" bazuar në Direktivën e BE-së 2003/37 / KE datë 26.5.2003.	Pajtueshmëria me këtë udhëzim është konsideruar si masë zbutëse dhe rekomandim në raportin e VNM-së.
Zhurma		
Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007, ndryshuar me Ligjin Nr. 39/2013	"Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" - përcakton kërkesat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, mënyrën e shmangies dhe parandalimit, reduktimit dhe eliminimit të efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë shqetësimin e shkaktuar nga zhurma.. Ky ligj synon të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga efektet e dëmshme të shkaktuara nga emetimet e zhurmave dhe përcakton rregullat, autoritetet, inspektimet, etj.	Gjatë aktivitetit të projektit Park Fotovoltaik Spitalla do të përdoren makineri të rënda dhe kamionë. Është me rëndësi për procesin e VNM-së që me makineritë që shkaktajnë zhurmë të punohet gjatë orëve të ditës. Pajtueshmëria me këtë ligj do të konsiderohet si një dokument përkatës për sugjerimin e masave zbutëse dhe menaxhimin në kuadër të procesit të VNM-së.
VKM Nr. 587, datë 07.07.2010	"Për monitorimin dhe kontrollin e niveleve të zhurmës në zonat urbane dhe turistike" - përcakton rregullat dhe rregulloret për mbrojtjen nga zhurma dhe administrimin e nivelit të zhurmës në zonat urbane dhe turistike.	Pajtueshmëria me këtë ligj do të konsiderohet si një dokument përkatës për sugjerimin e masave zbutëse dhe menaxhimin brenda fushës së procesit të VNM-së.
VKM Nr. 1063 (23.12.2015)	"Për miratimin e rregullave teknike për vlerësimin e konformitetit akustik të pajisjeve të instaluar në ambiente të hapura apo në mjedis" përcakton normat e emetimit të zhurmës për zhurmë të gjeneruar nga pajisje të caktuara siç janë gjeneratorët e energjisë elektrike, traktorët, kompresorët etj. Rregullorja jep kufijtë e përcaktuar (kryesisht kapacitetin e energjisë - kW).	Pajtueshmëria me këtë urdhër është marrë në konsideratë në zhvillimin e masave zbutëse të VNM-së. Zbatimi i këtyre rregullave duhet të sigurohet nga nënkontraktori bazuar në listën e pajisjeve dhe automjeteve që do të përdoren për aktivitetet.
Udhëzimi Nr. 6527/2004	Udhëzimi rregullon nivelet e prodhimit të zhurmës nga automjetet dhe metodat e kontrollit. Kjo përfshin kërkesat për	Pajtueshmëria me këtë udhëzim është marrë në konsideratë në zhvillimin e masave zbutëse të VNM-së. Zbatimi i



Legjisllacioni	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
	inspektime vjetore të automjeteve dhe përmbushjen e normave të paracaktuara. Pajtueshmëria e këtyre normave do të verifikohet me certifikatën e kontrollit të lëshuar nga SGS Albania <sup>7</sup> .	këtyre rregullave duhet të sigurohet nga nënkontraktorët bazuar në listën e pajisjeve dhe automjeteve që do të përdoren për aktivitetet.
Udhëzimi Nr.8 (27.11.2007)	Udhëzim i Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë mbi "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara", përcakton vlerat numerike të zhurmës në zona specifike dhe synon të sigurojë mbrojtje të mjaftueshme për shëndetin e njeriut përkundrejt ekspozimit ndaj zhurmës.	Pajtueshmëria me këtë urdhër është marrë në konsideratë në zhvillimin e masave zbutëse të VNM-së.
Udhëzimi Nr.6527 (24.12.2004)	"Mbi shkarkimet e lejuara të automjeteve në ajër, nivelet e gjenerimit të zhurmës dhe metodat e kontrollit" i ndryshuar - Ky udhëzim përfshin kërkesat për inspektimet vjetore të automjeteve dhe shkarkimet e lejuara në ajër. Të gjitha automjetet duhet të jenë në përputhje me këto norma.	Pajtueshmëria me këtë urdhër është marrë në konsideratë në zhvillimin e masave zbutëse të VNM-së.
Cilësia e karburantit		
VKM Nr. 147 (21.03.2007)	"Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel"	Në përputhje me këtë vendim, do të përdoren vetëm karburantet që gjenden në Shqipëri.
VKM Nr.781 (14.11.2012)	"Për cilësinë e disa lëndëve të djegëse të lëngshme, për përdorim termik, civil, industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)"	Në përputhje me këtë vendim, do të përdoren vetëm karburantet që gjenden në Shqipëri.
Mbetjet		
Ligji Nr.10463 (22.09.2011) i ndryshuar	"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (të ndryshuar) - synon të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin dhe të sigurojë menaxhim të shëndetshëm mjedisor të mbetjeve nëpërmjet menaxhimit të integruar.	Gjatë punës së projektit Park Fotovoltaik Spitalla do të gjenerohen si mbetje të rrezikshme dhe jo të rrezikshme. Menaxhimi i mbetjeve është marrë parasysh në zhvillimin e masave zbutëse dhe do të trajtohet në Planin e Menaxhimit dhe Monitorimit të Mjedisit (PMMM)
Ligji Nr. 99 (18.02.2005) i ndryshuar	"Katalogu shqiptar i klasifikimit të mbetjeve" (i ndryshuar) - i cili bën klasifikimin e mbetjeve bazuar në llojet e industrisë dhe vendos kriteret për vlerësimin e rrezikshmërisë së mbetjeve. Rregullorja i kodifikon llojet e mbetjeve në bazë të Katalogut Europian të Mbetjeve.	Ky Ligj është marrë në konsideratë në klasifikimin e mbetjeve që do të gjenerohen gjatë ndërtimit dhe operimit të projektit Park Fotovoltaik.
VKM Nr. 229	"Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të të	Mbetjet jo të rrezikshme të gjeneruara gjatë ndërtimit të projektit Park Fotovoltaik

<sup>7</sup> <https://www.automotivealbania.sgs.com>



Legjisllacioni	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
(23.04.2014)	dhënave që do të regjistrohen në dokumentin e transferimit” - Rregullorja e sapo miratuar parashikon transferimin e mbetjeve nga kompani të licencuara dhe sigurimin e asgjësimit përfundimtar në impiantet e miratuara. Ky akt kërkon dokumentacionin e transferimit të mbetjeve dhe dorëzimin e certifikatës përfundimtare të asgjësimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Rregullorja kërkon që të gjitha kompanitë gjeneruese të mbetjeve të regjistrohen në AKM dhe të marrin një numër personal të gjenerimit të mbetjeve.	do të transferohen dhe do të asgjësohen në përputhje me këtë direktivë.
VKM Nr. 371 (11.06.2014)	“Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”. Rregullorja e sapo miratuar kërkon transferimin e mbetjeve nga kompani të licencuara dhe sigurimin e asgjësimit përfundimtar në objektet e miratuara. Ky akt kërkon dokumentacionin e transferimit të mbetjeve dhe dorëzimin e certifikatës përfundimtare të asgjësimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Rregullorja kërkon që të gjitha kompanitë gjeneruese të mbetjeve të regjistrohen në AKM dhe të marrin një numër personal të gjenerimit të mbetjeve.	Mbetjet e rrezikshme do të konsiderohen brenda fushës së veprimit të procesit të VNMS. Numri personal i gjenerimit të mbetjeve duhet të regjistrohet në AKM në përputhje me kërkesat e ligjit shqiptar.
Ujërat e zeza		
Ligji nr. 9115/2003 (24/07/2003)	“Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” jep rregulloret që përcaktojnë nevojën për trajtimin e ujit të ndotur para se të shkarkohet. Neni 6 përcakton detyrimet e personave fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve shkarkojnë ujëra të ndotura. Këta janë të detyruara të marrin masa për:  a) të zvogëlojnë vazhdimisht sasinë e ujërave të përdorura që shkarkohen në mjedisin pritës; b) të zvogëlojnë shkallën e ndotjes në ujërat e shkarkuara, veçanërisht ndotjen e shkaktuar nga substancat e rrezikshme dhe mbeturinat; c) të menaxhojnë dhe trajtojnë ujërat e ndotura. Për të përmbushur këto detyrime, personat fizikë dhe juridikë, aktivitetet e të cilëve shkarkojnë ujëra të ndotura, duhet të hartojnë një program masash teknike, teknologjike dhe organizative. Ky program është subjekt kontrolli nga Inspektorati i Mjedisit, autoriteti i licencimit dhe strukturat e qeverisjes vendore.	Në zhvillimin e masave zbutëse të VNMS-së është marrë në konsideratë pajtueshmëria me këtë ligj.

### 3.2.5. Shëndeti dhe siguria

Ligji Nr. 10 237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" garanton sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit nëpërmjet parandalimit të rreziqeve në punë, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksidente, informimit, këshillimit, pjesëmarrje të balancuar në përputhje me ligjin. Ky ligj është në zbatim të kuadrit ligjor të mëposhtëm:

Direktivës së Këshillit Evropian 89/391/KE, datë 12 korrik 1989 "Për vendosjen e masave për nxitjen e përmirësimit në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë";

Direktivës së Këshillit Evropian 94/33 KE, datë 22 korrik 1994 "Për mbrojtjen e të rinjve në punë", neni 6; dhe

Direktivës së Këshillit Evropian 92/85 KE "Për vendosjen e masave për nxitjen e përmirësimeve në sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që janë shtatzëna dhe të atyre që kanë lindur së fundmi ose që ushqejnë fëmijën me gjii".

Legjislacioni shqiptar për shëndetin dhe sigurinë dhe rëndësia e tyre për projektin janë paraqitur në Tabela 9

Tabela 9. Legjislacioni për shëndetin dhe sigurinë në punë

Legjislacioni	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
Ligji Nr. 10237/2010 (18/02/2010)	"Për sigurinë dhe shëndetin në punë" - Ky ligj rregullon kuadrin ligjor për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës dhe përcakton rolet e secilës palë që i nënshtrohet ligjit.	Projekti do të veprojë në përputhje me këtë ligj për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punonjësve të tij. Masat specifike do të përfshihen në planin e masave zbutëse.
Ligji Nr. 9863/2008	Inspektorati Sanitar Shtetëror synon të mbrojë punëtorët nga ndikimi i kushteve të këqija të punës, siç janë ekspozimi ndaj substancave toksike, rrezatimi, zhurmat e papërshtatshme, dridhjet, mikroklimat e pafavorshme dhe kontrollon nivelin e sëmundjeve profesionale dhe aksidenteve si rezultat i kushteve të pafavorshme.	Projekti do të veprojë në përputhje me këtë ligj për të mbrojtur sigurinë e shëndetit të punëtorëve të tij. Masat specifike do të përfshihen në planin e masave zbutëse.
Ligji Nr. 9863/2008 (28/01/2008)	"Për ushqimin" përcakton rregullat e sigurisë ushqimore në Shqipëri	Projekti duhet të sigurojë sigurinë e ushqimit të konsumuar nga punëtorët e saj. Masat specifike do të përfshihen në planin e masave zbutëse.
Ligji Nr. 10433/2011 (16/06/2011)	"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Projekti është subjekt i inspektimeve / kontrolleve për respektimin e rregullave të shëndetit dhe sigurisë.
VKM Nr. 562/2013 (3/07/2013)	Vendimi i Këshillit të Ministrave në lidhje me miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.	Projekti / punëdhënësi duhet të garantojë sigurinë e punëtorëve të tij në vendin e punës. Në Rregulloren e Sigurisë të Punëdhënësit, duhet të hartohet një grup specifik rregullash. Masat specifike do të përfshihen në planin e masave zbutëse.
VKM Nr. 312/2010 (5/5/2010)	"Për sigurinë në kantier" përcakton rregullat e sigurisë për aktivitetet e ndërtimit.	Instalimi i kampeve të punëtorëve duhet të jetë në përputhje me rregullat e këtij vendimi. Masat specifike do të përfshihen në planin e masave zbutëse.
VKM Nr.	"Për krijimin, organizimin dhe	Projekti mund të jetë subjekt i disa

Legjislacioni	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
410/2015 (13/05/2015)	funksionimin e inspektoratit shtetëror teknik dhe industrial". Ky akt rregullon inspektimin e instalimeve që lidhen me proceset industriale në Shqipëri	inspektimeve siç përcaktohet në legjislacionin dhe standardet shqiptare. Pajtueshmëria me këto rregulla duhet të sigurohet nga Nënkontraktori që do të kryejë aktivitetet e termocentralit. Para fillimit të punimeve në terren dhe importimit të pajisjeve, duhet bërë një kontroll fillestar i pajisjeve që do të përdoren dhe të komunikohet me inspektoratin e përkatës për të përcaktuar çdo detyrim.
Vendimi Nr. 692/2001 (13/12/2001)	"Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë"	Projekti do të veprojë në përputhje me këtë ligj për të mbrojtur sigurinë e shëndetit të punëtorëve të tij. Masat specifike do të përfshihen në planin e masave zbutëse.
VKM Nr. 842/2014 (3/12/2014)	"Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me zhurmën në vendin e punës" kërkon që punëdhënësi të vlerësojë nivelin e zhurmës në vendin e punës dhe të sigurojë mbrojtjen e punëtorëve të tij.	Masat specifike do të përfshihen në planin e masave zbutëse.

### 3.2.6. Ligje të tjera Kombëtare që kanë lidhje me këtë projekt

Ligjet shqiptare të tjera që kanë të bëjnë me projektin janë paraqitur në Tabela 10.

Tabela 10. Ligje të tjera Kombëtare që kanë lidhje me këtë projekt

Legjislacioni	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
Përdorimi i tokës dhe planifikimi i territorit		
Ligji Nr. 107/2014	"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" -  Ligji ka për qëllim integrimin e kuadrit ligjor të planifikimit urban në një ligj të vetëm dhe, përfshin konceptin e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si dhe të shëndetit dhe sigurisë së komunitetit, për planifikimin e territorit.	Ligji dhe aktet nënligjore kërkojnë që çdo ndërtim të deklarohet. Projekti është i përkohshëm; mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, shëndeti dhe siguria e komunitetit do të përfshihen në masat zbutëse të VNM-së.
VKM Nr. 408 (13.5.2015 i ndryshuar me VKM 231/2017)	Rregullorja për zhvillimin e territorit.	Kjo rregullore specifikon llojin e objekteve që kërkojnë leje ndërtimi. Duhet kërkuar një leje paraprake për ndërtimin e kampeve të terrenit.  Instalimi i strukturave të lëvizshme kërkon leje paraprake (ose deklarim të punëve) të lëshuara nga bashkia.
Ligji Nr. 9244/2004	"Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore" përcakton statusin e mbrojtjes të fushave bujqësore të dhëna.	Projekti është i detyruar të informojë autoritetet lokale për çdo dëmtim të tokës bujqësore nga veprimtaria e tij. Autoritetet vlerësojnë dëmin dhe kërkojnë që përdoruesi i tokës të kthejë në gjendjen e

Legjislacioni	Përmbledhje	Rëndësia në lidhje me Projektin
		mëparshme gjendjen e tokës bujqësore. Janë propozuar masa zbutëse.
Figura 43 tregon vendndodhjen e aseteve më të afërta të trashëgimisë kulturore në lidhje me vendndodhjen e Projektit FV dhe përgjatë gjurmës LTTL. Hulumtime të mëtejshme do të zhvillohen gjatë punës në terren si pjesë e Fazës së VNMS-së për të identifikuar objektet arkeologjike dhe/ose të trashëgimisë kulturore brenda zonës së ndikimit të Projektit FV dhe gjurmës së linjës së transmetimit.





**Figura 43. Harta e Trashëgimisë Kulturore në Zonën e Projektit**

#### 4.4.10. Infrastruktura dhe rrugët e Aksesit në zonë

Zona e propozuar e projektit ka një akses të mirë infrastrukturor për realizimin e ndërtimit dhe operimit të impiantit të propozuar. Parcela e zgjedhur përshkohet nga vazhdimi i një rruge aksesi, kufizohet në Perëndim me landfillin “Eco Park Durrës”, në Veri nga një kanal kullues i zonës, ndërsa në Jug dhe në Lindje nga toka që nuk përdoren. Rruga kombëtare gjendet në një distancë të shkurtër nga zona e propozuar duke siguruar aksesin e nevojshëm për fazat e ndërtimit dhe operimit të projektit. Ndërkohë, rrugët e tjera janë rrugë rurale, përgjithësisht të pashtuara dhe përdoren rrallë nga komuniteti lokal, kryesisht për akses në tokat e tjera përreth dhe kullotje të bagëtive.

Zona e propozuar gjendet ndërmjet zonave shumë të industrializuara të Durrës-Tiranës dhe është deklaruar si Rajon Ekonomik që mbështetet nga “Plani i integruar ndër-sektorial për bregdetin 2015-2030”. Si e tillë, zona në fjalë paraqet një konsum të nivelit të lartë të energjisë elektrike në rrjetin 110/35/20/6/0.4 kV për qëllime industriale, shërbimi dhe banimi. Zona gjithashtu mbulohet me furnizim me tension të një niveli relativisht të lartë dhe ka linja të dedikuara për termocentralin e Porto Romanos dhe zonën e banuar të “ish kënetës së Spitalës”. Është fakt që infrastruktura e furnizimit me energji është e aftë të përthithë energjinë elektrike të prodhuar nga FV në nivelin e 50 deri 120 MWp.




Figura 44. Harta e Rrugëve në Afërsi të Implantit FV

#### **4.5. Receptorët Sensitiv Kryesorë të Identifikuar Fillimisht**

Bazuar në sa më sipër, fillimisht janë identifikuar receptorët kryesorë të rëndësishëm/sensitiv mjedisorë dhe socialë, që lidhen me planifikimin dhe realizimin e Projektit të propozuar:

- Kanalet e ujitjes dhe kullimit brenda zonës së Projektit FV, habitatet dhe ekologjia e ndikuar. (Referojuni **Figura 13** dhe **Figura 17**, **Figura 18**, **Figura 19**, **Figura 20**);
- Zogjtë me fole në tokë që mund të përdorin zonën e vendndodhjes së Projektit FV (Referojuni **Figura 34**)
- Fauna ekologjike e ndjeshme (Referojuni paragrafit 4.3.4);
- Banesat rezidenciale brenda distancës 100 m nga LTTL;
- Fshatrat e afërt Rinia dhe Vrinas (përkatësisht 150 m nga zona e zonës së projektit FV) (Referojuni 4.4.1);
- Kullotat që përdoren në zonën e Projektit FV (Referojuni **Figura 33**);
- Pronarët e bizneseve dhe shtëpive përgjatë rrugës së LTTL.



## 5. ANGAZHIMI I GRUPEVE TË INTERESIT

Angazhimi i grupeve të interesit është jetësor për zbatimin me sukses të projektit. Procesi i angazhimit të grupeve të interesit do të nisë gjatë fazës së përcaktimit të fushëveprimit dhe do të vazhdojë përgjatë gjithë ciklit të jetës së projektit. Si pjesë e fazës së përcaktimit të fushëveprimit të projektit është hartuar “Plani i Angazhimit të Grupeve të Interesit” (PAGI) i cili do të përditësohet gjatë gjithë projektit sipas nevojës.

Angazhimi me sukses i grupeve të interesit është një nga kërkesat kryesore të VNMS-së si dhe për nxitjen e marrëdhënieve të mira dhe përmirësimin e komunikimit, veçanërisht rreth çështjeve sensitive siç është blerja e tokës. Objektivi përfundimtar është ‘joshja’ e grupeve të interesit drejt projektit, gjë që mund të shënojë një hap të madh në procesin e përfuturit dhe mirëmbajtjes së një ‘licence sociale për të vepruar’.

Grupet e interesit përfshijnë çdo individ ose grup që preket ose beson se është prekur nga një projekt, si dhe çdo individ ose grup që mund të luajë një rol të rëndësishëm në formësimin ose ndikimin e një projekti, qoftë pozitivisht, qoftë negativisht.

### 5.1. Objektivat

Procesi i angazhimit të grupeve të interesit është krijuar për të qenë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë Kriteret e Performancës të BERZH. Në kuadër të këtij Projekti, objektivat kryesore për angazhimin e grupeve të interesit janë:

- **Njohja me Projektin:** Do të ndërmerret një proces i hapur, gjithë-përfshirës dhe transparent angazhimi dhe komunikimi kulturor, për të siguruar që grupet e interesit të jenë të mirë-informuar në lidhje me zhvillimin e propozuar. Informacioni do të sigurohet sa më herët dhe sa më i plotë që të jetë e mundur, në mënyrë që të grupet e interesit të kuptojnë ndikimet potencialisht të rëndësishme mjedisore dhe shoqërore të Projektit;
- **Angazhimi i Grupeve të Interesit:** Grupet e interesit mund të ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave lokale në funksion të përmirësimit të njohjes me kontekstin mjedisor dhe shoqëror dhe për të kuptuar më mirë çështjet e rëndësishme në nivel lokal. Ata mund të ndihmojnë gjithashtu në zhvillimin e masave efektive zbutëse dhe mund të sjellin ide të reja në lidhje me optimizimin e përfitimeve në nivel lokal që mund të realizohet përmes Projektit;
- **Ndërtimi i Marrëdhënieve:** Përmes mbështetjes së dialogut të hapur, angazhimi i tyre mund të ndihmojë në krijimin dhe mirëmbajtjen e një licence sociale për të funksionuar;
- **Menaxhimi i Pritshmërive:** Është e rëndësishme të sigurohet që Projekti i propozuar të mos krijojë apo lejojë pritshmëri joreale në lidhje me përfitimet e Projektit në mesin e komuniteteve lokale. Procesi i angazhimit do të shërbejë si një mekanizëm për të kuptuar dhe administruar pritshmëritë e grupeve të interesit dhe të komunitetit, duke shpërndarë informacion të saktë në një mënyrë të arritshme.

Angazhimi me komunitetet lokale dhe përdoruesit e tokës në lidhje me humbjen e aksesit në tokë si dhe shëndetin dhe sigurinë gjatë ndërtimit, do të jetë më i rëndësishmi. I nevojshëm do të jetë gjithashtu informimi i komuniteteve vendore në lidhje me punimet e ndërtimit dhe rritjen e trafikut në kohën e pikut të ndërtimit.

Për të përmbushur objektivat për angazhimin e grupeve të interesit, Projekti do të zhvillojë një plan për angazhimin me grupet e interesit përmes ciklit të jetës së Projektit. Plani përcakton procesin e konsultimeve dhe publikimeve. Katër fazat e Planit të Angazhimit të Grupeve të Interesit (PAGI) janë si më poshtë:

- Përcaktimi i fushëveprimit;
- Studimi VNMS;
- Publikimi i VNMS-së; dhe
- Zbatimi i Projektit (Planifikimi dhe Realizimi).



## 5.2. Identifikimi i Grupeve të Interesit

Për qëllime të këtij Projekti, grupet e interesit janë “çdo individ ose grup potencialisht i prekur nga Projekti ose që ka interes në Projekt dhe në ndikimet e mundshme të tij”. Qëllimi i identifikimit të grupeve të interesit është përcaktimi se cilat organizata dhe individë mund të preken direkt ose indirekt (pozitivisht dhe negativisht) ose kanë interes në Projekt. Identifikimi i grupeve të interesit është një proces i vazhdueshëm dhe që kërkon rishikim dhe përditësim të rregullt ndërsa Projekti vazhdon. Më poshtë është një përmbledhje e grupeve të ndryshme të projektit; një listë e plotë e tyre do të vendoset në PAGI.

Përgjatë fazës së përcaktimit të fushëveprimit do të përcaktohet një listë paraprake e aktorëve kryesorë të projektit. Këto grupe përbëhen nga individë, grupe dhe organizata që mund të preken nga ose mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në zhvillimin e projektit. Lista do të zgjerohet duke përdorur udhëzimet ndërkombëtare të IFC-së dhe ka përfshirë grupet e mëposhtme:

- autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore;
- drejtuesit e bashkësive lokale;
- anëtarët e komunitetit, përfshirë nën-grupe të rrezikuara si gratë, fermerët dhe të moshuarit;
- Organizatat joqeveritare në fushën e mjedisit dhe atë sociale, që operojnë në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor(OJQ-të).

Kjo listë potenciale është përgatitur paraprakisht dhe do të rishikohet vazhdimisht (zgjerohet ose ngushtohet sipas nevojës) gjatë gjithë studimit të VNMS-së.

**Tabela 20. Grupet e Identifikuara të Interesit**

Grupet e Interesit dhe Kategoritë	Interesat dhe roli i tyre në projekt
Kombëtar	
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)	Mbikëqyrja e procedurës së VNMS-së dhe miratimi i raportit të VNMS-së.
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)	Ministria ka kompetenca shumë më të gjera pasi, përveç energjisë, mbulon edhe transportin, planifikimin hapësinor dhe telekomunikacionin dhe pritet të lehtësojë koordinimin midis sektorëve.
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) është përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore, vaditjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmytjet. Ministria koordinon përparësitë ndërmjet qëllimeve të ndryshme dhe përdoruesve të ndryshëm të burimeve ujore.
Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	Mbikëqyrja, zbatimi i procedurës së VNMS-së dhe rishikimi dhe miratimi i raportit të VNMS-së. Mbikëqyrja e angazhimit publik gjatë procesit të VNMS-së.
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) është një institucion publik përgjegjës për planifikimin hapësinor dhe urban, të hapave thelbësorë në procesin e zhvillimit të projekteve të infrastrukturës, brenda MIE-së.
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)	AKZM-ja është një organ publik në varësi të MTM, përgjegjëse për menaxhimin e zonave të mbrojtura.
Instituti i Monumenteve të Kulturës -	Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore Kombëtare; do

Grupet e Interesit dhe Kategoritë	Interesat dhe roli i tyre në projekt
(IMK) Ministria e Kulturës	të informohet mbi çdo zbulim rastësor gjatë aktiviteteve të ndërtimit. Siguron të dhëna mbi trashëgiminë kulturore në zonën e projektit.
Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)	Menaxhon sistemin e transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri.
<b>Rajonale</b>	
Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Durrës	Mbikëqyrja dhe zbatimi i procesit të konsultimit publik. Asiston dhe realizon publikimin e njoftimeve për Dëgjimet Publike dhe Përmbledhjet Jo-Teknike (PJT) në faqen e saj të internetit (në faqen e internetit të AKM-së). Ndjek dëgjimet publike dhe raporton pranë AKM-së në lidhje me përputhshmërinë e projektit me procedurën e konsultimit publik. Ky raport është i rëndësishëm për vendimmarrjen përfundimtare nga ana e AKM dhe MTM.  Certifikimi i procedurës së konsultimit publik.
Bordi i kullimit	Bordi i Kullimit është përgjegjës për menaxhimin e vaditjeve, kullimin dhe mbrojtjen nga përmytja.
Agjencia Rajonale e Zonave të Mbrojtura (ARZM)	ARZM-ja është një organ publik në varësi të AKZM-së, përgjegjëse për menaxhimin e zonave të mbrojtura në nivel rajoni.
Prefektura e Qarkut Durrës	Raportimi i çështjeve/opinioneve kryesore pranë Qeverisë. Lehtësimi i angazhimit publik dhe procesit të dëgjimit.
Këshilli i Qarkut Durrës	Raportimi i çështjeve/opinioneve kryesore pranë Qeverisë. Lehtësimi i angazhimit publik dhe procesit të dëgjimit.
Kryetari i Bashkisë Durrës	I zjedhur si përfaqësues i komunitetit, raporton çështjet/opinionet kryesore pranë Qeverisë. Ka rol lehtësues gjatë angazhimit publik dhe procesit të dëgjimit.
Drejtoritë Teknike të Bashkisë Durrës	Menaxhimi i burimeve vendore brenda kompetencave të dhëna dhe mbështetje teknike për vendimmarrjen e Kryetarit. Lehtësimi i angazhimit publik dhe procesit të dëgjimit.  - Drejtoria e planifikimit urban (përfshirë mjedisin), siguron të dhëna për planin e përdorimit të tokës në zonën e projektit. Siguron të dhëna mbi mbrojtjen e mjedisit në zonën studimore të projektit.  - Drejtoria e bujqësisë, pylltarisë, vaditjes dhe kullimit, siguron të dhëna për përdorimin e tokës bujqësore në zonën studimore të projektit. Siguron të dhëna mbi zonat pyjore në zonën studimore të projektit. Siguron të dhëna mbi sistemet kulluese dhe planet në zonën studimore të projektit.

Grupet e Interesit dhe Kategoritë	Interesat dhe roli i tyre në projekt
	- Ndërmarrja e furnizimit me ujë ofron të dhëna mbi sistemet e furnizimit me ujë në zonën studimore të projektit.
<b>Lokal</b>	
Njësitë Administrative të Rrashbull dhe Katund i Ri	Lehtësimi i angazhimit publik dhe procesit të dëgjimit.
Komunitetet vendore në zonën e projektit	Vendbanimet dhe familjet që rrezikojnë të preken nga humbja e tokës, zhvendosja e aktivitetit ekonomik, shqetësime nga aktivitetet e ndërtimit.
Anëtarët e komunitetit të biznesit në zonën e projektit	Partnerë të mundshëm në menaxhimin e ndikimeve të mundshme kumulative gjatë fazës së ndërtimit të projektit.
OJQ-të rajonale dhe vendore	Interesimi për mbrojtjen e mjedisit dhe përhapjen e ndikimeve të projektit dhe strategjisë së zbutjes.

Një analizë e detajuar e grupeve të interesit, angazhimeve të ardhshme dhe lista e grupeve të interesit shpjegohen dhe pëditësohen në PAGI ndërsa Projekti përparon në fazat e mëpasshme.

### 5.3. Përmbledhje e procesit të angazhimit të grupeve të interesit në kuadër të VNMS-së.

Shkresat që njoftojnë Grupet e Interesit dhe të Prekura (GI&P) për aplikimin për autorizim mjedisor, do t'iu dërgohen të gjitha palëve të interesuara dhe të regjistruara, së bashku me një Dokument mbi Sfondin Historik (DSH). Në vendin e Projektit do të postohet një njoftim i cili do të përmbajë shkurtimisht të dhëna mbi projektin dhe personat e kontaktit, në mënyrë që GI&P-të të mund të kërkojnë informacione të mëtejshme dhe/ose të regjistrohen si grupe interesi (d.m.th. pranë ndërtesave publike).

DSH do të shpjegojë projektin dhe procesin e VNMS-së me terma të thjeshtë si dhe do të japë hollësi se si dhe ku mund të jepen komentet dhe kontributet. DSH do të përdoret për shpërndarjen e informacionit bazë të projektit tek aktorët kryesorë gjatë konsultimit publik të fazës së përcaktimit të fushëveprimit, dhe gjithashtu do të përdoret si një mjet njoftimi për aktorët kryesorë shtesë dhe për aktivitetet ballë për ballë dhe angazhime të tjera gjatë procesit të VNMS-së.

Takimet publike me grupet e interesit do të mbahen si gjatë fazës së përcaktimit të fushëveprimit ashtu edhe gjatë fazës VNMS për t'u ofruar palëve të interesuara informacion bazë rreth projektit të propozuar he për t'u dhënë atyre mundësinë për të ngritur çështje dhe/ose shqetësime që duhen trajtuar gjatë projektit.

Ftesat për grupet e interesit do të realizohen përmes shkresave njoftuese që do të përgatiten për takimet me grupet e interesit, ku do të prezantohet projekti i propozuar dhe grupet do të ftohen të marrin pjesë. Të gjitha shkresat e njoftimeve do t'iu shpërndahen grupeve kryesore dhe të identifikuar të interesit. Forma të tjera të njoftimeve që do të përdoren për konsultime gjatë fazës së përcaktimit të objektivave përfshijnë vendosjen e posterave në fshatrat, vendbanimet rezidenciale dhe ato tregtare të prekura, shpërndarjen e fletushkave, etj.

Draft-raporti për përcaktimin e fushëveprimit do të jetë i disponueshëm për GI&P-të në mënyrë që ata të bëjnë komente në faqen e internetit të zhvilluesit dhe kopje fizike të tij do të jenë të disponueshme për përdorim në mjediset e bashkisë dhe të agjencive rajonale të mjedisit. Periudha për dhënien e komenteve do të zgjasë 30 ditë.

Raporti Përfundimtar i Fushëveprimit do të vendoset në dispozicion për komente për regjistrimin e GI&P-ve në faqen e internetit të zhvilluesit. Shkresat njoftuese për të gjithë GI&P-të e regjistruara për periudhën e komenteve publike do të dërgohen me postë elektronike dhe SMS.

Draft-Raporti i VNMS-së do të vihet në dispozicion të GI&P-ve për komente për një periudhë 40-60-ditore, në faqen e internetit të zhvilluesit.

Gjatë fazës së VNMS-së do të mbahet edhe një takim i fundit Publik (në përputhje me legjislacionin kombëtar për VNMS-të) për të informuar grupet e interesit mbi progresin e procesit të VNMS dhe për të prezantuar gjetjet e studimeve të specializuara dhe rekomandimet e bëra. Raporti i dëgjesave publike do të përgatitet bazuar në reagimet e marra, pyetjet dhe përgjigjet përkatëse nga grupet e interesit dhe palët e interesuara dhe të prekura, dhe do të jetë pjesë e dosjes së aplikimit.

#### 5.4. Konsultimi publik gjatë fazes së përcaktimit të fushëveprimit

Konsultimet fillestare për fazën e përcaktimit të fushëveprimit u bënë me autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale dhe grupet e tjera të interesit brenda ose pranë zonës së projektit. Çdo komunitet tjetër i interesuar dhe grupet e tjera të interesit që nuk u identifikuan gjatë fazës së Përcaktimit të Fushëveprimit do të identifikohen dhe angazhohen gjatë fazës së VNMS-së.

Takimet për përcaktimin e fushëveprimit shërbyen për t'u siguruar grupeve të interesit të dhëna rreth Projektit dhe procesit të VNMS-së dhe për të marrë reagime nga ata për shqetësimet dhe çështjet kryesore. Qëllimi është identifikimi i çdo shqetësimi kryesor ose çështjeje të nivelit të lartë që aktorët kryesorë kanë pasur në këtë fazë të hershme.

Në takimin me OJQ-të (PPNA, AOS dhe Iliria), të datës 07/10/2021 u ngritën çështjet e mëposhtme:

- Monitorimi i specieve migruese të cilat përdorin korridorin e Adriatikut;
- Monitorimi i folezimit të llojeve të shpendëve tokësorë që janë aktivë në këto zona;
- Të shmangjet pastrimi i paneleve me produkte të rrezikshme ose të merren masa zbutëse për të minimizuar ndikimin;
- Përdorimi i devijuesve të shpendëve për të shmangur përplasjen e shpendëve me linjat e transmetimit, i cili është shumë efikas dhe me kosto të ulët;
- Mundësia për të bërë komente dhe sugjerime për raportin e fushëveprimit pasi të publikohet dhe në fazat e ardhshme.

Konsultimi publik përfshin prezantime në PowerPoint mbi elementët e Projektit, një përmbledhje të procesit të VNMS-së, metodologjinë e studimit fillestar dhe zonat e influencës (ZI) dhe metodologjinë e vlerësimit të çështjeve mjedisore dhe sociale. Takimet publike përfshinë edhe një forum të hapur për diskutime dhe pyetje nga pjesëmarrësit. Diskutimet dhe komentet e ngritura u regjistruan së bashku me procesverbalet e takimeve dhe regjistrin e pjesëmarrësve.

Midis datave 20 Shtator – 7 Tetor 2021 u mbajtën një sërë takimesh të veçanta me palët e mëposhtme:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM);
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT);
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE);
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);
- Ministria e Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) - Ministria e Kulturës;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);
- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)
- OJQ-të rajonale dhe vendore
- Kryetari i Bashkisë Durrës (Drejtoritë Teknike të Bashkisë Durrës);
- Njësia Administrative Rrashull and Katund i Ri, Bashkia Durrës;
- Prefektura e Qarkut Durrës dhe Këshilli i Qarkut Durrës;



- Sektori i Bordit të Kullimit / Departamenti i Rrugëve, Durrës;
- Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura (ARZM).
- Kryeplaku i fshatrave Rinia dhe Vrinas.

Në përgjithësi të gjitha grupet e interesit ishin mjaft mbështetëse ndaj Projektit dhe janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe të ndajnë informacionin në dispozicion që mund të kërkohet për VNMS-në. Më poshtë është një listë përmbledhëse e pikave kryesore të ngritura gjatë takimeve:

- Projekti është i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe diversifikimin e sektorit energjetik pasi varet shumë nga energjia hidrike.
- Në përgjithësi, projekte të tilla shihen si miqësore me mjedisin.
- Angazhimi i palëve të interesuara është i rëndësishëm, veçanërisht me komunitetin lokal dhe duhet të koordinohet me projektet e tjera që zhvillohen dhe zbatohen në zonë, si p.sh. në zonë do të shihet edhe zhvillimi i Portit të ri Industrial të Durrësit dhe i një zone rezidenciale. projekti duhet të marrë parasysh ndikimet kumulative me këto projekte dhe koordinimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm në zhvillimin e tyre.
- Projekti mund t'i nënshtrohet një VNMS të thelluar duke pasur parasysh zhvillimin e parashikuar të projekteve të tjera në të njëjtën zonë
- Reflektimet nga panelet mund të çorinetojnë zogjtë dhe duhet të merren parasysh brenda VNMS-së.
- Zona e Mbrojtur më e afërt është ajo e Rrushkullit, e cila ndodhet afërsisht 8-9 km nga zona e projektit.
- Rreziku sizmik i zonës duhet të vlerësohet dhe njehsohet gjatë studimeve të VNMS-së
- Linja e transmetimit mund të ndikojë te zogjtë (përplasja me linjat).
- A do të ndikojë projekti në sistemin e kullimit në zonë?

Një përmbledhje më e hollësishme në lidhje me takimet me grupet e interesit jepet në 0.

Konsultime të mëtejshme mund të kryhen me grupet e interesit që janë konsultuar edhe më parë gjatë fazës së përcaktimit të fushëveprimit dhe studimit të VNMS-së.

Përveç kësaj, pasi të jetë hartuar raporti i fushëveprimit, do të mbahen takime me komunitetin (me banorët vendas) për të mbledhur pikëpamjet dhe sugjerimet nga komunitetet vendase.

Pasi drafti i raportit të fushëveprimit të jetë publikuar dhe depozituar në MTM (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit), ai do t'i nënshtrohet një rishikimi nga ekspertët e MTM, AKM dhe institucioneve të tjera kombëtare, rajonale dhe lokale, si dhe do të rishikohet gjithashtu edhe nga specialistët. Të gjitha komentet, sugjerimet dhe pyetjet në lidhje me raportin dhe projektin mund të adresohen në faqen zyrtare të internetit të zhvilluesit. Pas periudhës së rishikimit të draft-raportit të përcaktimit të objektivave të VNMS-së, të gjitha gjetjet do të mblidhen dhe adresohen sipas procedurave dhe udhëzimeve të Standardit të IFC-së. Më pas, në kuadër të projektit, do të ndërmerren masa të përshtatshme për të trajtuar këto gjetje dhe komentet e marra nga autoritetet publike dhe qeveritare për raportin e fushëveprimit të VNMS-së.

Pas përfundimit të kënaqshëm të veprimeve të nevojshme për të trajtuar gjetjet, raporti i fushëveprimit do të finalizohet dhe MTM do të lëshojë autorizimin për realizimin e VNMS-së përfundimtare.

## 5.5. Mekanizmi i Ankesave

Zhvilluesi ka krijuar një mekanizëm ankesash si pjesë e Planit PAGI, për të qenë i informuar dhe për t'iu përgjigjur shqetësimeve të grupeve të interesit si dhe për të lehtësuar zgjidhjen e ankesave të aktorëve kryesorë. Mekanizmi i ankesave do të adresojë shqetësimet në kohë dhe mënyrë efektive, duke përdorur një proces të kuptueshëm dhe transparent i përshtatshëm nga ana kulturore dhe lehtësisht i arritshëm për të gjitha segmentet e palëve të prekura, pa asnjë kosto dhe pa penalitete.

Praktikat e mirë ndërkombëtare përshkruajnë kërkesat për mekanizmat e ankesave. Mekanizmat e ankesave duhet të marrin dhe lehtësojnë zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të komuniteteve të

prekura. Ai përfshin një mekanizëm të pavarur, objektiv të apelimit, i cili nuk do të pengojë aksesin në zgjidhje gjyqësore ose administrative. Procesi parashikon hapat e mëposhtëm:

- Identifikimi;
- Regjistrimi dhe kategorizimi;
- Njohja;
- Hetimi/përgjigja;
- Komunikimi i përgjigjes dhe kërkesa për reagimin e aktorëve kryesorë; dhe
- Mbyllja.

Për të siguruar që mekanizmi i ankesave është gjithëpërfshirës dhe i duhuri nga pikëpamja kulturore, aktorët kryesorë kanë disa metoda komunikimi për të raportuar një ankesë.

Në këtë mënyrë sigurohet që ankesat të pranohen, hetohen dhe zgjidhen me shpejtësi. Ankesat mund të jenë një tregues i shqetësimeve në rritje të aktorëve kryesorë (të vërteta dhe të perceptuara) dhe mund të përshkallëzohen nëse nuk identifikohen dhe zgjidhen. Menaxhimi i ankesave është si rrjedhojë një përbërës thelbësor i menaxhimit të aktorëve kryesorë dhe një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të rrezikut për një projekt.

## 5.6. Studim bazë socio-ekonomik

Angazhimi i komunitetit gjatë VNMS-së do të mundësohet për të mbledhur të dhëna të mëtejshme socio-ekonomike. Të dhënat bazë mbulojnë studimet në terren, si një element kyç i vëzhgimeve sociale dhe shëndetësore. Informacioni do të mblidhet për zonat ekzistuese të interesit brenda "Zonës së Projektit (ZP)".

Të dhënat parësore socio-ekonomike do të mblidhen si në vijim:

- Vizita në terren dhe takime me komunitetin dhe për të mbledhur të dhëna bazë shtesë;
- Marrja e të dhënave të disponueshme socio-ekonomike nga bashkia e Durrësit;
- Regjistrimi dhe shqyrtimi i komenteve dhe ankesave nga komunitetet;
- Mbledhja e të dhënave parësore e të rëndësishme socio-ekonomike nëpërmjet intervistave me persona informues kyç, diskutimeve me grupet e fokusit dhe angazhimit të palëve të interesuara;
- Përditësimi i bazës socio-ekonomike dhe shëndetësore me të dhëna parësore;
- Vlerësimi/krahasimi i ndikimit kumulativ të zhvillimit të projektit me zhvillimet aktuale dhe të planifikuara në zonë;
- Hartimi i draftit për masat zbutëse i cili do të përfshihet dhe në Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social.

Baza e të dhënave primare do të mblidhet përmes Diskutimeve me Grupet e Fokusit (DGF), Intervistat me Informatorë Kryesor (IIK), intervista me drejtues të komunitetit dhe biznese në ZP.

DGF janë diskutime të organizuara me një grup të përzgjedhur individësh për të marrë informacion në lidhje me pikëpamjet dhe përvojat e tyre për një tematikë të caktuar si dhe për të ndihmuar në marrjen e njohurive mbi këndvështrimin e përbashkët të njerëzve për jetën e përditshme dhe mënyrat në të cilat individët ndikohen nga të tjerët në një situatë në grup.

IIK-të janë intervista cilësore e të thëlluara me njerëz që e dinë se çfarë po ndodh në komunitet. Qëllimi i IIK-ve është mbledhja e informacionit nga një gamë e gjerë njerëzish, duke përfshirë përfaqësuesit e komunitetit, profesionistët ose banorët të cilët kanë njohuri të drejtpërdrejta për komunitetin. Intervistat do të zhvillohen me individë/institucione që kanë njohuri për një temë specifike (p.sh. programet e zhvillimit, shëndetësia, punësimi, arsimit dhe infrastruktura) ose janë anëtarë të informuar të komunitetit. Për të mbledhur të dhëna cilësore do të intervistohen përfaqësues të pushtetit vendor dhe profesionistë të kujdesit shëndetësor.

Numri i këtyre intervistave do të varet nga njohuritë dhe disponueshmëria e përfaqësuesve në zonë.

Takimet e komunitetit do të organizohen në AP për të paraqitur raportin e fushëveprimit dhe për të marrë komente nga palët e interesuara. DPI-ja ose dokumente të tjera informative (p.sh. fletushka me postera) do t'i shpërndahen komunitetit përpara takimeve konsultative. Kjo do të shpjegojë projektin dhe procesin e VNMS-së në terma të thjeshtë dhe do të japë detaje mbi datat dhe vendet e takimeve të konsultimit me komunitetin. Rezultatet e këtyre konsultimeve dhe komentet do të paraqiten në raportin e VNMS-së. Një kombinim i studimit në zyrë dhe në terren do të bëhet për të identifikuar çdo kufizim vertikal në ndërtesat nën linjat e transmetimit, ose një kufizim anësor për të siguruar akses dhe siguri në secilën anë të linjës së transmetimit, duke lejuar kalimin e infrastrukturave të tjera (linjat e tjera të energjisë, telefonia, antena , etj brenda korridorit të sigurisë (25m nga secila anë)).<sup>36</sup>

Aktivitetet e tjera të rëndësishme përfshijnë të kuptuarit nëse ka pika të ndjeshme që mund të kërkojnë ndryshime në dizajnin aktual të Projektit, pikat e ekspozimit ose zona që kërkojnë aplikimin e masave të veçanta zbutëse. Përveç kësaj, ekipi do të vëzhgojë se si vendbanimet po zgjerohen, me çfarë ritmi dhe në cilin drejtim (dmth drejt ose larg vendndodhjeve të objekteve) përveç vendeve të aktivitetit të planifikuar në të ardhmen.

Vëzhgimet në terren do të përfshijnë gjithashtu profilizimin e infrastrukturës sociale dhe shëndetësore dhe vëzhgimet e nivelit të lartë të trafikut. Ekipi i projektit nëpërmjet studimeve në zyrë dhe zbulimeve të pjesshme sipërfaqësore do të identifikojë vendet e trashëgimisë kulturore. Vëzhgimet në terren do të kërkojnë regjistrimin e gjurmës së rrugës me GPS (pikat e rrugës GPS) dhe të paktën dy fotografi të secilit prej vendeve në fjalë. I gjithë informacioni, duke përfshirë një përshkrim të detajuar të vendeve të studimit dhe çdo problem të mundshëm, do të regjistrohet në hartë dhe në bllok fotografish.

---

<sup>3636</sup> Në përputhje me standardet shqiptare KTP dhe KTZ, të cilat janë përditësuar dhe janë në përputhje me standardin evropian EN-50351 2012 "LTTL që tejkalojnë AC 1kV".

## 6. IDENTIFIKIMI FILLESTAR I PASOJAVE TË MUNDSHME

### 6.1. Hyrje

Projekti do të përfshijë një sërë aktivitete, shumë prej të cilave mund të ndikojnë në mjedisin fizik dhe biologjik, si edhe tek njerëzit, nëse këto nuk merren parasysh siç duhet gjatë hartimit, planifikimit dhe realizimit të projektit.

Tabela 21 më poshtë paraqet një vlerësim fillestar të ndikimeve të identifikuara si domethënëse për Projektin përmes procesit të përcaktimit të fushëveprimit. Nivelet e mundshme të ndikimit janë përcaktuar si 'i ulët', 'mesatar' ose 'i lartë', në mënyrë që të sigurohet një tregues shkalle për ndikimet e ndryshme brenda fushëveprimit të VNMS-së. Për ndikimet me vlerësim fillestar 'mesatar' ose 'të lartë', identifikohen pasiguritë/paqartësitë në lidhje me këto ndikime dhe propozohen kërkesa për studime/inspektime të mëtejshme. Ky vlerësim fillestar është përcjellë edhe përmes përdorimit të Listës së Kontrollit të Fushëveprimit <sup>37</sup> (shih 0).

Është e rëndësishme të theksohet se atributet e ndikimeve si 'e ulët', 'mesatar' dhe 'e lartë' sigurojnë një mjet për të bërë dallimin midis niveleve të ndikimeve për qëllime të përcaktimit të fushëveprimit dhe nuk pasqyrojnë nivelet e parashikuara të rëndësisë, të cilët përshkruhen në seksionin e metodologjisë së VNMS-së.

Sipas nevojave, janë identifikuar edhe ndikimet e mundshme që nuk konsiderohen domethënëse ose që kanë rëndësi në atë masë që mund të "hiqen" nga fazat pasuese të procesit të VNMS-së.

---

<sup>37</sup> Burimi: Komisioni Evropian "Vlerësimi i Ndikimit në Mjedisin e Projekteve - Udhëzime për Fushëveprimin (Direktiva 2011/92/BE e ndryshuar me Direktivën 2014/52/BE)"



## 6.2. Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor

**Tabela 21. Vlerësimi i Fillestar i Ndikimit**

Tema	Niveli i pritshëm i ndikimit	Objektivi i vlerësimit fillestar
Faza e ndërtimit		
Pasojat në mjedis		
Gjenerimi i pluhurit dhe grimcave	I ulët	<p>Ndotësit e ajrit të emetuar gjatë fazës së ndërtimit janë emetime pluhuri si pasojë e gërmimeve, punimeve mbitokësore dhe lëvizjes së automjeteve dhe makinerive të rënda, si dhe emetime të shkaktuara nga përdorimi i motorëve të makinerive, mjeteve të rënda dhe automjeteve. Emetimet e pluhurit mund të shkaktojnë probleme serioze, veçanërisht kur projekti ndodhet pranë zonave të banuara.</p> <p>Pjesa më e madhe e ndërtimit të ZZHP do të bëhet larg nga receptorët e ndjeshëm siç janë komunitetet e banimit; komunitetet më të afërta janë të vendosura rreth 600 m nga zona e Projektit. Megjithatë, ndërtimi i LTTL është afër shtëpive dhe universitetit “Aleksandër Xhuvani”. Aty ku ndërtimi mund të bëhet pranë receptorëve të ndjeshëm, aktivitetet që mund të gjenerojnë pluhur do të jenë shumë të lokalizuara dhe do të menaxhohen përmes masave standarde të zbutjes si p.sh. lagia e tokës së zhveshur dhe kontrollit të trafikut.</p>
Emetimet nga trafiku i ndërtimit	I ulët	<p>Pjesa më e madhe e trafikut të ndërtimit do të ndodhë larg receptorëve të ndjeshëm, siç janë komunitetet e banimit. Aty ku ndërtimi mund të bëhet pranë receptorëve të ndjeshëm, shkarkimet nga trafiku i ndërtimit ka të ngjarë të jenë të kufizuara dhe të menaxhueshme përmes menaxhimit dhe mirëmbajtjes standarde të automjeteve. Gjatë lëvizjes së automjeteve me naftë, ndotësit më problematikë të ajrit që emetohen janë: PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>, CO nga djegia e papërshtatshme, hidrokarburet (HC ose VOC) të cilat prodhohen gjithashtu nga djegia e papërshtatshme dhe NO<sub>x</sub> të cilat prodhohen në temperatura të larta të djegies.</p>
Zhurmat dhe dridhjet	I ulët	<p>Pjesa më e madhe e ndërtimit të ZZHP do të bëhet larg nga receptorët e ndjeshëm, siç janë komunitetet e banimit, ku me komunitetet më të afërta janë të vendosura rreth 600 m nga zona e Projektit. Megjithatë, ndërtimi i LTTL është afër shtëpive dhe universitetit “Aleksandër Xhuvani”.</p> <p>Aty ku ndërtimi mund të kryhen pranë receptorëve sensitivë dhe aktivitetet që gjenerojnë zhurma janë të pashmangshme, këto do të kenë një kohëzgjatje të kufizuar në çdo vendndodhje dhe do të kufizohen në ato orë të</p>

Tema	Niveli i pritshëm i ndikimit	Objektivi i vlerësimit fillestar
		ditës që të minimizojnë shqetësimet.
Ndikimet e mundshme në cilësinë e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore	I ulët	<p>Gjatë fazës së ndërtimit nuk do të ketë ndikime të dukshme për sa i përket ndryshimeve gjeologjike dhe hidrogjeologjike. Punimet që do të kryhen në Parkun Diellor FV do të jenë të vogla dhe mbi tokë. Vendndodhja e Projektit FV është e rrafshët dhe nuk nevojitet shumë punë për sheshimin/nivelimin. Do të kryhen gërmime, p.sh. për vendosjen e kablove brenda kanaleve, por kjo punë mund të menaxhohet me efektivitetet përmes praktikave të mira standarde të ndërtimit mjedisor. Duhet të theksohet se strukturat mbështetëse për panelet FV instalohen me shtylla dhe kjo kufizon nevojën për gërmim ose pastrim të tokave/bonifikim.</p> <p>Ndërtimi nuk duhet të destabilizojë tokat duke kufizuar kështu potencialin e erozionit të tokës gjatë reshjeve të mëdha dhe sedimentimit në kanalet kulluese dhe kanalet ujitëse të zonës. Ndikime të tjera lidhur me to mund të përfshijnë ngjarje aksidentale (derdhje, rrjedhje dhe shkarkime të pakontrolluara) për shkak të pranisë së materialeve të rrezikshme në vend, përfshirë karburantin. Për më tepër, ruajtja dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme dhe të parrezikshme brenda terrenit mund të paraqesin rreziqe për ndotje të mundshme të tokës, veçanërisht në rastet e praktikave jo të duhura të menaxhimit të mbetjeve.</p> <p>Pjesa LTTL e Projektit nuk përfshin hapjen e kanaleve të konsiderueshme në terrene kodrinore ose malore ose hapje tunelesh. Punimet që do të kryhen do të zhvillohen kryesisht mbi tokë dhe do të prekin shtresën e sipërme të tokës së punueshme pa ujitje.</p>
Ndikimet e mundshme mbi tokën	I ulët	Zbatimi i praktikave standarde për të shmangur derdhjet e naftës/ karburantit dhe çlirimi i ujërave të ndotura nga zonat e sheshit të ndërtimit do të parandalojë/ minimizojë çlirimin e çdo rrjedhje kimike që ka potencial të ndotë tokën. Për më tepër, zonat e gërmimeve të tokës do të mbushen me dhé, dhe do të ndjekin praktikën e mirë standarde, me zona me tokë të shkrifët/ të zhveshur që do të rivegjetohen për të minimizuar erozionin e mundshëm të tokës.
Ndikimet e drejtpërdrejta në zonat e mbrojtura	I ulët	Vendndodhja e propozuar për projektin FV dhe infrastrukturën shoqëruese janë të vendosura në një distancë nga Zonat e Mbrojtura dhe nuk parashikohet të ketë asnjë ndikim fizik të drejtpërdrejtë tek ZM gjatë fazës së ndërtimit pasi të gjitha aktivitetet do të jenë brenda gjurmës së projektit.
Ndikimet në habitat dhe florë	Të ulëta-mesatare	Përgatitja e vendit dhe puna e ndërtimit në kantier mund të përfshijë një zonë të madhe vegjetacioni. Megjithatë, pastrimi dhe sheshimi i tërë vendndodhjes nuk duhet të jetë e nevojshme falë strukturës mbështetëse të panelit që

Tema	Niveli i pritshëm i ndikimit	Objektivi i vlerësimit fillestar
		<p>do të instalohet përmes vendosjes njëri mbi tjetrin. Për më tepër, bimësia brenda zonës së projektit FV është identifikuar si e degraduar rëndë për shkak të aktiviteteve të mëparshme bujqësore dhe të mbikullotjes. Kjo tokë është e kripur e me prodhim të ulët dhe nuk mund të përdoret për bujqësi.</p> <p>Ndikimet tek habitatet dhe speciet nga aktivitetet e gërmimit dhe të ndërtimit, në mënyrë specifike ndikimet tek speciet që ndërtojnë strofulla, dhe efekti i depozitimit të sedimenteve dhe ndotësve në trupat ujorë përreth do të merret në konsideratë brenda VNMS-së si dhe do të identifikohen masat e duhura të zbutjes.</p>
Ndikimet në faunën dhe ekologjinë ujore	Të ulëta-mesatare	<p>Kanalet kulluese brenda Projektit FV dhe ato që kryqëzohen me LTTL janë habitate të rëndësishme dhe të ndjeshme për jetën ujore, duke përfshirë bretkosat, zhabat, breshkat e ujit, peshqit etj. pasi ato ofrojnë terren për shumim dhe ushqim dhe mund të ofrojnë gjithashtu habitate të përshtatshme për gjitarët, siç është vidra. Ndikimi i drejtpërdrejtë në këto zona mund të shmanget përmes zbatimit të masave të duhura zbutëse..</p> <p>Asnjë aktivitet i konsiderueshëm i lakuriqëve të natës nuk është identifikuar gjatë vëzhgimeve fillestare në terren dhe asnjë specie e rrezikuar nuk u identifikua si e pranishme brenda zonës së Projektit. Fauna tokësore konsiderohet përgjithësisht e lëvizshme dhe do të jetë në gjendje të shmangë ndikimet e drejtpërdrejta për shkak të aktiviteteve të ndërtimit.</p> <p>Rreziqet që lidhen me aktivitetet e ndërtimit në zonën e projektit mund të menaxhohen në mënyrë të përshtatshme përmes praktikave të mira dhe standarde të menaxhimit të ndërtimit. Zonat e drejtpërdrejta të tokës që ndikohen nga ndërtimi i LTTL-së do të jenë të lokalizuara dhe kufizuara për sa i përket gjurmëve të kullave.</p>
Ndikimi te zogjtë	Të ulëta-mesatare	<p>Duke qenë se zogjtë janë shumë të lëvizshëm, i vetmi ndikim i rëndësishëm gjatë ndërtimit është te zogjtë me fole në tokë, nëse janë të pranishëm në zonën e Projektit FV dhe në veçanti gjatë sezonit të shumimit. Gjatë fazës së përcaktimit të fushëveprimit nuk u identifikua prania e zogjve që ndërtojnë foletë në tokë brenda gjurmës së Projektit FV.</p> <p>Për këtë arsye, përpara se të nxirret ndonjë konkluzion përfundimtar në lidhje me avifaunën, Voltalia ka kryer studime të shpendëve në zonën e projektit dhe përgjatë linjave të transmetimit në një moment më të përshtatshme që mbulon si duhet sezonin e shumimit të shpendëve, në qershor 2021.</p> <p>Rreziqet e tjera të përgjithshme për zogjtë që lidhen me aktivitetet e ndërtimit mund të menaxhohen në mënyrë të përshtatshme përmes zbatimit të praktikave të përshtatshme të menaxhimit.</p>

Tema	Niveli i pritshëm i ndikimit	Objektivi i vlerësimit fillestar
Efektet vizuale dhe peizazhi	I ulët	<p>Aktivitetet e ndërtimit dhe prania e pajisjeve, makinerive dhe materialeve do të jetë e përkohshme dhe e kufizuar, dhe duke marrë parasysh se nuk ka receptorë të ndjeshëm brenda 100 m nga vendi i Projektit, ndikimi në dukshmëri parashikohet të jetë minimal.</p> <p>Projekti është shumë pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Porto Romanos, zonë kryesisht industriale, ndaj dhe ndikimi vizual do të jetë i vogël dhe i parëndësishëm. Ky park fotovoltaik nuk do të ndikojë në turizmin e zonës.</p>
Gjenerimi i mbetjeve gjatë ndërtimit	I ulët	<p>Asgjësimi i mbetjeve nga paketimi dhe i atyre shtëpiake nga punëtorët gjatë ndërtimit do të bëhet në vendet e landfillit të miratuara. Materialet e gërmuara (materiale të prishura) mund të ruhen përkohësisht në vendndhje gjatë ndërtimit. Të gjitha mbetjet e ndërtimit mund të menaxhohen në mënyrë efektive duke ndjekur procedurat standarde të menaxhimit të mbetjeve.</p>
Ndikimet social-ekonomike		
Blerja e tokave dhe ndryshimet në përdorimin e tokës	I ulët	<p>Bazuar në vëzhgimin fillestar të vendit, toka e zonës së përcaktuar për Projektin FV nuk ka aktivitete të përhershme bujqësore duke qenë se cilësia e tokës është identifikuar si e ulët për shkak të kripësisë së lartë të saj. Për më tepër, toka është klasifikuar si pronë shtetërore dhe deri më tani nuk është sinjalizuar apo identifikuar asnjë përdorues i tokës.</p> <p>Projekti do të kërkojë blerjen e përhershme të tokës për vendosjen e shtyllave LTTL. Aksesit në këtë tokë do të kufizohet gjatë fazës së ndërtimit ndërkohë që vendosen përçuesit dhe telat. Prandaj, zonat që i nënshtrohen këtyre punimeve tokësore nuk do të jenë të aksesueshme për një periudhë të caktuar kohe.</p> <p>Do të kryhen konsultime me pronarët/përdoruesit e tokës, duke nënshkruar një marrëveshje kompensimit për blerjen e tokës, nëse është e zbatueshme.</p> <p>Blerja e tokës në lidhje me projektin dhe/ose kufizimet në përdorimin e tokës mund të shkaktojë zhvendosje ekonomike që do të thotë humbje të aseteve ose aksesit që çon në humbje të burimeve të të ardhurave ose mjeteve të tjera të jetesës. Në përputhje me KP 5 të BERZH-it "Blerja e Tokës, Zhvendosja e Pavullnetshme dhe Zhvendosja Ekonomike", shoqëria do të zhvillojë një Plan të Rivendosjes së Jetesës (PRJ) ose Planin e Veprimit të Zhvendosjes (PVZH) për të shërbyer si udhëzues për procesin e blerjes së tokës pas VNMS-së.</p>



Tema	Niveli i pritshëm i ndikimit	Objektivi i vlerësimit fillestar
Shëndeti, Siguria dhe Mbrojtja e Komunitetit	Të ulëta-mesatare	<p>Zona e ndërtimit ndodhet në afërsi të disa vendbanimeve që mund t'i rrezikojnë këto komunitete. Gjithsesi, çdo ndërtim që mund të kryhet afër komuniteteve do të lokalizohet dhe shëndeti, siguria dhe mbrojtja e komunitetit mund të menaxhohen përmes masave standarde të menaxhimit të ndërtimit. Përdorimi i rrugëve ekzistuese për të aksesuar vendin e projektit dhe prania e punëdhënësve të huaj mund të sjellë rreziqe në shëndetin dhe sigurinë e komunitetit.</p> <p>Nga një vlerësim i përgjithshëm i LTTL -së së propozuar, u identifikuan disa kufizime për ndërtesat nën linjat e transmetimit, veçanërisht pranë nënstacionit të Porto Romanos. Për më tepër, një LTTL ekzistuese përshkon të njëjtën zonë, duke shkaktuar në këtë mënyrë ndikime të mundshme kumulative mbi receptorët, të cilët janë kryesisht aktivitete dhe biznese tregtare. Nga ana tjetër, asnjë receptor i zonave të mbrojtura, habitateve pyjore apo zonave të trashëgimisë kulturore nuk duket të ndikohen nga objektet e projektit.</p> <p>Për më tepër, kufizimet e tjera do të vlerësohen më tej brenda VNMS-së duke kryer shqyrtime në terren për të kontrolluar për një kryqëzim me infrastruktura të tjera (linjat e tjera të energjisë, telefonisë, antenave, godinave, etj.), që do të bënin të nevojshme ndryshimin e rrugës së propozuar të LTTL -së.</p>
Gjenerimi i Trafikut të Ndërtimit	I ulët	Do të ketë lëvizje të konsiderueshme të automjeteve gjatë fazës së ndërtimit për shkak të shpërndarjes së pajisjeve dhe materialeve, si dhe punëtorëve dhe transportit të mbetjeve. Gjenerimi i trafikut në rrjetin rrugor lokal, kapaciteti i rrjetit (rrugët lokale), çështjet e sigurisë, kapaciteti mjedisor dhe ndikimi i mundshëm të përdoruesit e tjerë të rrugës. Masat standarde për menaxhimin e trafikut të ndërtimit duhet të jenë të mjaftueshme për të menaxhuar ndikimet e trafikut brenda zonave më të populluara.
Mundësitë për punësim	I ulët (pozitiv)	Gjatë fazës së ndërtimit, Projekti do të sigurojë mundësi të drejtpërdrejta dhe/ose të tërthorta punësimi afatshkurtër dhe afatmesëm. Mund të ketë mundësi të reja për bizneset lokale siç mund të nevojiten nga zhvillimi i projektit. Punëtorët do të fitojnë aftësi të reja profesionale përmes trajnimit dhe përvojës së punës, të cilat do të rrisin mundësitë për punësim në të ardhmen. Nuk ka ende të dhëna për numrin e personelit të nevojshëm për periudhën e ndërtimit dhe funksionimit, por projekti do të synojë të maksimizojë mundësitë për punësim lokal.
Trashëgimia kulturore	I ulët	<p>Sipas studimeve paraprake në zyrë dhe konsultimit me Ministrinë e Kulturës, asnjë objekt i trashëgimisë kulturore nuk ndodhet brenda korridorit 1.8 km nga gjurma e projektit FV dhe brenda korridorit 1 km nga traseja e LTTL.</p> <p>Kërkime të mëtejshme do të kryhen gjatë Fazës së VNMS-së dhe konsultimit me Ministrinë e Kulturës për të</p>

Tema	Niveli i pritshëm i ndikimit	Objektivi i vlerësimit fillestar
		<p>identifikuar objektet e trashëgimisë arkeologjike dhe/ose kulturore brenda zonës së ndikimit të gjurmës së linjës së transmetimit.</p> <p>Për aktivitetet e ndërtimit të Projektit do të zbatohet Procedura e Gjetjeve Rastësore.</p>
Faza operacionale		
Pasoja në mjedis		
Shkarkimet në ajër dhe gjenerimi i zhurmës	I ulët	<p>Projektet FV janë të natyrës pasive dhe nuk ka emetime në ajër dhe burime domethënëse zhurme që lidhen me fazën operacionale të Projektit. I vetmi trafik që lidhet me fazën e funksionit ka të bëjë me punëtorët (rreth 20 persona) që mbërrijnë në vendndodhje dhe çdo automjet që mund të nevojitet për të menaxhuar pastrimin e paneleve.</p> <p>Efekti i kurorës mund të prodhojë zhurmë në nivel të kufizuar gjatë kushteve të motit me mjegull, lagështirë ose me shi, por kjo është shumë e lokalizuar (brenda disa dhjetëra metrash). Ndikimet e zhurmës mund të zvogëlohen duke përdorur ndarës të ngurtë dhe duke rritur rrezën e përcjellësit në zonat e ndjeshme.</p>
Mbetjet dhe Ujërat e Ndotura	I ulët	<p>Meqenëse projektet FV kanë natyrë pasive, ujërat e zeza dhe mbetjet e gjeneruara gjatë funksionimit do të kufizohen në ato të prodhuara nga numri i vogël i punëtorëve të përhershëm të pranishëm në vendndodhje. Uji nga pastrimi i panelit nuk do të përmbajë asnjë kimikat, nuk ka nevojë për trajtim dhe për këtë arsye nuk konsiderohet ujë i ndotur.</p> <p>Nevojat për materiale ose kimikate të rrezikshme gjatë fazës së funksionimit janë shumë të kufizuara.</p>
Ndikimi në burimet ujore dhe përdorimin e tyre	I ulët	<p>Parku diellor do të mbulojë rreth 120.85 ha tokë, megjithatë zona do të mbetet kryesisht e hapur dhe kanalet e kullimit dhe ujitjes do të mbeten të paprekur dhe do të funksionojnë normalisht.</p> <p>Uji nevojitet për pastrimin periodik të paneleve dhe do të furnizohet nga një burim i miratuar.</p>
Ndikimi në zonat e mbrojtura, habitatet, flora dhe fauna	I ulët	<p>Asnjë zonë/habitat i mbrojtur ose flora e fauna me status të mbrojtur nuk janë evidentuar në ZZHP. Zona përkatëse natyrore e identifikuar më afër zonës së projektit është Rrushkulli, Zonë e Mbrojtur pranë Gjirit të Lalzit, 8 km në veri nga zona e projektit. Nuk parashikohet asnjë ndikim nga aktivitetet e propozuara në këtë zonë, megjithatë</p>

Tema	Niveli i pritshëm i ndikimit	Objektivi i vlerësimit fillestar
		<p>ndotja e ujit, ajrit dhe biodiversitetit nuk do të lejohet.</p> <p>Gjatë funksionimit bimësia do të lejohet të rikuperohet me rritjen e bimëve të kontrolluar për të parandaluar krijimin e hijeve nga bimët te panelet. Duke qenë se projektet diellore fotovoltaike kanë natyrë pasive, do të ketë ndikim të kufizuar në faunë gjatë fazës së funksionimit.</p>
Ndikimi te zogjtë	Mesatar	<p>Zona e Mbrojtur e vendosur në Gjirin e Lalzit dhe rezervati i mbrojtur i Rrushkullit janë të dyja Zona të Rëndësishme të Shpendëve për shkak të numrit të madh të shpendëve ujorë që vijnë në sezonin e shumimit, e dimrit dhe në sezonin e migrimit.</p> <p>Edhe pse janë ngritur disa shqetësime në lidhje me ndikimin e mundshëm të projekteve FV diellore në shkallë të gjerë, ku panelet ngjajnë me trupat ujorë dhe për këtë arsye tërheqin zogjtë ujorë, ky ndikim nuk është identifikuar më parë si një çështje kryesore në projekte të tjera të ngjashme të paneleve FV në shkallë të gjerë. Për më tepër, indikacionet fillestare tregojnë që në rrugën e LTTL nuk kalojnë rrugë të tilla migratore për zogjtë.</p> <p>Duke qenë se projektet diellore FV mbulojnë një sipërfaqe të madhe, ekziston rreziku që prania e tyre të ndikojë në zogjtë që ndërtojnë foletë në tokë, nëse janë të pranishëm në zonën e Projektit; ky rrezik do të konsiderohet më tej në VNMS.</p> <p>Ka ndikime të mundshme tek shpendët që përdorin kullat e transmetimit për foletë duke ngritur foletë nëpër tela ose duke përdorur vrimat e vetë kullës. Për më tepër, ka rrezik që zogjtë e mëdhenj fluturues dhe tufat e mëdha të përplasen me telat gjatë migrimit në kushte të vizibilitetit të dobët ose në vendet ku shtigjet e fluturimit ngushtohen.</p> <p>Nevojiten studime të mëtejshme avifaunale për të hetuar ndikimet e mundshme në speciet lokale dhe migratore, si dhe te zogjtë që ngenë foletë në tokë dhe për të identifikuar masat zbutëse kur është e përshtatshme.</p>
Efektet vizuale dhe peizazhi	Të ulëta-mesatare	<p>Do të ketë ndryshime në cilësi dhe në karakterin e peizazhit për shkak të pranisë së paneleve diellore në të gjithë vendndodhjen 120 Ha, dhe ka mundësi që projekti të ketë vizibilitet nga pikëpamjet përreth. Megjithatë, panelet diellore FV janë struktura të ulëta (jo më shumë se 2.5 m mbi nivelin e tokës), dhe kjo shoqërohet me një numër të kufizuar receptorësh rezidencial, do të thotë që ndikimet vizuale për shkak të pranisë së Projektit diellor FV parashikohet të jenë minimale.</p> <p>Mund të ketë ndikim vizual në receptorët rezidencialë që ndodhen pranë gjurmës së LTTL megjithatë, ndikimi vizual konsiderohet të jetë i vogël për shkak të numrit të kufizuar të pronave të banimit që ndodhen pranë gjurmës</p>

Tema	Niveli i pritshëm i ndikimit	Objektivi i vlerësimit fillestar
		<p>së LTTL . Do të organizohen disa konsultime të mëtejshme me banorët lokalë në lidhje me ndikimet vizuale.</p> <p>Pritet të ketë ndikim tek drejtuesit e mjeteve që do të lëvizin në autostradën duke kaluar në kantier, megjithatë do të merren masat e duhura zbutëse për të zvogëluar efektin e reflektimit</p>
Ndikimet social-ekonomike		
Blerja e tokës	I ulët	<p>Bazuar në vëzhgimin fillestar, toka e zonës së përcaktuar për Projektin FV nuk ka aktivitete të përhershme bujqësore duke qenë se cilësia e tokës është identifikuar si e ulët për shkak të kripësisë së lartë të saj. Për më tepër, toka është klasifikuar si pronë shtetërore dhe deri më tani nuk është sinjalizuar apo identifikuar asnjë përdorues i tokës.</p> <p>Projekti do të kërkojë blerje të përhershme të tokës për vendosjen e shtyllave për LTTL, gjë që mund të kufizojë aktivitetet tregtare që i nënshtrohen blerjes së tokës.</p> <p>Do të kryhen konsultime me pronarët/ përdoruesit e tokës, duke nënshkruar një marrëveshje kompensimit për blerjen e tokës, nëse është e nevojshme.</p>
Mundësitë për punësim	Të ulëta (pozitive)	Gjatë fazës së operimit do të ketë një numër të kufizuar mundësish punësimi, duke përfshirë punëtorët teknikë dhe gjysmë të aftë, si dhe personelin e sigurisë.
Shëndeti, Siguria dhe Mbrojtja e Komunitetit	I ulët	<p>Projekti FV është afër disa vendbanimeve, por do të zbatohet siguria e duhur për të parandaluar hyrjet e paautorizuara.</p> <p>Lëvizja e trafikut gjatë fazës së funksionimit do të jetë e kufizuar vetëm për punonjësit që mbërrijnë në vendin e punës.</p>
Ndikimet e mundshme nga fushat elektrike dhe magnetike (FEM)	E ulët-mesatar	Zona pranë nënstacionit të Porto Romanos e përshkruar nga projektimi aktual i LTTL-së, është pranë aktiviteteve tregtare dhe bizneseve. Një LTTL ekzistues përshkon të njëjtën zonë, duke shkaktuar në këtë mënyrë ndikime të mundshme kumulative në këta receptorë.



## 7. PLANI I PROPOZUAR PËR VNMS-në

### 7.1. Hyrje

Sapo të përmbyllen komentet publike mbi Raportin e Fushëveprimit, raporti do të finalizohet dhe do të jetë bazë për termat e referencës për raportin e VNMS-së. Edhe pse kjo përfaqëson fundin e fazës zyrtare të përcaktimit të Fushëveprimit të VNMS-së, sipas “Udhëzuesi për Fushëveprimin<sup>38</sup>” i Komisionit Evropian, veprimtaria e Fushëveprimit duhet të vazhdojë gjatë gjithë procesit të VNMS-së, në mënyrë që fushëveprimi të mund të ndryshohet nëse do të ketë çështje dhe informacione të reja. Faza pasuese e Vlerësimit të Ndikimit përshkruhet hollësisht më poshtë.

Qëllimi i Fazës së Vlerësimit të Ndikimit të një VNMS-je është:

- Të trajtojë çështje që janë ngritur gjatë fazës së fushëveprimit;
- Trajtimi dhe vlerësimi i alternativave të aktivitetit të propozuar me metoda krahasuese;
- Përcaktimi i kushteve mjedisore dhe sociale para fillimit të projektit;
- Trajtimi dhe vlerësimi i të gjitha ndikimeve të rëndësishme të identifikuar; dhe
- Formulimi i masave lehtësuese.

Ky Kapitull ofron Planin e propozuar të Studimit për VNMS dhe është strukturuar si më poshtë:

- Mbledhja e të dhënave bazë dhe studimet e specializuara
- Metodologjia e vlerësimit të ndikimit
- Struktura e propozuar e Raportit të VNMS-së

### 7.2. Studimi fillestar

Statusi fillestar mjedisor dhe socio-ekonomik i zonës së projektit dhe zonës përreth do të sigurojë një kontekst brenda të cilit do të vlerësohen ndikimet e Projektit. Kjo gjithashtu do të ndihmojë në planifikimin dhe strategjinë e menaxhimit mjedisor dhe shoqëror për të minimizuar ndikimet e mundshme të identifikuar për shkak të aktiviteteve të Projektit në mjedisin përreth dhe do të sigurojë një pikë referimi me të cilën mund të monitorohen ndryshimet e ardhshme për të vlerësuar performancën.

Do të vlerësohet baza fillestare mjedisore dhe sociale që mbulon një zonë prej 4 km nga kufiri i Projektit, si dhe një zonë prej 1 km përgjatë gjurmës së linjës së transmetimit (500 m në të dyja anët) - në vijim referuar si zona e studimit (shih Figura 45). Një studim për zbulimin e zonës së studimit do të kryhet për të identifikuar lokacione sensitive mjedisore dhe sociale brenda kësaj zone. Të dhënat fillestare mjedisore dhe sociale do të mblidhen përmes studimeve primare, studimeve të specializuara dhe vëzhgimeve të bëra gjatë vizitave në terren, si dhe nëpërmjet burimeve dytësore si studimi i literaturës dhe diskutimeve me palët e interesit në fjalë.

Informacioni dytësor për studimin bazë do ta ketë burimin nga informacionet i disponueshëm publikisht, duke përfshirë literaturën aktuale shkencore, literaturën jo-teknike (raporte mjedisore, artikuj, dhe dokumentet e tjera VNM dhe VSM nëse ka), bazat e të dhënave në internet dhe burimet e tjera dytësore të të dhënave.

<sup>38</sup> Komisioni Evropian "Vlerësimi i Ndikimit në Mjedisin e Projekteve - Udhëzime për Fushëveprimin (Direktiva 2011/92/BE e ndryshuar me Direktivën 2014/52/BE)" 2017




Figura 45. Harta që tregon Zonën e Studimit Bazë/Zona direkte e Influencës

### 7.2.1. Përcaktimi i Zonave të Influencës (ZI) për Projektin

Shkalla e efektit të një aktiviteti projekti në një burim të caktuar fizik, biologjik ose shoqëror do të ndryshojë dhe quhet Zona e Influencës (ZI). Referuar projektit të propozuar, do të ketë një zonë të caktuar të ndikimit për secilin aspekt/përbërës të mjedisit, përfshirë aspektin socio-ekonomik. Do të bëhet një identifikim paraprak i ZI-ve dhe gjatë studimeve bazë, në rast se do të konsiderohen si të domosdoshme nga specialistët përkatës të ekipit të Konsulentit, mund të ketë ndryshime.

Në mënyrë të veçantë, Zonat e Influencës do të përfshijnë si më poshtë:

- Zonat që mund të preken nga Projekti, aktivitetet dhe objektet e Projektit (ZI-të e drejtpërdrejta); dhe zhvillimi i paplanifikuar por i parashikueshëm i shkaktuar nga Projekti që mund të ndodhë më vonë ose në një vend tjetër (ZI-të indirekte);
- Objektet e shoqëruese që nuk janë pjesë e projektit, por që nuk do të ishin ndërtuar ose zgjeruar nëse Projekti nuk do të ekzistonte dhe pa të cilat Projekti nuk do të ishte i zbatueshëm; dhe,
- Ndikimet kumulative që rezultojnë nga ndikimi në rritje në zona ose burime të ndikuara drejtpërdrejt nga Projekti nga zhvillime të tjera ekzistuese, të planifikuara ose të përcaktuara në mënyrë të arsyeshme.

Konsulenti gjykon se Zona e Influencës do të ndryshojë në varësi të komponentit ose aspektit mjedisor dhe llojit të ndikimit, por në çdo rast, ajo përfshin të gjithë zonën e Projektit, ku ka gjasa që të ketë ndikime domethënëse.

Në mënyrë që të kuptohen sa më mirë kushtet ekzistuese mjedisore dhe sociale (burimet dhe receptorët) në Zonën e Influencës së Projektit, një ekip specialistësh do të kryejë studime të mëtejshme nga zyra dhe në terren në mbështetje të procesit të VNMS-së. Për përcaktimin e Zonës së Influencës do të ndërmerret një qasje konservatore por e arsyeshme.

### 7.2.2. Studimet nga zyra

Studimet nga zyra do të kryhen për të mbledhur të dhëna dhe informacione mjedisore për studimin e VNMS-së. Lloji i dokumenteve që do të merren në konsideratë mund të përfshijnë raporte të tjera të VNMS-së, artikuj, studime të lidhura me to, harta dhe foto.

Të dhënat do të mblidhen nga autoritetet qeveritare, projektet ekzistuese aktualisht në ndërtim dhe projektet në fazë operimi dhe infrastrukturat dhe objektet e tjera të lidhura me to, OJQ-të dhe institucionet përkatëse kërkimore. Gjithashtu, do të kryhet një kërkim i literaturës për të identifikuar raporte kërkimore dhe shkencore që janë vendosur në dispozicion të publikut, me rëndësi për vendndodhjen e Projektit dhe zonën në përgjithësi.

Së fundmi, studimet e inxhinierisë së projektit do të rishikohen për të marrë informacion sasior mbi elementët e mjedisit. Studimet që mund të sigurojnë të dhëna të dobishme do të përfshijnë hetimet gjeoteknike, proceset dhe operacionet të burimeve ujore, studime të kullimit të ujërave sipërfaqësore dhe studime të shkarkimeve në ajër.

Studimet nga zyra do të kryen kryesisht për të mbledhur të dhëna mjedisore dhe sociale për Zonën e Influencës. Burimet e informacionit ekzistues në lidhje me Zonën e Influencës së Projektit dhe më gjerë përfshijnë:

- VNM-ja e kryer në zonën përreth;
- Statistikat Qeveritare dhe Planet e Zhvillimit;
- Studimet mbi Biodiversitetin e Zonës.

Tabela n

Nr.	Atributi Mjedisor	Burimi
1.	Të dhënat meteorologjike afatgjata	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dhëna nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM)</li> </ul>
2.	Gjeologji, Hidrologji dhe Hidrogeologji	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dhëna nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM)</li> <li>• Harta gjeologjike, hidrologjike dhe hidrogeologjike nga</li> </ul>

Nr.	Atributi Mjedisor	Burimi
		Infrastruktura Kombëtare e të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI/ ASIG) <sup>39</sup>
3.	Përdorimi i tokës/pronësia	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Imazhet satelitore/ Programi Corine</li> <li>• Harta Kadastrale</li> </ul>
4.	Mjedisi socio-ekonomik	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dhënat nga Censusi i Parë 2011;</li> <li>• Baza e të dhënave për fshatrat (2011); dhe</li> <li>• Studime, artikuj dhe informacione të tjera të publikuara të disponueshme në domenin publik mbi aspekte të tilla si ujitja, sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm, modeli i jetesës, toka, qeverisja lokale dhe decentralizimi, shoqëria civile dhe OJQ-të, si dhe politikat ekonomike dhe planet e zhvillimit rajonal që ndiqen nga shteti.</li> </ul>
5.	Biodiversiteti	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Studime mjedisore, literaturë shkencore dhe vlerësime të tjera ekzistuese të biodiversitetit të disponueshme për zonën e projektit;</li> <li>• Planet kombëtare ose rajonale (p.sh., Vlerësimet Strategjike Mjedisore, Strategjitë Kombëtare të Biodiversitetit dhe Planet e Veprimit);</li> <li>• Programet ose iniciativat për ruajtjen e zonës dhe rrethinave të saj (të kryera ose të planifikuara);</li> <li>• Zonat e Mbrojtura, Baza e të Dhënave Botërore për Zonat e Mbrojtura (BDHJP).</li> <li>• BirdLife International</li> <li>• Vendndodhja e çdo habitati që vlen për t'u ruajtur, duke përfshirë zonat e trashëgimisë botërore; Zonat e Mbrojtura; Zonat Kryesore të Biodiversitetit (ZKB) (Zonat e Rëndësishme të Impiantëve), Zonat e Rëndësishme të Zogjve (IBA), Vendet RAMSAR, Vendet Smeralde Kandidate etj.</li> <li>• Të dhënat ekzistuese të specieve (p.sh., Lista e Kuqe e IUCN e Specieve të Kërcënuara, Baza e të Dhënave Globale e Specieve Pushtuese, Planet e Veprimit të Specieve të IUCN dhe listat e specieve të mbrojtura në shkallë vendi, p.sh. Lista e Kuqe Shqiptare), për të identifikuar nëse ka ndonjë specie të kërcënuar që njihet ose mund të jetë e kërcënuar, specie endemike dhe/ose speciet migratore brenda zonës së studimit të projektit;</li> <li>• Të dhëna ekzistuese, për të identifikuar çdo specie të mundshme pushtuese në zonën e studimit të projektit dhe peizazhin përreth;</li> <li>• Raportet kombëtare për Censusin Ndërkombëtar të Zogjve të Ujit;</li> <li>• Dokumente të tjera planifikimi si Strategjia e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës;</li> <li>• Rezultatet nga takimet konsultative me organet përkatëse.</li> </ul>

<sup>39</sup> <https://geoportal.asig.gov.al/en/services?category=geology>



### 7.2.3. Studime të identifikuara të specializuara

Një numër çështjesh të mundshme janë identifikuar gjatë këtij studimi të fushëveprimit, të cilat kërkojnë studime / anketa të specializuara për të kuptuar më në detaje ndikimin e mundshëm Studimet e mëposhtme të specializuara janë identifikuar si të nevojshme për të adresuar boshllëqet aktuale të të dhënave:

- Biodiversiteti, duke përfshirë florën dhe faunën tokësore, avifaunën dhe ujin;
- Cilësia e tokës dhe ujit;
- Socio-ekonomike.

Të dhënat kryesore do të mblidhen nga studimet në terren të kryera nga specialistët mjedisorë dhe socio-ekonomikë. Do të caktohen specialistë të kualifikuar për çdo fushën të studimit dhe të cilët duhet të kenë njohuri të kushteve lokale. Programi i përgjithshëm për studimet është paraqitur Tabela 22, Tabela 23, dhe Tabela 24 më poshtë. Më poshtë jepet qëllimi ose termat e referencës për çdo studim të specializuar të propozuar.

#### 7.2.3.1. Studime për biodiversitetin

Mbledhja e të dhënave dhe studimet bazë bazë të biodiversitetit do të kryhen nga specialistë të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme, të cilët mbulojnë 4 elementet vijues të biodiversitetit:

- Flora
- Fauna Tokësore
- Avifauna (zogjtë)
- Sistemet Ujore

Zona e studimit që do të vëzhgohet do të përfshijë:

- gjurmën e projektit dhe zona përreth deri në 2 km rreze nga vendndodhja e propozuar;
- gjurma e propozuar e linjës së transmetimit, korridori me gjerësi 1 km për linjën e transmetimit (secila anë 0.5 km nga qendra) për studimin;
- zonat e mbrojtura përreth (pjesa jugore e PK) dhe çdo zonë e identifikuar si e rëndësishme pas shqyrtimit në zyrë.

Shtirja e zonës së studimit të vendndodhjes është paraqitur më lart, Figura 45 ndërsa fushëveprimi është paraqitur më poshtë. Programi i studimit është paraqitur në Tabela 22 dhe Tabela 23 më poshtë. Standardet e KP6 dhe BE do të merren parasysh në vlerësimin e ndikimit në biodiversitet.

#### Fauna Tokësore

Studimi i faunës tokësore do të përqendrohet, por pa u kufizuar në speciet e mëposhtme të kafshëve:

- Lakuriqët e natës (të gjitha speciet: vendet ku kanë ngritur foletë, zonat ku kërkojnë ushqim);
- Gjitarë të tjerë, të tillë si vidra, vjedulla, qelbësi, çakalli, gjeri;
- Amfibët dhe zvarranikët, të tilla si bretkosat dhe zhabat, breshka, breshka e pellgut, breshka e ujit, gjarpërinjtë, etj.

Në një hartë do të paraqitet çdo specie (lakuriq nate, gjitar, zvarranik dhe amfib) e pranishme që klasifikohet si e rrezikuar në mënyrë kritike ose është pjesë e Listës së Kuqe të IUCN; me rëndësi kombëtare/rajonale, duke përfshirë ato në Listën e Kuqe Shqiptare dhe/ose objekt i dispozitave të legjislacionit shqiptar. Do të regjistrohen koordinatat GPS të çdo specie të tillë 'prioritare'.

Imazhet satelitore dhe fotografitë ajrore do të përdoren për të zgjedhur vendet e kampionimit në habitate të përshtatshme për speciet 'prioritare' brenda zonës së Projektit FV, dhe përgjatë gjurmës së Linjës Ajrore së Transmetimit (LTTL), të tilla si skajet e pyjeve, rrjedhat e ujit (kanalet e ujitjes, kanalet), ndërtesat e braktisura dhe bunkerët.

Vizitat e studimit do të ndërmerren në kushte të përshtatshme për regjistrimin e shenjave të aktivitetit të specieve duke shmangur erërat e forta dhe reshjet e dendura.

Ky studim do të kryhet nga ekologë me përvojë (grup pune i përbërë nga një ekspert drejtues dhe një asistent në terren) me njohuri për me metodat gjetjes, zbulimit dhe identifikimit të specieve (lakuriqët e natës, gjitarët, amfibët dhe zvarranikët).

Aty ku do të vihen re, të gjitha shenjat e aktivitetit të specieve, do të paraqiten në një hartë të përshtatshme për të treguar vendin ku janë regjistruar së bashku me koordinatat GPS për të përcaktuar vendndodhjet e sakta. Do të përgatitet një përshkrim i llojit të habitatit, përshtatshmërisë dhe cilësisë për të mbështetur speciet 'prioritare', për të vlerësuar kapacitetin e mundshëm mbajtës të habitatit/ madhësisë së popullatës.

Informacioni në këtë studim do të rishikohet përkundrejt vlerësimeve të disponueshme të publikuara të popullsisë nga zona e gjerë për të përcaktuar vlerën e tyre relative të ruajtjes së natyrës në një shkallë gjeografike.

Më poshtë janë paraqitur detaje të mëtejshme të fushëveprimit për secilin studim në terren:

### Lakuriqët e natës

Do të kryhen dy lloje studimesh për lakuriqët e natës si më poshtë:

**Studimi i itinerareve:** Do të përzgjidhet 1 km itinerar të gjurmës brenda habitateve që mund të përdoren nga lakuriqët e natës brenda zonës së Projektit FV dhe korridorit të LTTL. Vrojtimet studimore do të kryhen sipas periudhave të planifikuara siç tregohet në tabelën 1 më sipër për të regjistruar detaje të mëtejshme rreth shtigjeve të fluturimit të specieve që lëvizin/kërkojnë ushqim. Një pajisje portative regjistrimi me detektim me zë për lakuriqët e natës do të përdoret për të ndihmuar në identifikimin e specieve gjatë studimit të itinerareve. Të paktën tre itinerare prej 1 km për në distancë 4-5 km nga njëri-tjetri do të zgjidhen përgjatë LTTL dhe një itinerar prej 1 km brenda vendndodhjes së Projektit FV.

**Studimet për vendet ku ngrenë fole të:** Bazuar në gjetjet e studimit të itinerareve, ekspertët do të kryejnë një studim në terren gjatë ditës për elemente të tilla si, pemë me vrime qukapiku, lëvore të ngritura, zgavra të tjera etj., ndërtesa dhe bunkerë që ndodhen në zonën e projektit ku dyshohen të ketë një numër të konsiderueshëm folesh të lakuriqëve të natës. Ndoshta në këtë studim do të duhen të paktën dy persona për secilën vendndodhje të foleve. Do të përdoren pajisjet e regjistrimit të detektimit me zë për lakuriqët e natës për të ndihmuar në identifikimin e këtyre specieve. Duhet të kryhen tre studime në muzg për çdo fole të mundshme gjatë vëzhgimeve në vend. Studimi do të bëhet për 2 orë, duke filluar 15 minuta para perëndimit të diellit. Do të bëhet regjistrimi i specieve dhe numrit të lakuriqëve të natës duke përdorur secilën vendndodhje të foleve.

### Gjitarë të tjerë:

Studimet në terren do të kryhen në kushte të përshtatshme për regjistrimin e sinjaleve të aktivitetit të gjitarëve duke shmangur erërat e forta dhe shiun e dendur e të zgjatur. Ekspertët do të përcaktojnë minimumi dy itinerare prej 1 km në secilin vend kampionimi brenda vendndodhjes së Projektit dhe gjurmës së LTTL për gjitarët. Do të përcaktohen disa itinerare paralele me rrjedhat ujit përgjatë gjurmës së Projektit për të kërkuar shenja të vidrit (*Lutra lutra*), vjedullës (*Meles meles*), qelbësit (*Mustela putorius*), çakallit të artë (*Canis aureus*) dhe gjitarëve të tjerë bregdetarë. Vendndodhja dhe rruga/shtrirja e çdo itinerari do të regjistrohen dhe shfaqen në hartat GIS.

Do të bëhen 3 ecje në këto itinerare në mot të përshtatshëm për të identifikuar dhe regjistruar shenjat e aktivitetit ose pranisë së gjitarëve duke përfshirë:

- Gjurmët e këmbëve, gjurmët dhe shtigjet;
- Jashtëqitjet;
- Strehat, gropat dhe strofkat; dhe,
- Mbetjet e ushqimeve.

### Amfibët dhe Zvarranikët

Studimi është kryer në kohën e duhur kur speciet e amfibëve dhe zvarranikëve mund të identifikohen në terren përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë.

Ekspertët kanë përcaktuar të paktën dy itinerare 1 km në çdo vend-kampion brenda zonës së Projektit FV dhe përgjatë gjurmës së LTTL, të përshtatshme për amfibët dhe zvarranikët. Disa itinerare do të orientohen paralelisht me rrjedhat ujore në të gjithë zonën e studimit të Projektit për të kërkuar praninë/shenjat e bretkosave, zhabave dhe vendet e shumimit. Çdo vendndodhje dhe itinerar/shtrirje do të përcaktohen në një hartë.

Vizitat e vëzhgimit në terren do të kryhen në kushte të përshtatshme moti, duke shmangur erërat e forta dhe shiun e dendur e të zgjatur dhe në kohën e duhur që të përkojnë me kohën kur zvarranikët dhe amfibët kanë më shumë gjasa të ngrohen në diell. Kjo do t'i lejojë ekspertët të identifikojnë dhe regjistrojnë sinjalet e aktivitetit ose pranisë për amfibët dhe zvarranikët, dhe të regjistrojnë mbarështimin e specieve prioritare.

Vëzhgimet për amfibët do të përfshijnë një kombinim të studimit ditë-natë. Kërkimet sistematike gjatë ditës për amfibët do të kryhen nëpërmjet vëzhgimeve në terren për të paktën një orë në çdo vend-kampion. Vëzhgimet gjatë natës do të përfshijnë një kombinim të dëgjimit të tingujve të amfibëve, ndriçimit, kërkimit në çdo vend-kampion duke filluar 15 minuta para perëndimit të diellit.

Studimet për zvarranikët dhe amfibët do të ndjekin metodologjinë e mëposhtme:

- Identifikimi i strehëve/ekosistemeve të përshtatshme natyrore që mund të përdoren nga zvarranikët dhe amfibët për t'u ushqyer;
- Identifikimi dhe regjistrimi i specieve, madhësisë dhe kushteve të të gjithë zvarranikëve dhe amfibëve të identifikuar;
- Gjatë studimit të shënohet çdo shenjë e pranisë së zvarranikëve, duke përfshirë lëkurat në kënetat ose vëzhgimet e drejtpërdrejta; dhe,
- Plotësimi i një vlerësimi të gjendjes së habitatit për zvarranikët, duke treguar nëse ai është në gjendje të mirë, të moderuar ose të keqe, nëse mund të suportojë një popullsi të madhe, të mesme ose të vogël dhe përqindjen relative të habitatit të pranishëm në lidhje me një zonë më të gjerë.

## Insektet

Vëzhgimet në terren do të kryhen në kushte të përshtatshme atmosferike për gjurmimin e insekteve duke shmangur erërat e forta dhe shiun e dendur e të zgjatur. Një ekip ekspertësh me përvojë me metodat për të gjetur/zbuluar dhe identifikuar insektet e pranishme brenda zonës së studimit të Projektit, do të kryejë studimin.

Për çdo insekt, që renditet si i rrezikuar në mënyrë kritike ose i rrezikuar në Listën e Kuqe të IUCN, i rëndësishëm në nivel kombëtar/rajonar, përfshirë dhe ato të Listës së Kuqe Shqiptare dhe/ose subjekt i dispozitave të legjisllacionit shqiptar, do të realizohet një hartë ku do të ilustrohen tiparet prioritare dhe habitatet kritike sipas kriterëve të BERZH – klasifikimet e habitateve të BERZH KP 6 dhe IFC SP6). Gjithashtu do të regjistrohen koordinatat GPS të çdo lloji të insektit 'prioritar'.

Imazhet satelitore dhe fotografitë ajrore do të përdoren për të përzgjedhur një minimum të vendeve të koampione me habitat të përshtatshëm për insektet 'prioritare' brenda zonës së studimit të Projektit. Zonat e kampionit do të përfshijnë përfaqësimin më të mirë të zonave shkëmbore/rrëpirë, kullota, makie dhe habitatet buzë pyjeve.

Një minimum itinerari prej 100 m do të vendoset në çdo vend kampion me 5 kurthe të lidhura e të mbuluara me etilen-glikol (ose antifriz) për të ruajtur insektet e kapur në tokë. Rrugët e survejuara të itinerarit dhe vendndodhjet e regjistrimeve të llojeve të insekteve me vëzhgim dhe inspektim të drejtpërdrejtë të ekzemplarëve të kurtheve do të shfaqen në një hartë GIS.

## Avifauna

Vizitat në terren për zogjtë me riprodhim të vonshëm, zogjtë migrues (të hershëm) dhe zogjtë folezues janë kryer në periudha të përshtatshme kohore gjatë gjithë vitit. Për avifaunën, zona e studimit mori në konsideratë rajonin më të gjerë gjeografik, duke përfshirë gjurmën e projektit, zonën e ndikimit dhe zonat e interesit të vendosura në pjesën perëndimore dhe veriore të projektit të propozuar.

Metodologjia e përdorur gjatë studimit në terren do të jetë një kombinim i itinerareve të linjës ashtu edhe pikave me numër pasi kombinimi i të dy metodave është më i përshtatshmi për karakteristikat e habitateve që do të vëzhgohen. Itineraret e linjës janë më të përshtatshme për habitatet e hapura, siç është rasti i vendndodhjes së Projektit FV, ndërsa metoda e pikave me numra është më e përshtatshme për habitate të mbyllura, siç mund të jetë rasti për gjurmën e LTTL.

Të dy metodat, itineraret e linjave dhe pikat me numra bazohen në regjistrimin e zogjve të hasur përgjatë një gjurme të paracaktuar brenda një zone të paracaktuar studimi. Për itineraret e linjës, regjistrimi i shpendëve ndodh vazhdimisht, ndërsa për numërimin e pikave kryhet në intervale të rregullta përgjatë gjurmës dhe për një kohëzgjatje të caktuar në secilën pikë (Sutherland dhe të tjerë, 2004).

Do të ndërmerren itinerare linjash për të identifikuar speciet e shpendëve të pranishme në tokat bujqësore aktuale dhe të braktisura, kënetat e përkohshme aty pranë, kallamishtet, dunat ranore, zonat bregdetare në pjesën veriperëndimore të zonës së Projektit FV. Përgjatë gjurmës së propozuar të LTTL do të përdoren pika me numra që mbulojnë toka bujqësore, kanale kulluese, pemë të ndara, etj.

Speciet që gjenden në zonë gjatë vizitës në terren do të përshkruhen duke përfshirë informacione mbi statusin e tyre të ruajtjes dhe kërkesat e habitatit. Identifikimi i zonave me rrezik më të lartë përplasjeje do të identifikohet përgjatë gjurmës së LTTL dhe vendndodhjeve të tjera të projektit në mënyrë që të sigurohen masa zbutëse shtesë të nevojshme për ruajtjen e tyre në përputhje me hierarkinë e zbutjes.

Për secilën prej specieve të vëzhguara do të mbahen evidencat e mbarështimit, në përputhje me kategoritë e shumimit të Atlasit Evropian të Shpendëve (EBBA2).

Vizitat në vendndodhjet e folezimit do të kryhen për shpendët folezues në lagunën e Karavastasë, Godullën e Ushtarit dhe tokën e thatë në afërsi, aty ku mund të gjenden specie folezuese koloniale. Vëzhguesi do të shënojë çdo lloj prove shumimi: si zogjtë në dukje, foletë e sapondërtuara dhe ato me vezë, të vegjlit me flatra, etj.

Ekipi i studimit do të përbëhet nga një vëzhgues i pajisur me dylbi (10 x 42), objekti i dallimit (me zmadhim 20-60) dhe kamera për fotografimin e zogjve dhe habitateve, dhe altoparlant për vendosjen e tingujve thirrës në rast se është e nevojshme për të identifikuar zogjtë. Të gjitha të dhënat do të shënohen menjëherë në bazën e të dhënave në adresën: <https://observation.org/%20database>.

Përveç kësaj, Konsulenti do të konsultohet me organet e mëposhtme për të marrë informacion dhe të dhëna shtesë:

- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), duke përfshirë Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura (ARZM);
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);
- Përfaqësues të Shoqatave të Gjuetisë;
- Përfaqësues të OJQ-ve që punojnë në zonë;
- Komunitet lokal.

## Mjedisi Ujor

Për ekologjinë ujore do të zgjerohet gjeografikisht zona e studimit, duke marrë parasysh të gjitha kanalet, si kulluese ashtu edhe vaditëse, që ndodhen në rrethinën e gjurmës së projektit dhe pjesën jugperëndimore. Gjatë kësaj pune do të hetohen lloje të ndryshme të ujërave sipërfaqësore, duke përfshirë kanalet kulluese (të përhershme dhe me ndërprerje) dhe kanalet e ujitjes (hapësirë më e gjerë sesa zona e projektit). Vendndodhjet e pikave të studimit për sistemin ujor do të kategorizohen sipas (a) kritereve hidrologjike, d.m.th., trupave ujorë të përhershëm dhe me ndërprerje; (b) kriteret gjeografike, d.m.th., rrjedhat ujore në



zonë e projektit dhe më gjerë, duke marrë në konsideratë pjesën në jug-perëndim të projektit, si dhe trupa të tjerë të rëndësishëm ujqorë si përrenj/lumenj rreth zonës së projektit.

Vizitat në terren do të mundësojnë grupimin e karakteristikave të cilësisë së ujit (kripësia, oksigjeni i tretur, temperatura) dhe karakteristikat e habitatit (substrati, thellësia, rrjedha, bimësia në sipërfaqen ujqore) të rrjedhave kryesore ujqore në zonën e studimit të projektit.

Studimet do të kryhen gjatë orëve të ditës, duke përdorur një rrjetë të madhe me një dorezë të zgjatur druri dhe një kornizë në formë D-je, me së paku tetë prova radhazi të kryera në secilin vend, do të përdoren edhe rrjeta më të vogla zhytjeje. Në ato raste, kur vendet janë të kalueshme (substrat relativisht të ngurta, thellësi më pak se 1.5 m dhe bimësi e kufizuar), do të përdoren rrjeta tratë.

Gjatë studimeve do të merren parasysh përbërësit e mëposhtëm:

- Vlerësimi i habitatit ujqor;
- Përbërja e peshqve;
- Jovvertebrorët ujqorë dhe
- Bimësia ujqore e lidhur me habitatet e studiuara.

Parametrat e ujit, në lidhje me temperaturën, kripësinë, pH-në dhe oksigjenin e tretur, do të maten në vend me një analizues me shumë parametra *Consort C535* dhe sonda të përshtatshme.

Për përbërjen e peshqve do të përdoren një larmi rrjetash, duke përfshirë rrjetën e dorës të tipit D, rrjetat sagje të përdorura për kapjen e ngjalave në kanalet e komunikimit dhe rrjetat tratë. Për rrjetat tratë janë zgjedhur gjithsej 12 zona të marrjes së mostrave në pjesën e cekët të zonave të zgjedhura të habitateve ujqore. Mostrat do të mbledhen duke përdorur një rrjetë tratë për në det me gjatësi 12 m (madhësia e vrimëzave 2 mm), i cili lejon kapjen e peshqve të vegjël dhe të rriturve të specieve me madhësi të vogël. Disa mostra të veçanta do të përdoren për t'u mbledhur gjatë çdo periudhe të marrjes së mostrave në secilin vend të marrjes së mostrave, duke ndjekur 20 metra skaje të vijës bregdetare në secilën mostër të veçantë.

Mostrat e gjalla, pasi u është bërë anestesia me kuinaldinë, do të identifikohen (nomenklatura e peshkut sipas Kottelat & Freyhof 2007), maten (të rrumbullakosura në mm), peshohen (të rrumbullakosura në 0,001 g) dhe pastaj kthehen në ujë (disa ekzemplarë mund të mbahen për analiza të mëtejshme).

Për studimin e jovvertebrorëve ujqorë në secilën vendndodhje do të merren dy mostra të veçanta të nënshtresave të fundeve të buta nga një zonë standarde prej 400 cm<sup>2</sup> (dy mostra të veçanta). Mostrat do të ruhen në një solucion formaldehyd me 4%. Në laborator, fauna e mbajtur në një rrjetë me sitë 1 mm, do të renditet dhe identifikohet në nivelin e specieve kudo që të jetë e mundur.

Vlerësimi i mbulesës së bimësisë së zhytur do të bëhet në mënyrë vizuale, duke regjistruar zonën e përqindjes së mbuluar nga bimësia dhe duke kategorizuar dendësinë e livadheve nga 0 (dendësi e ulët) në 5 (dendësi e lartë).

Përveç kësaj, Konsulenti do të konsultohet me palët kryesore të interesuara në vijim për të marrë informacion dhe të dhëna shtesë:

- Sektori i Politikës dhe Strategjisë për Zhvillimin e Peshkimit dhe Bujqësisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), duke përfshirë Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura (ARZM);
- Peshkatarët vendas dhe anëtarët e komuniteteve.

## Habitate

Punimet në terren do të ndërmerren gjatë periudhave optimale kur speciet bimore përcaktuese të lidhura me çdo lloj habitatit janë më të dukshme. Një botanist me përvojë, me njohuri për hartën e habitateve dhe i

aftë për të identifikuar llojet e ndryshme të habitateve dhe specieve të florës të pranishme brenda zonës së studimit të Projektit, do të kryejë studimet e zonës.

Imazhet satelitore dhe fotografitë ajrore do të përdoren për të identifikuar lloje të ndryshme habitatesh (Natyrore dhe të Modifikuara) në zonën e studimit të Projektit për të përgatitur një hartë paraprake. Kjo hartë do të përdoret për të përzgjedhur numrin e vendeve të mostrimit/kampioneve brenda secilit prej llojeve të habitateve pas vëzhgimeve në këmbë. Vendndodhjet e llojeve të habitateve do të hidhen në një hartë/tabelë që tregon konturet dhe veçoritë e tokës, në një shkallë të përshtatshme. Vendndodhjet sipas GPS të pikave kyçe do të regjistrohen për të ndihmuar në futjen e të dhënave nga terreni në GIS dhe ilustrimin në hartë.

Regjistrimi i detajeve në lidhje me gjendjen e llojeve të habitateve sipas IFC PSC dhe BERZH KP 6 (habitat natyror, i modifikuar, kritik) do të bëhet në bazë të faktit nëse është:

- Në gjendje të mirë dhe që përfshin popullata bimore të qëndrueshme me origjinë kryesisht vendase (shqiptare) (dhe për këtë arsye konsiderohet të jetë Habitat Natyror);
- Duke "vuajtur" nga shqetësime ose ndërhyrje të moderuara, por që ende përfshin kryesisht popullata të specieve bimore vendase (shqiptare) dhe për këtë arsye me vlerë të konsiderueshme biodiversiteti (dhe për këtë arsye konsiderohet si Habitat Natyror); ose,
- Në gjendje të keqe (d.m.th., të menaxhuara gjerësisht ose të ndryshuara nga gjendja natyrore nga aktiviteti njerëzor) dhe që përfshin një pjesë të madhe të specieve me origjinë jo-vendase (dhe për këtë arsye konsiderohen si Habitat i Modifikuar).

Për studimet e mostrave të habitatit, do të sigurohet një formular i mostrës analitike. Detaje të tjera do të regjistrohen si bimësi ekzistuese për të vlerësuar kushtet e habitateve dhe klasifikimin e habitateve sipas EUNIS (dhe Direktivës së BE-së për Habitatet Aneksi 1).

## Flora

Për vlerësimin bazë të florës do të zhvillohet një hartë e bashkësisë së bimësisë, bazuar në punën paraprake në terren dhe të dhënat ekzistuese dytësore. Më pas, shtrirja dhe përbërja e llojeve të bimësisë do të verifikohet duke përdorur studime (*relèves*, *fitosociological sensu striktu*). Vlerësimi dhe analiza e disa indekseve bio-ekologjike si toka, klima dhe indeksi i thatësisë do të vlerësohen brenda zonës së studimit të projektit.

Studimi i florës do të përqendrohet në:

- Biodiversitetin ekologjik (peizazhet, ekosistemet, habitatet, Karakteristikat Parësore të Biodiversitetit (KPB));
- Biodiversitetin organizativ (familje, gjini dhe specie), përveç specieve dhe familjeve. Konsulenti do të vlerësojë ndryshueshmërinë në format biologjike, format korologjike dhe indekset e biodiversitetit (indeksi Shannon etj.).

Shpërndarja dhe ndryshueshmëria e bimësisë në të gjithë Zonën e Influencës ndjek përgjithësisht një pjerrësi dhe ndryshon bazuar në distancën e saj nga bregu i detit. Prandaj, metodologjia për përcaktimin e pikave të studimit do të kryhet në përputhje me itineraret nga perëndimi (bregu i detit) në lindje (drejt zonës kodrinore). Për të përcaktuar larinë e florës dhe bimësisë brenda zonës së studimit të projektit, studimet do të zhvendosen në të majtë ose në të djathtë të itinerarit ku vërehet ndonjë ndryshim në përbërjen e specieve (në *fitosociologji kjo metodë quhet "metoda e kënetës"*).

Studimi i florës në terren do të kryhet nga një ekolog i kualifikuar në mënyrë të përshtatshme.

Tiparet ekzistuese të biodiversitetit brenda gjurmës së projektit dhe mjedisit përreth do të karakterizohen, duke përfshirë legjislacionin shqiptar Listën e Kuqe, Listën e Kuqe të IUCN, Karakteristikat Prioritare të Biodiversitetit (KPB) dhe veçoritë kritike të kualifikimit të habitatit sipas KP6 të BERZH dhe IFC SP6. Ky proces priorizimi do të ndihmojë duke ofruar përqendrim në vlerësimin e ndikimit për të siguruar që masat shmangëse, zbutëse dhe restauruese të përqendrohen te vlerat dhe rreziqet më të larta të biodiversitetit brenda zonës së ndikimit (ZI).

Raportimet/vëzhgimet në terren do të plotësohen në një template të mirë-përcaktuar dhe do të realizohen disa harta në GIS të cilat do të ilustrjnë gjetjet kryesore. Do të përgatitet një inventar i florës, listimi i llojeve të bimëve të rralla, të rrezikuara, të kërcënuara, të cenueshme, ekonomikisht të rëndësishme dhe mjekësore dhe frekuenca, bollëku dhe dendësia e tyre do të përcaktohet dhe do të shoqërohet me të dhënat, koordinatat dhe fotot e mbledhura në terren gjatë vëzhgimit.

Përveç kësaj, Konsulenti do të konsultohet me palët kryesore të interesuara në vijim për të marrë informacion dhe të dhëna shtesë:

- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), duke përfshirë Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura (ARZM);
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (Drejtoria e Pyjeve);
- Universiteti Bujqësor i Tiranës (teza diplome dhe studime doktorature).

Raporti bazë do të përshkruajë habitatet dhe speciet e pranishme në zonën e studimit bazuar në rishikimin teorik dhe hetimin në terren, dhe vlerëson dhe klasifikon ndjeshmërinë ose cenueshmërinë e specieve. Për qëllim të këtij vlerësimi të biodiversitetit do të jepen informacione për sa më poshtë:

- Një përshkrim i statusit aktual të biodiversitetit të florës në zonën e studimit të projektit;
- Një përshkrim i kërcënimeve ndaj biodiversitetit të florës;
- Identifikimi i çdo zone me vlerë të lartë ruajtjeje (VLR) që është e rëndësishme për biodiversitetin, p.sh., zona me status të mbrojtur, popullata të specieve ose ekosistemeve të kërcënuara ose të rralla.

### Raportimi i Studimit të Biodiversitetit

Të dhënat e vendeve të marrjes së mostrave (duke përfshirë hartat dhe koordinatat GPS), metodat e përdorura, datat e studimit dhe informacione të tjera përkatëse do të regjistrohen dhe bëhen të disponueshme për secilin nga komponentët ose kategoritë e studiuara të biodiversitetit.

Të dhënat do të paraqiten në tabela përmbledhëse, me specie të rrezikuara ose të kërcënuara në mënyrë kritike, të cenueshme dhe me rreze të kufizuar në Listën e Kuqe të IUCN, dhe çdo specie të listuar në nivel kombëtar/rajonar të përfshirë në Listën e Kuqe Shqiptare dhe/ose subjekt i dispozitave të legjislacionit shqiptar. Direktivat e BE-së (udhëzimet dhe anekset) Kërkesat e IFC SP6 dhe KP6 të BERZH-it.

Do të ofrohet një hartë në shkallë të gjerë, ku tregohet vendi i marrjes së mostrave dhe vendet e regjistrimit të specieve "prioritare"<sup>40</sup>.

Për përshtatshmërinë e habitatit për çdo specie 'prioritare' të regjistruar, do të përshkruhet një tregues për sasinë/madhësinë e popullatës dhe shpërndarjen e tyre brenda zonës së studimit të Projektit. Konsulenti do të ofrojë gjithashtu informacion kontekstual në lidhje me statusin e specieve 'prioritare' në një zonë më të gjerë gjeografikisht se sa zona e projektit: rreth zonës së Spitallës (pjesa veriperëndimore), Shqipëri dhe ndërkombëtarisht.

### Vlerësimi kritik i habitatit

Do të identifikohet një listë e specieve "prioritare", që përfshin speciet shkaktoare për Habitatin Kritik KP6, për të përcaktuar një Vlerësim Kritik të Habitatit dhe modelin e zbutjes siç është e nevojshme. Një Vlerësim Kritik i Habitatit do të ndërmerret dhe përgatitet si një dokument i veçantë dhe një përmbledhje e gjetjeve do të përfshihet në një aneks brenda VNMS. Vlerësimi Kritik i Habitatit do të vlerësojë në bazë të 5 kritereve, siç kërkohet në kriteret e KP6 të BERZH dhe SP6 të IFC për Habitatet Kritike (HK), si më poshtë:

- Ekosisteme me rrezik të lartë ose unike;

<sup>40</sup> Llojet prioritare janë ato specie që janë identifikuar sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare si më të kërcënuarat dhe që kërkojnë masa ruajtëse.

- Habitata me rëndësi të konsiderueshme për speciet e rrezikuara ose me rrezik kritik;
- Habitata me rëndësi të konsiderueshme për speciet endemike ose të kufizuara gjeografikisht;
- Habitata që mbështesin specie migratore ose kongregacionale globale të rëndësishme; ose
- Zonat e lidhura me proceset kyçe evolucionare;
- Funksionet ekologjike që janë jetike për ruajtjen e qëndrueshmërisë së veçorive të biodiversitetit të përshkruar (si tipare kritike të habitatit).

### 7.2.3.2. Cilësia e tokës dhe e ujit

Mostrat dhe analizat e cilësisë së tokës dhe ujit do të ndërmerren si më poshtë :

- Toka: mostrat e tokës do të merren në 3 vendndodhje përfaqësuese pranë ZZHP dhe linjës së transmetimit për të përcaktuar bazën e cilësisë së tokës. Pikat e marrjes së mostrave do të referohen gjeografikisht dhe do të analizohen për strukturën/ lagështinë e tokës, pH-n, metalet e rënda, pjellorinë e tokës (përmbajtja e lëndëve ushqyese) dhe ngjyrën. Do të bëhet përshkrimi sipërfaqësor i tokave, si ndjesia, ngjyra, struktura, kullimi i tokës dhe daljet e shkëmbinjve.
- Cilësia e ujit: ekzistojnë disa kanale ujitëse që ndodhen në afërsi të linjës së transmetimit në zonën bujqësore përreth Zonës së Projektit FV. Do të merren deri në 3 mostra uji, kur është e mundur, dhe do të analizohen për metale të rënda, pH-n, oksigjenin e tretur, kërkesën biokimike të oksigjenit dhe lëndët e ngurta totale të precipituara dhe kërkesën kimike për oksigjen. Rezultatet e analizave do të krahasohen me standardet kombëtare dhe udhëzimet e OBSH-së dhe do të përdoren për të vendosur kushtet bazë të cilësisë së ujit.

### 7.2.3.3. Baza socio-ekonomike

Gjatë VNMS-së do të mundësohet angazhimi i komunitetit në mënyrë që të mbledhë të dhëna të mëtejshme socio-ekonomike. Këto të dhëna të mbledhura gjatë vëzhgimeve në terren janë element kryesor i studimeve sociale dhe shëndetësore. Informacioni do të mblidhet për fushat ekzistuese të interesit brenda "Zonës së Projektit (ZP)".

Të dhënat bazë socio-ekonomike do të mblidhen përmes sa vijon:

- Kryerja e vizitave në terren për të organizuar takime me komunitetin dhe për të mbledhur të dhëna bazë shtesë;
- Merrja e të dhënave socio-ekonomike nga bashkia Durrës;
- mbledhja e komenteve dhe ankesave nga komunitetet;
- Mbledhja e të dhënave socio-ekonomike përmes intervistave me informatorët kryesorë, diskutimeve me grupet e fokusit dhe angazhimit të palëve të interesuara;
- Përditësimi i gjendjes bazë socio-ekonomike dhe shëndetësore me të dhënat parësore;
- Vlerësimi i ndikimit kumulativ të zhvillimit me zhvillimet aktuale dhe të planifikuara në zonë;
- Masat zbutëse që do të hartohen dhe dotë përfshihen në Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social.

Këto të dhëna do të mblidhen përmes Diskutimeve në Fokus Grupe (DFG) dhe Intervistat me Informatorët Kryesorë (KII), intervista me drejtues të komunitetit dhe biznese në ZP.

DFG janë diskutime të organizuara me një grup të zgjedhur individësh për të marrë informacione në lidhje me pikëpamjet dhe përvojat e tyre në një temë të caktuar për të ndihmuar marrjen e njohurive për perceptimin e përbashkët të njerëzve për jetën e përditshme dhe mënyrat në të cilat individët ndikohen nga të tjerët në një situatë grupi.

KII-të janë intervista cilësore të thelluara me njerëz që dinë se çfarë po ndodh në komunitet. Qëllimi i KII-ve është mbledhja e informacionit nga një gamë e gjerë njerëzish, duke përfshirë drejtuesit e komunitetit, profesionistë ose banorë, të cilët kanë njohuri personale për komunitetin. Intervistat do të organizohen me individë/ institucione që kanë njohuri për një temë specifike (p.sh. programet e zhvillimit, shëndetësinë, punësim, arsim dhe infrastrukturën) ose janë anëtarë të informuar të komunitetit. Për të mbledhur të dhëna cilësore do të intervistohen dhe përfaqësuesit e qeverisë lokale dhe specialistët e kujdesit shëndetësor.



Numri i këtyre intervistave do të varet nga njohuritë dhe disponueshmëria e përfaqësuesve në zonë.

. DSH -ja ose dokumente të tjera informative (p.sh. fletushka) do t'i shpërndahen komunitetit përpara takimeve konsultative. Këto do t'i shpjegojnë projektin dhe procesin e VNMS-së në terma të thjeshtë dhe do të japin detaje mbi datat dhe vendet e takimeve të konsultimit me komunitetin. Rezultatet e këtyre konsultimeve dhe komentet e marra do të paraqiten në raportin e VNMS-së.

Do të bëhet një kombinim i hetimit teorik dhe atij në terren për të identifikuar çdo kufizim vertikal të ndërtesave nën linjat e transmetimit, ose kufizime anësore për të siguruar aksesin dhe sigurinë në secilën anë të linjës së transmetimit, duke përfshirë kalimin e infrastrukturës tjetër (linjat e tjera të energjisë, telefonisë, antenave, etj.), brenda korridorit të sigurisë (25m në secilën anë).

Aktivitete të tjera të rëndësishme përfshijnë të kuptuarit e pranisë së çdo pike të nxehtë që mund të kërkojë ndryshime në projektin aktual të projektit, pikat e ekspozimit ose zonat që kërkojnë aplikimin e masave të veçanta zbutëse. Për më tepër, ekipi do të vëzhgojë se si po zgjerohen vendbanimet, me çfarë ritmi dhe në cilin drejtim (d.m.th., drejt ose larg nga ndonjë vendndodhje e objekteve), si dhe vendet e veprimtarisë së planifikuara në të ardhmen.

Vëzhgimet në terren do të përfshijnë gjithashtu profilizimin e infrastrukturës sociale dhe shëndetësore dhe vëzhgimet e nivelit të lartë të trafikut. Ekipi i projektit nëpërmjet studimeve në zyrë dhe zbulimeve të pjeshme sipërfaqësore do të identifikojë vendet e trashëgimisë kulturore. Vëzhgimet në terren do të kërkojnë regjistrimin e gjurmës së rrugës me GPS (pikat e rrugës GPS) dhe të paktën dy fotografi të secilit prej vendeve në fjalë. I gjithë informacioni, duke përfshirë një përshkrim të detajuar të vendeve të studimit dhe çdo problem të mundshëm, do të regjistrohet në hartë dhe në bllok fotografish.

**Tabela 22. Plani i studimit të biodiversitetit**

Ekspertë	Të dhënat që do të mblidhen	Shtrirja	Periudha kohore											
			2021						2022					
			Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shtat	Tet	Nën	Dhjet	Jan	Shku	Mar
Eksperti i florës dhe habitatit	Hartësimi i habitatit; Karakterizimi i habitatit - Përbërja e specieve e secilit lloj habitatit; Identifikimi i çdo specie/ PBF-je të kualifikuar për CH dhe vlerësimi i popullatave.	Zona e Zhvillimit të Projektit (ZZHP) dhe Zona e Influencës (ZI), rrugët e transportit, çdo habitat tjetër kryesor në peizazhet përreth	Stina e Pranverës						Stina e Vjeshtës					
Eksperti i faunës dhe lakuriqëve të natës	Fauna tokësore dhe lakuriqët e natës; Lloji i të dhënave = të dhëna për praninë/ mungesën e mundshme; Përdorimi i habitatit; Vendet e foleve;	ZZHP dhe ZI, rrugët e transportit, çdo habitat tjetër kryesor në peizazhet përreth	Stina e Pranverës						Stina e Vjeshtës					
Eksperti i zogjve	Prania/ mungesa e specieve	ZZHP dhe ZI, rrugët e transportit, çdo habitat tjetër kryesor në peizazhet përreth												
	Identifikimi i çdo specie të kualifikuar për CH/ specie PBF; Identifikimi i specieve migratore dhe specieve të kualifikuara për CH/PBF, vlerësimi i popullsisë dhe habitateve të tyre;		(Shumimi/ folezimi)	(Zogj Shtegtarë)		Stina e Vjeshtës		Stina e Dimrit						
Eksperti ujqor	Identifikimi i çdo specie PBF/ të kualifikuar për CH; Identifikimi i specieve migratore;	ZZHP dhe ZI, rrugët e transportit, çdo habitat tjetër kryesor në peizazhet përreth duke përfshirë kanalet e ujitjes dhe kullimit.	Stina e Pranverës						Stina e Vjeshtës					

**Tabela 23. Studime dhe raportime shtesë për biodiversitetin**

Studime dhe raportime shtesë për biodiversitetin														
Ekspertët	Të dhënat që do të mblidhen	Shtrirja	2022											
			Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
			Studimi i shumimit të shpendëve/ Studimi i foleve	Prania/ mungesa e specieve Identifikimi i çdo specie të kualifikuar për CH/ specie PBF	ZZHP, ZI dhe linja e propozuar e transmetimit					Fund maji - fillim qershor, 2022				
Zogjtë Shtegtarë	Identifikimi i çdo specieve migratore dhe të kualifikuara për CH/ specie PBF;	ZZHP, ZI dhe linja e propozuar e transmetimit				Prill/Fillimi i maji, 2022;								
Studimi ujqor - kanalet e ujitjes dhe kullimit	Identifikimi i çdo specieve PBF/ të kualifikuar për CH; Identifikimi i specieve migratore;	ZZHP, ZI, linja e propozuar e transmetimit dhe kanalet e lidhura të ujitjes											(sezoni i shirave)	
Fauna tokësore mbi amfibët dhe zvarranikët - strehimi; Lakuriqët e natës dhe gjitarët e tjerë?		ZZHP, ZI, linja e propozuar e transmetimit dhe kanalet e lidhura të ujitjes				Pranverë, 2022								

**Tabela 24. Programi i Studimeve Bazë Mjedisore dhe Sociale**

Ekspertë	Të dhënat që do të mblidhen	Shtrirja	Periudha kohore											
			2021						2022					
			Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer
Eksperti socio-ekonomik	Demografia, Popullsia, Grupet e Cënueshme, Arsimit, Burimet e jetesës dhe Mikro-Ekonomia, Burimet kryesore të jetesës dhe Punësimi,	Zona e Zhvillimit të Projektit (ZZHP) dhe Zona e Influencës (ZI), rrugët e transportit.												
		Linja e propozuar e transmetimit												

Ekspertë	Të dhënat që do të mblidhen	Shtrirja	Periudha kohore														
			2021						2022								
			Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer			
	Infrastruktura, Shëndetësia Komunitet, etj.	Alternativa e re e linjës së transmetimit															
Ekspertë mjedisorë dhe socio-ekonomikë	Vlerësimi i infrastrukturës së fshatit, rrugët, vendkalimet, vendbanimet, çështjet e sigurisë, furnizimet me ujë, mbetjet, ujitja, etj.	ZZHP dhe ZI, rrugët e transportit, çdo habitat/ zonë tjetër sensitive															
		Linja e propozuar e transmetimit															
		Alternativa e re e linjës së transmetimit															
Ekspert i mjedisit, cilësisë dhe përdorimit/mbulesës së tokës	Vlerësimi i përdorimit dhe mbulesës së tokës, duke përfshirë peizazhin. Shqyrtimi i vetive fiziko-kimike të tokës në zonën e studimit. Matjet e cilësisë së tokës do të kryhen nga një laborator i akredituar.	ZZHP dhe ZI, rrugët e transportit, çdo receptor tjetër kyç në peizazhet përreth;															
		Linja e propozuar e transmetimit dhe kanalet e ujitjes;															
		Alternativa e re e linjës së transmetimit															
Ekspert i gjeologjisë	Vlerësimi i gjeologjisë në zonën e studimit	ZZHP dhe ZI, rrugët e transportit, çdo receptor tjetër kyç në peizazhet përreth, duke përfshirë kanalet e ujitjes dhe kullimit.															
